

Per scoprire le radici dell'albero genealogico bisogna essere muniti di conoscenza e coraggio, cose che a noi albanesi non mancano. «Le stelle non si vergognano di sembrare lucciole, ma anche le lucciole si onorano di sembrare stelle».

RRËNJËT

LE RADICI

GIORNALE INDIPENDENTE

Te zbuloshe rrenjet e trungut gjinetik patjeter duhet te jesh i paisur me dituri e kurajo, te cilat ne shqiptareve nuk na mungojne. «Yjet nuk e kane per turp te duken si xixellonja, por dhe xixellonjat e kane per nder te duken si yjet».

Anno 22
Numero 5
Dicembre 2024


Mensile di attualità e cultura italo-albanese
Direttore editoriale: Hasan Aliaj

Distribuzione gratuita in:
Albania, Australia,
Belgio, Canada, Germania,
Grecia, Francia, Italia,
Stati Uniti e Svizzera

ERODOTO UN VIAGGIATORE ALLA SCOPERTA DEI "BARBARI"

Preparato da Hasan Aliaj - Grottaferrata

I greci chiamavano tutti gli altri popoli "barbari". Col che volevano dire solo "stranieri" che parlavano un'altra lingua, fatta di suoni sgradevoli e incomprendibili. Certo li sentivano molto diversi da sé: meno liberi ed equilibrati, con usanze strane; immersi in una natura meno benigna, meno bella, lontani dalla linfa e dalla luce del mare.



Erodoto

Erodoto, nel suo libro sugli egiziani, oltre a molte informazioni interessanti, si sofferma su un fatto di valore etimologico. Citiamo questo fatto poiché fa luce non solo sull'antichità dei popoli, ma ha grande valore per noi albanesi, poiché stabilisce, da migliaia di anni, una parola che usiamo ancora oggi. Erodoto scrive espressamente: Gli Egiziani prima del regno di Psammetico credevano di essere i più antichi di tutti gli uomini. Ma dopo che Psammetico divenne re e volle conoscere quali fossero gli uomini più antichi, da allora credono che prima di loro vennero i Frigi, e dopo di loro tutti gli altri. Psammetico cercò d'informarsi; ma non riuscendo a trovare un mondo per scoprire quali fossero gli uomini più antichi, escogitò questo sistema. Prende due neonati, figli di gente qualunque, e li consegna a un pa-

store perché li allevi fra i suoi greggi in questo mondo: nessuno davanti ai due bambini poteva pronunciare neanche una parola; essi dovevano rimanere soli in una capanna isolata; a una certa ora del giorno il pastore avrebbe condotto delle capre e dopo averli saziati di latte sarebbe tornato alle sue occupazioni. Così fece Psammetico e diede questi ordini perché voleva udire dai bambini, appena fossero andati oltre emissione di suoni privi significato, quale parola avrebbero pronunciato per prima. Ciò che appunto accade.

Erano due anni che il pastore osservava le disposizioni del re, quando un giorno, aprendo la porta ed entrando nella capanna, i due bambini si buttarono ai suoi piedi tendendo le mani dissero: "Bekos". Da principio il pastore ascoltò senza dir nulla; ma poi, ogni volta che arrivava per accudire ai bambini, quella paro-

la veniva ripetuta. Allora avvertì il padrone e a un suo ordine condusse i bambini davanti a lui. Anche Psammetico li ascoltò, poi cominciò a informarsi su quali fossero gli uomini che chiamano "bekos" qualche cosa. Alla fine scoprì che è il nome con cui i Frigi chiamano il pane.

Ecco come gli Egiziani, sulla base di questo fatto, vennero ad ammettere che i Frigi sono più antichi di loro. Che sia un fatto vero l'ho sentito dire dai sacerdoti del tempio di Efesto a Menfi. I Greci invece sostengono molte altre sciocchezze, fra qui questa: che Psammetico fece tagliare la lingua ad alcune donne e poi mise alloggiare i due bambini presso di loro.

Nel libro *L'Antico Oriente* troviamo un altro fatto interessante... Erodoto scrive: Quasi tutte le figure divine sono arrivate in Grecia dall'Egitto. La loro provenienza barbarica mi risulta dalle mie ricerche: soprattutto, mi pare, la loro provenienza egiziana. Ad eccezione di Posidone e dei Dioscuri, secondo quanto prima ho detto, nonché di Era, Estia, Temide, le Cariti e le nereidi, le figure delle altre divinità esistono in Egitto da sempre: non faccio che ripetere quanto dicono gli stessi Egiziani. E quanto alle figure divine ch'essi affermano di ignorare, penso abbiano avuto il nome dai Pelasgi, tranne Poseidone, che ai Greci fu fatto conoscere dai Libici, poiché la figura di Poseidone non è un patrimonio originario di nessun popolo, se non dei Libici adoratori da sempre di questo dio.

(segue a pagina 2)

L'ALBANIA SALENTINA, TRA GLI ARBËRESHË TARANTINI

Di Lino De Matteis - Lecce

Un'enclave albanese nel cuore del Salento. È uno degli itinerari suggeriti nel volume *IL GRANDE SALENTO DA SCOPRIRE* Un viaggio insolito nel Tacco d'Italia attraverso quindici itinerari tematici, il volume curato da Lino De Matteis, per le Edizioni Grifo, in vendita nelle edicole di Brindisi, Lecce e Taranto in abbinata col "Nuovo Quotidiano di Puglia" (208 pagine a colori ad euro 8,80 + il prezzo del quotidiano).



(leggi a pagina 8)

LE BASILIANE NELLA STORIA DEL MILLENARIO DELL' ABBAZIA DI GROTTAFERRATA

Di Elena Lulashi - Albania

Il 3 ottobre 2024, nella Sala Conferenze dell' Abbazia di S. Nilo a Grottaferrata, c'è stato un omaggio di stima e di affetto alla Venerabile M. Macrina (Elena) Raparelli, fondatrice della nostra Congregazione delle Suore Basiliane di S. Macrina. L'idea, nata su iniziativa dell'Azione Cattolica del Sacro Cuore in collaborazione con la Comunità Monastica Basiliana e l'Amministrazione Comunale, è stata realizzata con successo.



(leggi a pagina 17)

ERODOTI, NJË UDHËTAR NË ZBULIM TË "BARBARËVE"

Pergatiti Hasan Aliaj - Grottaferrata

Grekët i quanin të gjithë popujt e tjerë "barbarë". Me këtë donin të thoshin thjesht "të huaj" që flisnin një gjuhë tjetër, të përbërë nga tinguj të pakëndshëm dhe të pakuptueshëm. Sigurisht, i ndienin shumë të ndryshëm nga vetja: më pak të lirë dhe të ekuilibruar, me zakone të çuditshme; të zhytur në një natyrë më pak të begatë, më pak të bukur, larg lëngut dhe dritës së detit.



Re Psammetico

Erodoti, në librin e tij mbi egjiptianët, përveç shumë informacioneve interesante, ndalet në një fakt me vlerë etimologjike. E përmendim këtë fakt sepse hedh dritë jo vetëm mbi lashtësinë e popujve, por ka një vlerë të madhe për ne shqiptarët, pasi përcakton një fjalë që e përdorim ende sot, që prej mijëra vitesh. Erodoti shkruan shprehimisht: Egjiptianët, para mbretërimit të Psammetikut, besonin se ata ishin njerëzit më të vjetër ndër të gjithë njerëzit. Por, pasi Psammetiku u bë mbret dhe deshi të zbulonte kush ishin njerëzit më të vjetër, që atëherë ata besojnë se para tyre ishin Frigjet, dhe pas tyre të gjithë të tjerët. Psammetiku kërkoi të informohej; por, duke mos arritur të gjente një mënyrë për të zbuluar se kush ishin njerëzit më të vjetër, ai shpiku këtë metodë. Mori dy foshnje, fëmijë të njerëzve të thjeshtë, dhe ua dorëzoi një bariu që t'i rrisë mes kopesë së tij në këtë mënyrë: askush përpara dy fëmijëve nuk mund të shqiptonte asnjë fjalë; ata duhej të

qëndronin vetëm në një kasolle të izoluar; në një orë të caktuar të ditës, bariu ju sillte qumshin prej dhive dhe, pasi t'i kishte ngopur me qumësht, do të kthehej te punët e tij. Kështu veprroi Psammetiku dhe dha këto urdhra sepse donte të dëgjonte nga fëmijët, sapo të dilnin përtej lëshimit të tingujve pa kuptim, se cilën fjalë do të shqiptonin për herë të parë. Dhe kjo ndodhi.

Ishin bërë dy vjet që bariu ndiqte udhëzimet e mbretit, kur një ditë, duke hapur derën dhe hyrë në kasolle, të dy fëmijët iu hodhën te

këmbët, duke shtrirë duart dhe thanë: "Bekos." Fillimisht, bariu dëgjoi pa thënë asgjë; por pastaj, çdo herë që vinte për t'u kujdesur për fëmijët, kjo fjalë përsëritej. Atëherë ai informoi zotërinë dhe, me një urdhër të tij, i sollti fëmijët përpara tij. Edhe Psammetiku i dëgjoi, pastaj nisi të informohej se cilët ishin njerëzit që e quanin "bekos" diçka. Më në fund, zbuloi se ishte emri me të cilin Frigjet e quanin bukën.

Kështu, egjiptianët, mbi bazën e këtij fakti, pranuan se Frigjet janë më të vjetër se ata. Që kjo është një ngjarje e vërtetë e kam dëgjuar nga priftërinjtë e tempullit të Hefestit në Memfis. Grekët, në anën tjetër, pretendojnë shumë marrëzira të tjera, mes të cilave edhe këtë: që Psammetiku ua preu gjuhën disa grave dhe pastaj i vendosi dy fëmijët të qëndronin pranë tyre.

Ndërsa në librin *Lindja e Lashtë* hasim një tjetër fakt interesant... Erodoti shkruan: "Pothuajse të gjitha figurat hyjnore kanë mbërritur në Greqi nga Egjipti. Origjina e tyre barbare del qartë nga hulumtimet e mia: kryesisht, siç duket, origjina e tyre është egjiptiane. Përveç Poseidonit dhe Dioskurëve, sipas asaj që kam thënë më parë, si dhe Herës, Estias, Temidës, Haritëve dhe Nereidëve, figurat e hyjnive të tjera kanë ekzistuar gjithmonë në Egjipt: nuk bëj tjetër veçse përsëris atë që thonë vetë Egjiptianët. Sa për figurat hyjnore për të cilat ata thonë se nuk dinë gjë, mendoj se i kanë marrë emrat nga Pelasgët, përveç Poseidonit, të cilin Grekëve ua kanë bërë të njohur Libianët, pasi figura e Poseidonit nuk është pasuri e asnjë populli tjetër përveç Libianëve, të cilët e kanë adhuruar këtë zot që në lashtësi.

(vazhdon në faqen 2)

-Redaksia e gazetës "Rrënjët" në Romë uron të gjithë bashkëpunëtorët, lexuesit dhe të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen: Gëzuar Festat e Fundvitit! Urojmë që viti 2025 të jetë i mbarë dhe i mbushur me suksese!



-La redazione del giornale "Radici" a Roma augura a tutti i collaboratori, lettori e a tutti gli albanesi ovunque si trovino: Buone Feste di Fine Anno! Che il 2025 sia un anno prospero e pieno di successi!

Erodoto un viaggiatore alla scoperta dei "barbari"

Erodoto, një udhëtar në zbulim të "barbarëve"

(continua dal pagina 1)

Quella invece di rappresentare nelle statue Ermes col membro eretto non è un insegnamento degli Egiziani, ma dei Pelasgi. Fra tutti i Greci i primi ad accogliere questa tradizione furono gli Ateniesi, poi gli altri da loro. Gli Ateniesi erano già annoverati fra i Greci quando i Pelasgi vennero ad abitare il loro stesso paese; dopo di che cominciarono appunto essere considerati greci essi pure. Gli iniziati ai misteri dei Cabiri, che i Samotraci celebrano per eredità dei Pelasgi, sanno cosa dico. La Samotracia era abitata prima dai Pelasgi, che poi coabitavano con gli Ateniesi, e da questi i Samotraci hanno ereditato i misteri. Dunque il membro eretto nelle statue di Ermes venne rappresentato per primi tra i Greci dagli Ateniesi, e a loro fu insegnato dai Pelasgi. I Pelasgi hanno narrato in proposito una storia sacra, che è stata divulgata nei misteri di Samotracia.

Da principio, come ho sentito dire a Dodona, i Pelasgi offrivano tutti i sacrifici invocando gli dèi senza indicare un appellativo o un nome proprio di qualcuno, poiché mai ne avevano uditi. Il nome di "dio" gliel'avevano attribuito perché essi avevano "disposto" in ordine tutto l'universo e se l'erano suddiviso. Passò molto tempo, e i Pelasgi impararono i nomi delle varie divinità, arrivati fino a loro dall'Egitto: non però quello di Dionisio, che conobbero molto più tardi. Dopo altro tempo ancora, sui nomi degli dèi essi consultarono l'oracolo di Dodona, il più antico, si crede, degli oracoli greci e a quel tempo l'unico. I pelasgi dunque chiesero a Dodona se adottare i nomi provenienti dai barbari; l'oracolo rispose di sì. Così da quel momento usarono nei sacrifici il nome delle divinità, e da essi li ricevettero più tardi i Greci.

Questo dunque è quanto ho udito dai sacerdoti tebanici ed ecco ora quanto dicono le profetesse di Dodona. Due colombe nere volarono via da Tebe d'Egitto, e l'una andò in Libia, l'altro arrivò da loro. Posatasi su una quercia, la colomba proclamò con voce umana che in quel luogo doveva sorgere un oracolo di Zeus. Gli abitanti supposero che l'ordine loro rivolto



Il Teatro di Dodona Epirus

venisse da dio, perciò la eseguirono. Quanto alla colomba diretta in Libia, dicevano avesse ordinato ai Libici d'istituire un oracolo di Ammone, un oracolo, anche questo, di Zeus.

Questo mi dicevano le sacerdotesse di Dodona; la più anziana si chiamava Promeneia, la successiva Timarete, e la più giovane Nicandra. Anche gli altri abitanti nei dintorni del santuario confermarono il loro racconto.

Quanto a me, ecco la mia opinione in proposito. Se davvero i Fenici rapirono le due sacrestane e le cedettero una in Libia, l'altra in Grecia, quest'ultima secondo me fu venduta nella regione della Grecia che prima si chiamava Pelasgia, e dunque ai Tesprozi; poi, durante la schiavitù, essa inalzò sotto una quercia cresciuta spontaneamente un tempio a Zeus, con'era naturale per chi a Tebe serviva in un santuario di Zeus il ricordarsene nel luogo dov'era giunta. In seguito, quando comprese la lingua greca, essa istituì un oracolo. Fu anche lei a dichiarare che sua sorella era stata venduta in Libia da quei medesimi Fenici che avevano venduto lei pure.

Il nome di colombe, io credo, venne attribuito alle due donne dai Dodonei per il fatto ch'erano barbare e sembrava emettessero voci simili agli uccelli. E se dopo un certo tempo la colomba si mise a parlare con voce umana, come dicono, è che la donna ormai parlava in modo a loro comprensibile. Finché parlava una lingua barbara, sembrava loro che si esprimesse come uccello: perché una colomba come si sarebbe potuta esprimere con voce umana?

Bibliografia: Erodoto libro "L'antico Oriente"

(vazhdon nga faqja 1)

Ndërkaq, përfaqësimi i Hermesit me organin e tij seksual të ngritur nuk është një mësim nga Egjiptianët, por nga Pelasgët. Nga të gjithë Grekët, të parët që pranuan këtë traditë ishin Athinasit, e më pas edhe të tjerët prej tyre. Athinasit ishin tashmë të renditur ndër Grekë kur Pelasgët u vendosën në të njëjtin vend me ta; pas kësaj, ata filluan të konsideroheshin grekë gjithashtu. Të iniciuarit në misteret e Kabirëve, që Samothrakët i festojnë si trashëgimi nga Pelasgët, e dinë se çfarë them. Samothrakia ishte e banuar më parë nga Pelasgët, të cilët më pas bashkëjetuan me Athinasit, dhe prej tyre Samothrakët trashëgjuan misteret. Prandaj, përfaqësimi i Hermesit me organin e ngritur u bë fillimisht ndër Grekë nga Athinasit dhe atyre iu mësuara nga Pelasgët. Pelasgët kanë treguar në lidhje me këtë një histori të shenjtë, e cila është përhapur në misteret e Samothrakisë."

Që në fillim, siç kam dëgjuar të thuhet në Dodonë, pellazgët ofronin të gjitha flijimet duke i thirrur hyjnitet pa përdorur një epitet ose një emër të veçantë për secilën, sepse asnjëherë nuk kishin dëgjuar për ta. Emrin "zot" ua kishin dhënë atyre, sepse ata kishin "rregulluar" gjithësinë dhe e kishin ndarë mes tyre. Pasi një periudhë e gjatë dhe pellazgët mësuuan emrat e hyjnive të ndryshme, që u kishin ardhur nga Egjipti; por jo emrin e Dionisit, që e mësuuan shumë më vonë. Pas ca kohësh, për emrat e hyjnive, ata u këshilluan me orakullin e Dodonës, që besohet të jetë më i vjetri ndër orakujt grekë dhe, në atë kohë, i vetmi. Pellazgët, pra, e pyetën Dodonën nëse duhet të merrnin emrat

që vinin nga barbarët; orakulli u përgjigj po. Kështu, që nga ajo kohë, ata përdorën emrat e hyjnive gjatë flijimeve dhe më vonë grekët i morën prej tyre.

Kjo pra është ajo që kam dëgjuar nga priftërinjtë tebanë, dhe ja tani çfarë thonë profetet e Dodonës. Dy pëllumba të zinj fluturuan larg nga Teba e Egjiptit; njëri shkoi në Libi, tjetri mbërriti tek ata. Pasi u vendos mbi një lis, pëllumbi shpalli me zë njerëzor se në atë vend duhej të ngrihej një orakull i Zeusit. Banorët supozuan se urdhri i drejtohej nga hyjnia, prandaj e zbatuan. Sa për pëllumbin e drejtuar në Libi, thoshin se u kishte urdhëruar libianëve të ngrihin një orakull të Amonit, gjithashtu një orakull i Zeusit.

Këtë më thoshin priftëreshat e Dodonës; më e moshuara quhej Promeneja, tjetra Timareta, dhe më e reja Nikandra. Edhe banorët e tjerë përreth shenjtërores konfirmonin tregimin e tyre.

Sa për mua, ja mendimi im në lidhje me këtë çështje. Nëse me të vërtetë fenikasit rrëmbyen dy kujdestaret e shenjtërores dhe njërin prej tyre e dërguan në Libi, ndërsa tjetrin në Greqi, kjo e fundit, sipas meje, u shiti në rajonin e Greqisë që më parë quhej Pellazgi, dhe kështu te tesprotet; pastaj, gjatë skllavërisë, ajo ngriti nën një lis të rritur natyrshëm një tempull të vogël për Zeusin, siç ishte e natyrshme për dikë që në Tebë shërbente në një faltore të Zeusit, që ta kujtonte këtë në vendin ku kishte mbërritur. Më pas, kur kuptoi gjuhën greke, ajo ngriti një orakull. Ishte gjithashtu ajo që deklaroi se motra e saj ishte shitur në Libi nga ata fenikas të njëjtë që kishin shitur dhe atë.

Emri "pëllumb" për të dy gratë, mendoj, iu dha nga banorët e Dodonës për faktin se ato ishin të huaja dhe dukeshin sikur nxirrnin tinguj të ngjashëm me zogjtë. Dhe nëse pas njëfarë kohe pëllumbi filloi të fliste me zë njerëzor, siç thonë, është për shkak se gruaja tashmë fliste në mënyrë që ata ta kuptonin. Derisa fliste një gjuhë të huaj, atyre u dukej se ajo shprehej si zog; sepse si mund të fliste një pëllumb me zë njerëzor?

Bibliografia: Erodoto libri "Lindja e Lashte"

Gjuha shqipe në Maqedoni nuk duhet ta humbasi statusin e saj.

Nga Zef Bushati - Tiranë

Skandal që mund të marrë përmasa të rrezikshme për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor! Ngjarje e rëndë ku mund të përfshihen shqiptarët në Maqedoninë e Veriut të mbështetur nga Shqiptarët e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, nga Shqiptarët në Luginën e Preshevës, Shqiptarët në Malin e Zi, në Çamëri e më gjere.

Në Maqedoninë e Veriut është hapur një debat jo i ri rreth statusit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare. Çështja lidhet me një vendim të pritshëm të Gjykatës Kushtetuese që do të shqyrtojë Ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili u miratua në vitin 2018 dhe garanton përdorimin e gjuhës shqipe në institucione shtetërore.

Ky ligj ka qenë subjekt i kundërshtimeve që nga fillimi, me opozitën maqedonase që e ka cilësuar atë si antikushtetues. Aktualisht, shqetësimet janë rindezur pasi gjykata pritet të vendosë për shfuqizimin e disa dispozitave kyçe të këtij ligji, gjë që mund të ndikojë në statusin zyrtar të gjuhës shqipe në vend.

Disa politikanë shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, përfshirë liderin e BDI-së, Ali Ahmeti, kanë paralajmëruar për pasoja serioze nëse gjuha shqipe humbet statusin e saj, duke e cilësuar këtë si një cenim të rëndë të të drejtave të komunitetit shqiptar si shtet formues në Maqedoninë e Veriut.

Nga ana tjetër, qeveria maqedonase ka theksuar se shqyrtimi i ligjit nuk synon heqjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, por rishikimin e disa dispozitave specifike që konsiderohen problematike.

Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve është i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit dhe të drejtave të komuniteteve etnike në Maqedoninë e Veriut, duke qenë pjesë e Marrëveshjes së Ohrit që solli paqe me luftëtarët e Ushtrisë Shqiptare në vitin 2001 pas një konflikti ndër-etnik.

Çështja mbetet ende e paqartë dhe do të varet nga vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese, i cili pritet të merret në dhjetor 2024.

Ky debat ka ngritur shqetësime për tensione të mundshme politike dhe etnike në vend nëse statusi i gjuhës shqipe ndryshohet duke çenuar statusin e shqiptarëve si shtet formues në Maqedoninë e Veriut.

La lingua albanese in Macedonia del Nord non deve perdere il suo status

Di Zef Bushati - Tirana

Uno scandalo che potrebbe avere conseguenze pericolose per la stabilità nei Balcani Occidentali! Un grave evento che potrebbe coinvolgere gli albanesi della Macedonia del Nord, sostenuti dagli albanesi della Repubblica d'Albania e del Kosovo, dagli albanesi della Valle di Presheva, del Montenegro, della Cameria e oltre.

In Macedonia del Nord è emerso un dibattito non nuovo sullo status della lingua albanese come lingua ufficiale. La questione è legata a una decisione imminente della Corte Costituzionale, che esaminerà la Legge sull'uso delle lingue, approvata nel 2018, che garantisce l'uso della lingua albanese nelle istituzioni statali.

Questa legge è stata oggetto di contestazioni sin dall'inizio, con l'opposizione macedone che l'ha definita incostituzionale. Attualmente, le preoccupazioni si sono riaccese poiché la Corte potrebbe decidere di abrogare alcune disposizioni chiave della legge, il che potrebbe influire sullo status ufficiale della lingua albanese nel paese.

Alcuni politici albanesi in Macedonia del Nord, tra cui il leader dell'Unione Democratica per l'Integrazione (BDI), Ali Ahmeti, hanno avvertito di gravi conseguenze nel caso in cui la lingua albanese perda il suo status, definendo questo un grave attacco ai diritti della comunità albanese come popolo costitutivo in Macedonia del Nord.

D'altra parte, il governo macedone ha sottolineato che la revisione della legge non mira a eliminare l'albanese come lingua ufficiale, ma a rivedere alcune disposizioni specifiche considerate problematiche.

L'attuazione della Legge sull'uso delle lingue è cruciale per mantenere la stabilità e i diritti delle comunità etniche in Macedonia del Nord, essendo parte dell'Accordo di Ohrid, che ha portato la pace con i combattenti dell'Esercito di Liberazione Albanese nel 2001, dopo un conflitto interetnico.

La questione rimane ancora incerta e dipenderà dalla decisione finale della Corte Costituzionale, attesa per dicembre 2024. Questo dibattito ha sollevato preoccupazioni per potenziali tensioni politiche ed etniche nel paese qualora lo status della lingua albanese venisse modificato, compromettendo il ruolo degli albanesi come popolo costitutivo in Macedonia del Nord.

RRËNJËT
LE RADICI

Mensile di attualità,
storia e cultura italo-albanese

Direttore editoriale: Hasan Aliaj

Sede operativa presso: Hasan Aliaj

via Principe Amedeo n. 20,

00046 Grottaferrata (RM)

Tel. +39/3335912236

hasan.aliaj@tiscali.it

redazione.rrenjet@yahoo.com

editoriarrenjet@hotmail.it

gazetarrenjet.word.pres

Capo redattore: Andrea Llukani

Capo traduttore: Valbona Jakova

Fotocronista: Ylber Gjergji

Marketing: Petrit Aliaj

Traduttori: Ana Bisholla, Lindita Ngresi.

Traduttore lingua inglese: Dr. Shpresa Fundo Gjergji

Traduttore lingua francese: Mirela Xhava Leka

Membro del giornale: Antonio Biasco,

Angelo D'Ottavi, Aurel Shtembari,

Imer Xhemail Lladrovci, Fitije Picari,

Giuseppe Chimisso, Lilly Gradilone, Lutfi Alia,

Mark Palmikaj, Dr. Adriana Qafa,

Nikollaq Doraci, Petrit Belliu, Peter Stoka

Eqerem Canaj

Direttore responsabile:

Daniele Priori

Proprietario ed editore:

Associazione "Rrenjet" - Le radici

Direzione, redazione e amministrazione:

via Principe Amedeo n. 20,

00046 Grottaferrata (RM).

Tel. +39/0683606938,

cell: +39/3335912236

Registrazione del Tribunale civile di Velletri

n. 11/2003 del 25/06/2003

Përkujdesja grafike: Botime M&B

E-mail: mbotime@gmail.com tel: +355/692068603

GLI ARBËRESHË: UN MIRACOLO ANTROPOLOGICO

INTERVENTO DEL PROF. MATTEO MANDALA'

Signor Presidente della Repubblica Italiana, Sergio Mattarella,
Signor Presidente della Repubblica d'Albania, Bajram Begaj,
Autorità civili, militari,
diplomatiche, religiose, accademiche,
scolastiche,

Signore e Signori, quando secoli fa i nostri progenitori decisero di lasciare le coste orientali dell'Adriatico non immaginavano che, una volta giunti in Italia, sarebbero diventati i protagonisti del fenomeno che Pier Paolo Pasolini ha definito acutamente il "miracolo antropologico arbëresh". Tanto meno potevano immaginare che i loro moderni discendenti, proprio perché epigoni di quel miracolo, avrebbero ricevuto il prestigioso omaggio odierno della visita congiunta dei primi cittadini dei due Paesi a loro tradizionalmente cari, l'Albania e l'Italia. Cari Presidenti, per me è un privilegio rivolgermi in nome della comunità arbëreshe di Sicilia un caloroso sentimento di ringraziamento e il più affettuoso saluto di benvenuto, *mirë se na erdhët në gjirin e Arbëreshëvet të Sicilisë!*

La storia culturale degli arbëreshë è stata considerata per lungo tempo un paradigma indecifrabile, tanto complesse, poco indagate e perciò oscure risultavano le sue implicazioni sociali, storiche e antropologiche. La definizione icastica di Pasolini, esperto tra i più entusiasti delle minoranze linguistiche in Italia, manifestava stupore dinnanzi alla sopravvivenza plurisecolare della minoranza arbëreshe, la quale pur dispersa in sette regioni dell'Italia meridionale, si distingueva nel variegato mondo minoritario per il suo originale dinamismo. In condizioni di diaspora, gli arbëreshë, non solo mantenevano vive lingua, cultura, tradizioni, memoria del passato, ma avevano dato vita, caso unico tra le minoranze linguistiche italiane, a una moderna letteratura d'arte in lingua albanese, avviato un inedito processo di costruzione di identità, si erano impegnati da protagonisti nei Risorgimenti dell'Italia e dell'Albania, e non avevano lesinato un contributo al filellenismo greco. Per di più, opponendo un netto rifiuto alla sterile venerazione del passato, grazie al fecondo contatto con il contesto culturale che li aveva generosamente ospitati, accettarono con coraggio le sfide dei vari momenti storici al fine di cogliervi le istanze più innovative da adattare criticamente alla propria visione del futuro.

Gli studi odierni hanno dimostrato che il fenomeno arbëresh, lungi dall'essere stato frutto del caso o del miracolo, è stato invece merito esclusivo di una popolazione che, come ha più volte ribadito il prof. Francesco Altamari, nel corso di sei secoli non si è affatto limitata a "conservare", ma al contrario ha decostruito e modernizzato le componenti fondamentali della sua identità culturale ogni qualvolta che ne ha percepito la necessità. Un dato quest'ultimo già rilevato nei primi anni del secolo scorso dal poeta pianoto Giuseppe Schirò che stigmatizzò aspramente la presunta avversione al rinnovamento degli arbëreshë, per i quali rivendicò invece la forte propensione verso il progresso e l'innovazione. Non la chiusura, dunque, bensì l'apertura all'altro. Sicché l'accoglienza, il dialogo, l'inclusione, il culto straordinario per la differenza sono state le ragioni autentiche del successo degli arbëreshë. E del resto, le tracce di questa loro attitudine, probabile retaggio delle loro arcaiche origini balcaniche, si rilevano profonde e nitide in ogni sfera della loro vita sociale, culturale, religiosa, nel vestiario come nel cibo tradizionale, nelle varietà linguistiche come nella loro straordinaria produzione artistica, letteraria, iconografica, musicale, visuale. Ne sono prova inconfutabile i dati confluiti nel progetto *Moti i madh*, che le cattedre albanologiche delle Università della Calabria e di



Presidente della Repubblica Italiana, Sergio Mattarella con Presidente della Repubblica d'Albania Bajram Begaj

Palermo in collaborazione con quelle di Venezia, Lecce e Statale di Milano, con l'autorevole patrocinio del Fondo per l'Ambiente Italiano e dell'Accademia delle Scienze d'Albania, hanno elaborato congiuntamente al fine di candidare la cultura immateriale arbëreshe quale patrimonio universale dell'UNESCO grazie a una proposta

lità che, una volta superate le iniziali difficoltà, diede vita a proficui processi di integrazione. L'approdo in Italia per gli albanesi non segnò soltanto la fine del loro viaggio della speranza, ma si configurò come l'agognata conquista che li avrebbe aiutati a superare d'un colpo la prova più difficile della loro storia: schivare, per dir-



transnazionale che vede compartecipare i Ministeri della Cultura d'Italia e d'Albania

Giunti in Italia sul finire del XIV secolo, ben prima che gli Ottomani comparissero nei Balcani, gli arbëreshë si insediarono stabilmente nella Penisola soltanto verso la seconda metà del XV secolo, portando con sé, benché poveri come tutti i migranti, un grande giacimento prezioso: la forte volontà di riscattarsi e di rimbocarsi le maniche in quella che sarebbe divenuta la loro nuova Patria. In Sicilia, gli insediamenti si realizzarono in centri medievali preesistenti sortendo sulla lunga durata effetti benefici per l'economia isolana: da un lato contribuirono a invertire la tendenza disastrosa agli abbandoni rurali e, dall'altro, a offrire un nuovo e innovativo modello di sviluppo economico e sociale destinato a incrementare esponenzialmente i nuovi centri abitati, a promuovere la crescita demografica dell'Isola e a incentivare la produttività di feudi da tempo desertificati. L'innesto di nuove braccia da lavoro straniere fu accompagnato da una politica inclusiva dell'accoglienza e dell'ospita-

la con le parole del compianto Ismail Kadare, "il rischio di cadere nell'apatia, nel fatalismo, nell'ossessione" e sviluppare una formidabile e inedita cultura della resilienza.

Le vantaggiose condizioni offerte dalla nuova patria scandirono le tappe dell'evoluzione culturale degli arbëreshë. In Italia fiorì la tradizione scritta della lingua albanese, con la pubblicazione nel XVI secolo del *Messale* di Gjon Buzuku e del *Catechismo albanese* di Luca Matranga, le prime due opere pervenute. E se a Piana degli Albanesi Luca Matranga fondò nel 1592 la prima scuola che utilizzò l'albanese come lingua veicolare, nel monastero basiliano di Mezzojuso si formarono i monaci che nel XVIII secolo istituirono le missioni in Himara dotandole di scuole in lingua albanese. Memore di questa antica tradizione, la comunità arbëreshe ha rivestito il ruolo di antesignana nelle attività a sostegno del proprio patrimonio linguistico affidando alle Università italiane, che nel numero sono pari a quelle attive in Albania, l'organizzazione della ricerca e della didattica, anche attraverso l'at-

tivazione di appositi percorsi di formazione, di aggiornamento e di specializzazione per i docenti delle scuole primarie delle aree linguistiche minoritarie.

Ancora in Italia si esperirono i primi tentativi di adeguare alla disciplina cattolica la tradizione rituale bizantina. Lo spinoso problema fu affrontato dal Venerabile Padre Giorgio Guzzetta, fondatore nel 1734 a Palermo del Seminario greco-albanese, che con il Collegio di Sant'Adriano divenne la fucina dell'intelligenza arbëreshe in Italia. L'avvio di una concreta conciliazione tra le due chiese cristiane d'Oriente e d'Occidente, abbattendo ogni forma di pregiudizio e di equivoco e instaurando una innovativa, direi inclusiva, "visione organica dei problemi religiosi", come ebbe a definirla Bernardo Mattarella, fu uno dei capisaldi del pensiero teologico di Guzzetta. Più tardi, con l'istituzione a Palermo di un Vescovo ordinante per i sacerdoti di rito greco-bizantino e con l'avvio del graduale riconoscimento dello status canonico *sui iuris* per la chiesa italo-albanese, i migliori allievi arbëreshë del Venerabile Paolo Maria Parrino, Giorgio Stassi e Nicolò Chetta, non solo portarono a compimento l'originale disegno del Maestro, ma garantirono alla comunità ecclesiale arbëreshe di divenire una precorritrice dell'ecumenismo moderno, riconoscimento che più tardi le conferì solennemente il Pontefice Paolo VI.

L'apporto dato alle cause Risorgimentali costituisce uno dei capitoli più esaltanti della storia politica e civile degli arbëreshë. Tra gli artefici delle principali rivoluzioni del 1848 e del 1860, si ricordano Francesco Crispi, Andrea e Gabriele Dara, Pietro Chiara, Giuseppe Bennici, Pietro Piediscalzi, Francesco Bentivegna e, naturalmente, le popolazioni dei centri arbëreshë di Sicilia e di Calabria, che con entusiasmo sostennero la spedizione garibaldina sino al suo epilogo. L'esperienza irredentista maturata in Italia costituì il volano ideologico che permise agli arbëreshë di rivolgere lo sguardo verso i Balcani e di contribuire al raggiungimento nel 1913 dell'indipendenza dell'Albania. Di non minore spessore politico fu il movimento dei *Fasci dei lavoratori* di fine Ottocento, il primo di ispirazione socialista che si distinse in Europa per la difesa dei diritti dei contadini e per l'emancipazione politica e culturale delle classi meno abbienti e, in particolare, delle donne. Tra i più influenti organizzatori e ispiratori vi fu il medico arbëresh Nicola Barbato, immortalato nel celebre romanzo *I vecchi e i giovani* con il quale Luigi Pirandello denunciò la prima grande crisi politica ed economica dell'Italia unita. Barbato, autentico educatore dei poveri, amava arringare le popolazioni di Piana degli Albanesi, di San Giuseppe Jato e di San Cipirello nel pianoro di Portella della Ginestra, che diverrà teatro della strage mafiosa perpetrata il 1 maggio del 1947 e un imperituro monumento alle lotte degli arbëreshë contro la violenza criminale e la tutela della legalità.

Dall'alto di questa ricca esperienza storica, politica e culturale, dalla loro condizione di cittadini italiani ed europei, gli arbëreshë guardano figuciosi agli sviluppi recenti del processo di integrazione europea dell'Albania. L'auspicio che la visita dei Presidenti Sergio Mattarella e Bajram Begaj possa dare ulteriore impulso all'ingresso a tale storica opportunità per gli albanesi e, aggiungo, per i Balcani Occidentali è pari soltanto alla gioia degli arbëreshë di Sicilia e d'Italia in questa giornata indimenticabile della loro storia contemporanea.

GJORMI = GJINNIMI = GJINI IM

Nga Aljosh Korkaj – Firenze

Historiani grek dhe, njëherësh, studiues i urave të gurta, z. Spiro Mantas nga Peleponezi, në 2018, më dërgoi këtë hartë të hershme të zonës tonë. Ai kërkonte emrat e disa urave të vjetra në Lumit e Vlorës, të cilat i ka shënuar me një rreth të kuq. Teksa e kontrolloj rastësisht hartën, dalloj emrin origjinal të fshatit Gjorm = Gjinimi – Gjini im ose I imi Gjin!!

Siç dihet, mbas shek. VIII, (më saktë në vitet 904), bullgarët pushtuan Vlorën dhe Himarën. Mbas kësaj ngjarje, gradualisht, në kulturën e të folmes të familjes fisnore Gjini (Gjormi), përgjatë mijëvjeçarit në vazhdim, kuptimi etimologjik i emrit të fshatit të tyre pësoi deformimin nga: “Gjinimi = Gjini im” apo “I imi Gjin” në Gjorm! Nuk jam i sigurtë të them që, ky deformim i emrit nga Gjinimi në Gjorm, realisht, është si rezultat i dikimit sllavë (huazim përgjatë regjistrimeve kadastrale të tyre), apo për shkak të ndryshimeve gjuhësore.

Gjithsesi, rëndësi ka fakti që, rrënja “Gjini” (e cila bart kuptimin kryesor të fjalës) i jep këtë fshati identitetin e tij të mëparshëm origjinal. Këto deformime të fjalëve apo emrave janë të pranueshme, pasi kanë kaluar mbi 1100 vite, e praktikisht, gjuha e folur ka pësuar gjytime morfologjike. Konkretisht, unë, toponimin Shqefari të Velçës (i cili sipas gojëdhënave të moshuarve ka pasë qënë një toponim hyjnor me një tempull të hershëm) e gjeta nga shkoqitja e emrit Shqefar të Filatit të Çamërisë, të cilët sqaronin se: “fshati i tyre Shqefar e merr emrin nga Shënjtori Shën Stefani (Shtjefni). Pas kohës së gjatë, shkurtimi i emërimit të toponimit dhe rotacizmi në dialektin çamërisht, ku bashkëtingëllojra “n” u bë “r”, emri i fshatit është përfunduar prej formës “Shën Stefani – Shën Shtjefni” në “shqefar”. Kësisoj, edhe Gjormi i Krujës, prejardhjen e emrit të tij duhet ta interpretoj nga: “Gjinimi = Gjini im” i Gjormit të Vlorës!

Po çfarë e lidh Gjormin tonë me Gjimin dhe jo Gjonin siç hamendësohej gabimisht? Ekzistenca e emërtimeve “gjin – gjine” në fshatrat e Lumit (Velçë, Gjorm, Tërbaç dhe zonën tonë) lidhet dhe me faktin se, dikur, në jug të vendit, ka jetuar fisi epiriot i Argjynëve dhe vetë qyteti i lashtë Argjia. Çka na lë të nënkuptojmë se këto emërtime toponimesh apo fisesh janë mbetje të Argjynëve.

Ja çfarë më shkruante para disa vitesh studiuesi Mihal Jano me origjinë nga Lushnja, por që tashmë jeton në Amerikë: “...Velça juaj, në kohët antike, quhej Argjirinoi dhe banohej nga fisi epiriot i Argjynëve. Sipas Timeut, Theonit dhe Lykofronit, shkruan Stefan Bizantini kur tregon mbi qytetet dhe popujt... tek argjirinët dhe malet e pyllëzuara të Keramëve. Në lindje të Velçës, jo larg, ndodhet Mali Alkomenos, pranë tij ndodhen edhe sot rrënojat e një qyteti mjaft antik, para luftës së Trojës, që quhet Arpia – Arpija – H’Argjia dhe, sot, sipas teorive të likuideve gjendet me emrin R’Abia... Po në bazë të veçorive të teorisë së likuideve kemi dhe daljen e emrit “labëria” nga emri i hershëm i Velçës ilire, një supozim të tillë e ka hedhur edhe vetë gjuhëtari ynë i madh, Egerem Çabej... Unë (Mihal Jano), tek emri Velça, shoh shumë lidhje dhe vazhdimësi historie, por që duhen të thellohen se kemi të bëjmë me Elimejtë... Së fundmi, tek emri Velça unë dalloj një trajtë vendase të emrit sllav të një fisi antik ilir mjaft të njohur, por shoh dhe mundësinë që ky emër i latinizuar i ka dhënë emër gjithë krahinës në trajtën “labëri”... etimologjia e të cilit është për t’u kuptuar më qartë nga emri “i bardhë”, i fisit Argjinet, që jetonte këtu krahas Deksarëve, edhe ky një fis Kaon në kohët antike ...”.

Interpretimi i emërtimeve toponimike të fshatrave tona (Velçë & Gjorm) përveçse një kujtesë gjuhësore na njehe me shtratit e vjetër të përbashkët – “gjinët”. Çka vërteton zanafillën primitive të trungut fisnor, njëfarë “vëllazëri e përbashkët” apo stërgjysh i vjetër. Nëse te Gjormi kemi “gjinim”, në Velçë hasim gjithandej toponime me rrënjën e stërlashtë “gjin – gjina – dheu mëmë”: Psh: Lagjinet dhe Lagji në zonën e Presaranit; Kushgjinë; Gjinet e Xhebre; Gjinet e Krute; Muçogjin; Ndregjin; Gjini etj. Cila është origjina e kësaj fjale? E kam sqaruar te Shpella e Kushgjinës (libri, “Qytetërimi i Bardhë i Velçës”, botim i ripunuar 2022). Emër që vjen nga besimi i një miti vendas, dhe që ka lidhje shpirtërore të përbashkët me “Femënooren e Shenjtë” – Tokën Mëmë. Ndaj, Velça dhe zona e Lumit e përdorte gjerësisht dhe e fliste atë pasi e kishin trashëgimi nga të parët. Në

fund të fundit vetqusheshin Argjinë, kuptimi simbolik apo hyjnor i të cilit është: “argjinë = ar (e ndritur) + gjinë /a (gjinë e kuqe, gjinë gri, balta, dheu, toka) = Toka Mëmë e ndritur, Toka e Zotit.

Në librin “Sellenizmi – Besimi që sundon Botën” me autore Fatbardha Demi, në faqen 102



gjejmë shpjegimin: “... Ar nuk është mbaresë, por një fjalë – rrënjë e stërlashtë, e cila ndodhet edhe në fillim të emrit Arbër – Arban si emërimit i Zotit (Hyjit). Këtë na e dëshmon Petro Zheji... Rrënja e pastër Ar, në një sërë gjuhë shprehe “parim dritësor”... Te shkrimi im i mëparshëm “Realiteti Njerëzor i Gjormit”, u mundova të sqaroj se “... toponimet Dardhëz të Velçës dhe Gjormit, kanë si rrënjë fjalën “d’ard - ard”, e cila, përveçse kuptimin “e bardhë – e ndritur (ndriçuar - Ar), hyjnore”, mund të ketë patur edhe etimologjinë tjetër (siç pretendon enciklopedia franceze), që ka qënë shumë e përdorshme në zonën e Mesdheut apo atë europiane: “arth = ard = i lartë, hyjnor”. Prapë se prapë dalim te “parimi dritësor - e ndritur”... ”.

Vendbanimet paraekzistuese të fshatrave të sotëm Gjorm dhe Lepenicë ishin të ngritura në mal, zonë e pyllëzuar dhe terren shkëmbor i fshehtë. Lartësitë Dardhëz, Shënkoll, Kalibaq, ku banuan fillimisht këto fise përbënin një strukturë tipike fisnore. Nga që nuk kishin shpella sikundër Velça, ju përshtatën zakonisht së jetuari jashtë. Askush tjetër mund të hynte në jetën e këtyre fiseve. Kështu ruhej dhe homogjeniteti i racës. Në se këto vendbanime fillestare ishin një vendmbrojtje e sigurtë nga sulmet dhe rreziqet, fiset nuk siguronin dot mbështetjen ekonomike. Livadhët dhe kullotat vërtet ishin të bollshme, por vetëm sezonale. Edhe rrjeti ujor (përrenj dhe burimet) ndikohej prej kushteve atmosferike. Në se rreshjet ishin të pakta burimet thaheshin. E vetmja tokë punuese dhe uji i bollshëm gjendej buzë lumit, te Udhë e Karvanit, aty ku rreziku ishte më i madh. Nevoja e mbijetesës i detyroi të zbrisnin pikërisht aty, ku banojnë ende edhe sot.

Nga çka dëshmojnë dokumentet, Gjormi dhe Lepenica, filluar nga shek. VIII (kur bullgarët pushtuan trojet tona), ishin të ngulur aty qysh më parë. Domethënë, me përafërsi, “mosha” e fshatit të tyre është në kufijtë e 2000 vjeçarit. Ku bazohet kjo hamendje? Vite më parë, në një publikim të arkeologut Skënder Muça (i cili së bashku me një grup arkeologësh të rinj vizituan disa qendra vendbanimesh të vjetra në zonën tonë – Lumit të Vlorës) shkruante që: “... në fushën e Murës gjenden shumë gjurmë banesash të shek III – IV ... Më të vjetrat shtrihen në fushë, kurse ato të rejtat kanë patur tendencë të ndërtoheshin në faqet e kodrave...”. Mura e Velçës dhe Gjormi janë në kufi me tyre. Disa prej emërtimeve toponimike dhe ato të fiseve të këtij fshati (Gjinimi), akoma dhe sot kanë burim fetar. Konkretisht: Shënkoll – Shën Koll; Premtaj – Shën Premte; Shenaj - Shën (Santo) – i Shenjtë; Zotaj – Zot; Sinaj – Sin – Shën – i Shenjtë. Emri “Sina” personifikohet qysh në lashtësi si simbol i shenjtë. Mali Sinai në Bibël shënjohej si mali i Zotit... Ngacmimet e vazhdueshme Velçë – Gjinimi, kur ata zbritën poshtë, ishte tendenca nga shtytja e lakmisë të ekzagjeruar të tyre për shtyrjen e kufijve dhe përfitimim e tokave. Kjo lakmi pasqyrohet te legjenda e vjedhjes së malit nga Gjinimët, apo batuta e vendosjes së kufijve midis fshatrave tona. Lidhjet e gjakut (martesat) midis dy fshatrave tona janë shumta. Do e kenë komshinjtë tanë kurajon dhe dëshirën e mirë për ta fshirë emrin e deformuar “gjorm” dhe përdorur identitetin e gjenezës së tyre?

O Gjinët e hershëm! Do u duhet pak të dilni prej të zakonshmes. Rrënja e emërimit të fisit (apo fshatit) tuaj të çon thellë, në largësinë e shekujve, te origjina hyjnore e përbashkët e stërgjyshërve!

Kalaja e Teutës - Tërbaç

Nga Eduard Demo – Vlore

Gjatë ekspeditave vëzhguese, hulumtuese në lumin e Vlorës, shumë shpesh kemi hasur emërtime vendesh dhe objektsh kulturi të periudhës Ilire. Populli ynë gjatë mijë vjeçarëve, në procesin e formimit të tijë arriti të krijojë ndërgegjen e tij duke u udhëhequr nga bashkësi interesash si dhe nga një shkrirje ndjesish, qëllimesh e përpjekje të përbashkëta për trashëgiminë kulturore atë shpirtërore dhe materiale e jo vetëm. Nisur nga kjo në fshatin Tërbaç gjejmë shumë legjenda dhe toponime vendesh dhe rrënoja me emra mirëfilli shqip prej mijëra e mijëra vjetësh.. Studjuesi P.Margilaj në librin e tij “ Ilirët flasin Shqip, Shqiptarët Ilirist” shkruan se: “ Visaret historike e kulturele të antikës ilire, të derdhura dhe të copëtuara nuk ua kanë tërhequr vëmendjen shkencëtarëve e në përgjithësi as shkencës së historisë, duke u nisur nga starti i pikëpamjes të nënvlefësimit të gabuar të kaluarës së popullit shqiptar “. Në grykën e malit të Shëngjergjit te shkëmbi kuq në Tërbaç, në faqen jugore të malit është një shkëmb shumë i thepisur, me një lartësi 50-60m. Ngjitur faqes së shkëmbit është ndërtuar një mur guri i rregullt me llaç gëlqereje. Fillon në fundin e shkëmbit mbas tri-katër shkallëve të gdhendura në shkëmb, lartësia e të cilit arrinë në mbi 10 metër. Nga forma e ndërtimit të bind se ka shërbyer si mur shkallësh për tu ngjitur në majën e shkëmbit.

Quhet Kalaja e Teutës. Nga gojëdhënat mësojmë se në këtë vend ka ardhur mbretëresha e shtetit Ilir Teuta e viteve 231-228 p.e.r.. Ka fjetur dy netë dhe është larguar së bashku me shoqëruesit e saj nga rruga e cila të çon në portin e qytetit të Orikut dhe mandej ka kaluar në Itali. Referuar dokumentave historikë, mbretëresha Teuta në fillimet e sundimit të saj zgjeroi mbretërinë në jugë të Ilirise duke pushtuar Epirin, Korfuzin e deri më në jugë në gjirin e Ambrakisë. Dihet që mbretëresha u tradhëtua nga komandanti më i besueshmi dhe më i fuqishmi i saj.

Rezistenca gjashtëmujore e mbretëreshës Teuta kundër romakëve në vitet 298 p.e.s. mbas tradhëtisë, të le të supozosh për një udhëtim të tillë për negociata paqeje me romakët, në të mirë të Ilirëve të cilin ajo e arriti me sukses. Arritja me sukses e negociatave dhe imponimit të kushteve të saj romakëve, tregon se përveç takimeve diplomatike mbretëresha ka zhvilluar edhe takime të fshehta me palët armike e kufitare e më gjerë të mbretërisë. Pra udhëtimi në jugë të mbretërisë saj, për të realizuar qëllimin na jep arsye të besojmë në gojëdhënë që e gjejmë edhe sot në fshatin Tërbaç të Vlorës. Emri kalaja e Teutës nga banorët e fshatit Tërbaç është përdorur shumë herët brez pas brezi duke ardhur në ditët tona. Këtu flitet ose më saktë emërtohet një vend për një kala por në fakt pa pasur një të tillë dhe nga vëzhgimet në vend nuk ka asnjë rrënoje apo gjurmë që mund të lejojë të mendohet se ka patur një të tillë.Në pjesën perëndimore me drejtimin e rjedhjes së ujrave lindje-perëndim është përroi i thellë që sot nga banorët vendas quhet edhe përroi i zi edhe përroi i Teutës. Mbi shkëmb janë rrënojat e kishës së Shën Gjergjit. Periudha e kishës sigurisht është gati një mijëvjeçar më mbas periudhës së sundimit të mbretëreshës Teuta. Nisur nga gojëdhënat e banorëve vendas mbi shkëmbin e Kuq ka qënë një foltore. Banorët pa përcaktuar periudhë kohore historike, por qysh nga të parët tanë tregojnë se, në foltoren mbi shkëmb janë kryer rituale në përgjërime të perëndive sipas ndodhjeve të jetës së përditshme të tyre. Pra para lindjes së krishterimit, në ritualet pagane ose të tjera të vendasve aty ka qënë një foltore ku vendasit ju faleshin perëndive. Rrënojat të japin të drejtë për ta besuar këtë.

Natyrshëm lind pyetja :

- Përse Mbretëresha Teuta udhëtoi nga qyteti i Durrësit nëpër det deri në qytetin e Orikut dhe nga aty udhëtoi në këmbë disa orë së bashku me shoqëruesit e saj deri te shkëmbi i kuq në grykën e Shëngjergjit ?

- Ky vend a ishte i banuar në atë kohë, ishte pjesë e mbretërisë së saj dhe çfarë rëndësie kishte për mbretëreshën?

Po e nis shtjellimin e arsytimit për përgjigjen e pyetjes së dytë – a ka qënë i populluar ky vend ?

Nga ana lindore e shkëmbit të kuq e gjithë pllaja është me mbuluar me rrënoja shtëpish me përmasa të vogla, me mure pa llaç gëlqere dhe në të gjithë sipërfaqen ka dukshëm mbetje qeramike gjë e cila tregon se kjo pllajë ka pasur një popullsi jo të vogël . Në daljen e qafës së Shëngjergjit ndodhen

edhe dy gurë të mëdhenj me një lartësi reth 3m , njëri dukshëm i latuar nga dora e njeriut, të cilët të krijojnë përshtypjen e një vendi kontrollor ushtarak për rrugëkalimin porti detar i qytetit antik Orik dhe në brendësi të interlandit të krahinës së lumit të Vlorës me qytetet e Horës në Vranisht, të Ceries në Smokthinë, të Olimpes në Mavrovë, të kryeqendrës Amantie në Ploçe e më pastaj në thellësi të Ilirisë. Edhe në qafën e shkëmbit që përmendim më sipër kemi shumë rrënoja ndërtimeve si dhe shenjat e një ndërtese me sipërfaqe më të madhe që të jep përshtypjen e foltoreje. Në fshatin Tërbaç përveç shumë gjurmë të qeramikës janë gjetur edhe monedha antike bakri dhe argjendi të cilat përforcojnë mendimin që zona ka qënë jo vetëm e banuar por edhe ka patur veprimtari tregëtare midis vendasve dhe tregëtarëve të zonës përreth si dhe të tregëtarëve të cilët vinin nga porti detar i qytetit anti Orik. Në krahë të shkëmbit ndodhen përsëri rrënojat e një kishë tjetër e ritit kristian-ortodoks.

Përsëri një gojëdhënë e vjetër nga banorët e këtij vendi thotë se: “ Mbretëresha me shoqëruesit pruri nga pasuria e saj, diçka me vlerë të madhe në këtë vend të sigurtë, për ta pasur nën ruajtje e më pastaj u largua në drejtim të gadishullit Italian. Kuajt u ngarkuan me pasurinë te guri i Kuq, te gryka e Arapës u panë se ishin të ngarkuar dhe kur dolën në qafë të Valit të malit të Çikës ishin pa ngarkesë.” Në librin “Ilirët” të Profesor N.Ceka thuhet se: “Foinike u pushtua(nga Mbretëresha



Teuta) pasi u ble garnizoni gal prej 800 mercenarësh.” Pra një veprim blerjeje është i dokumentuar në mbretërimin e Teutës dhe mund të përputhen thënie të gojëdhënave të banorëve, pasi territori i fshatit Tërbaç ka qënë nën sundimin e saj. Dhe qyteti i Finiqit është jo largë prej aty, më në jugë dhjetra kilometra. Gryka e Shëngjergjit si kryqëzim rrugësh dhe si vend i mbrojtur nga çdo lloj sulmi agresiv është i përshtatshëm si vendpeshim apo vendbazim.

Nisur nga legjendat e thurura mendoj se emri “Kala Teuta” ka lidhje me “ka lanë Teuta”. Në dialektin Gegërisht i cili flitet edhe sot në Shqipërinë e veriut ka të njejtin kuptim me – ka lanë pra ka lënë diçka. Dhe që të trashëgohet e thëna, ndër mijëra e mijëra vjet ajo duhet të jetë si veprim i një figure të shquar. Prania e rrënojave të një foltore të bind që edhe ambiente të tjera akomoduese të denja për strehimin e një mbretëreshë në fshatin Tërbaç duhet të këtë pasur. Kjo duhet studjuar nga specialistë të mirëfilltë të fushës së arkeologjisë, historisë dhe të folklorit bashkarisht edhe me studjues të gjuhësisë për prejardhjen e fjalëve dhe toponimeve të vendeve që fatmirësisht ndryshe nga gjithë krahina e Lumit të Vlorës, nuk janë të mpleksura me emërtimeve sllave të shekujve 8,9,10 të e.s si dhe turke të viteve në shekujt 16,17,18. Gjurmët janë aty. Gjithkush mund ti shohë!

Literatura:

- A.Biagini – Historia e Shqipërisë; Botimet-Shtëpia e librit dhe e Komunikimit - Tiranë 2000.

- N.Ceka – Ilirët; Botimet Ilar; faqe 103- Tiranë 2001.

- M.Korkuti – Parallirët, Ilirët, Arbrit; faqe 28 - Botime Toena – 2003.

- P.Margilaj – Ilirët flasin Shqip, Shqiptarët Ilirist; faqe 329 – Botimet Montenegro-publik-Podgoricë – 2001.

- P.Thëngjilli – Historia e popullit Shqiptar; faqe 29 – Botimet Shtëpia e Librit Universitar 1999.

- S.Fraseri–Vepra II - “Shqipëria ç’ka qënë ç’është dhe ç’do të bëhet –faqe 23; Akademia e Shkencave e RPS-SH – Instituti i Historisë – Tirane 1988.

- Zh. Klod Faverial – Historia e Shqipërisë : faqe 66 – Botimet Plejad – 2004.

- Akademia e Shkencave të RSH – Historia e Shqipërisë – Instituti i Historisë; faqe 84,109 - Botimet Toena 2002.

- Akademia e Shkencave e RPSSH – Shqiptarët dhe trojet e tyre – Botimet M.Duri Tiranë 1982.

KANDAVIA: TREVA, MALET, RRUGA DHE TEMPULLI DIANA I KANDAVIA

Nga Prof. Lutfi ALIA, Siena – Itali

Në dorëshkrime, në kronika, në veprat historike, në vepra letrare, në hartat antike, në dokumenta kishtarë, Kandavia rezultoi emër treve - Candavia; emër mali - Candavii Mons (Malet e Kandavias); emër tempulli - Diana Candaviense dhe emëri i rrugës së lashtë - Via Candaviense, që fillonte në Durrës, përshkonte tërthorë Epirin e Ri, kalonte përmes trevës malore të Kandavias, kalonte në Ohër e Manastri dhe pasi zbriste në Selanik, vazhdonte dhe arrinte në Bizanc.

Origjina e emrit Kandavia e trevës.

Sipas historianëve dhe arkeologëve N. Ceka dhe L. Papajani: **Kandavia ishte emri i lashtë i Ilirisë.** [Neritan Ceka, Lazër Papajani. *Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike. Revista Monumentet 1971, Nr. 1, f. 43.*]

Sipas historianit Luigi Bossi: “Emri Kandavia është shumë i vjetër, vjen nga kohët e lashtësisë, me origjinë nga gjuhët sanskrite dhe pellazge, i ruajtur si toponim në Albania”. [Luigi Bossi. *Quadro Geografico-fisico e storico-politico di tutti i paesi e popoli del mondo. Edizione Carlo Bertoni, Milano 1829.*]

Në se marrim në konsideratë mendimin e historianit Luigi Bossi, i cili thekson origjinën sanskrite të emrit Kandavia, duhet të pranojmë se Kandavia ekzistonte në vitin 1900 para K, pra rreth 4000 vite më parë.

Emri Kandavia lidhet me legjendën e Dardanit dhe Kandavia (Harmonia). Sipas mitologjisë, mbreti Korito i Tegea, i martuar me Elektra, e bija e Atlasit me Pleiona, kishin katër djemë: Iasio, Dardani, Italo, Sikano dhe vajzën Kandavia. [Pseudo-Apollodoro, *Biblioteca III, 5 e 4, 10, 1.*]

Bokaçio shkruan se motra e Dardanit ishte Kandavia, bijtë e Korito: “Huic Iasius frater, esto sint qui addant Ytalam et Sycanum atque Candaviam sororem; et cum Coritho sola civitas”. [Giovanni Boccaccio. *De Genealogia Deorum Gentilium. Libri VI. Tradotta ed adornata Messer Giuseppe Betussi da Bassano. 1547, Ripubblicata da Edizione Gius. Laterza & Figli. Bari 1951, f. 107.*]

Diodor Sikulo tregon tjetër varjant. Pasi lindi djalin Ytalo, Elektra pati lidhje të fshehta dashurore me Jupiterin, me të cilin lindi tre fëmijë Iasio, Dardani e Kandavia. Pas vdekjes të mbretit Korito, pretendenti i fronit ishte Iasio, por Dardani ambicioz, për të zënë fronin, e vrau vëllanë Iasio. Ky akt kriminal e revoltoi popullin, që u ngrit kundër Dardanit, i cili për t'i shpëtuar ndëshkimit, mori disa anije e bashkë me Kandavian dhe me mbështetësit e tij besnikë, zbarkuan në Samothraka. Më pas Dardani zbriti në Helespont dhe trojet që i pushtoi, morën emërin Dardania. Në Helespont Dardani ndërtoi një qytet të ri dhe një kështjellë të madhe. [Diodoro Siculo. *Bibliotheca Historica, libri V, f. 47-48.*]

P. Peruxhino, bazuar në kronikat e Eusebio di Cesarea, ipeshkëvi i Çesarea (260 - 339 pas K) [Chronicon id est temporum brevium], thekson se ngjarjet e Dardanit dhe Kandavias, kanë ndodhur në kohën e Moisiut dhe kur në Argo mbretëronte Steleni e në Frigia mbretëronte Tantalos, periudhë kohe që përkon rreth vitit 1300 para K. [Paolo Peruginò. *Collectiones. Trattato di Mitologia. Edizione anno 1340.* Atë kohë, Kadmo, i biri i mbretit Agenore në Tiro, ishte nisur në kërkim të motrës Europa, që e kishte rrembyer Zeusi. Kur arriti në Samothraka, Kadmo njohu dhe u dashuroi me Kandavian. Këtë lidhje dashurore e shfrytëzoi Zeusi, i cili i propozoi Kadmos martesën me Kandavian, me kusht, që ai t'i ndërpriste kërkimet për të motrën Europa. Kadmo e pranoi këtë kompromis dhe u martua me Kandavian. Në dasmën e tyre, Zeusi dërgoi 12 hyjnë të Olimpikut. [Pierre Grimal & A. R. Maxwell-Hyslop. *The Dictionary of Classical Mythology, 1996, p. 230.*]

Kur Samothraka u shkatërrua nga Dionisi, Kadmo me Kandavian dhe fëmijët, u detyruan të ikin e pas një udhëtimi mundës, arrijtën te fisi ilir i Enkelejeve, i cili atë kohë ishte në luftë me fiset fqinje. Gjatë lutjeve të enkelejeve në tempull, orakulli u tha se, me në krye Kadmon, do ta fitonin luftën dhe atëhere populli e emëroi komandant të ushtrisë dhe pas fitores, Kadmo u bë sovran i Enkelejeve. Në nderim të kontributit të Kadmos, trevën veriperëndimore të mbretërisë të Enkelejeve e quajtën me emërin e Kandavia (Candavia) dhe vargmalin në lindje të trevës me emrin Malet e Kandavias - Candavii Mons. [Karl Patsch. *Ilirët. Viena 1923.* [Maria Rocchi. *Kadmos e Harmonia. Un matrimonio problematico. Roma, L'Erma di Bretschneider, 1989, pp. 21-30*]

Në moshë të avancuar, Kadmo me Kandavia lindën një tjetër djalë, Ilirin (Illyrios). Sipas mitologjisë, Iliri u bë mbreti i fiseve Liburne, me kryeqendër Rizonin. [Francis Vian. *Les Origines des Thèbes. Cadmos et les*



Tabula Peutingeriana me rrugën Egnacia, ku janë shënuar stacioni Ad Dianam në rrjedhën e sipërme të lumit Shkumbin dhe simbolet e tempullit Ad Dianam i Kandavias dhe i tempullit Ad Dianam në Butrint.

Spartes, *Klincksieck, Paris 1963.* [Apollodoros & Hard, 1999, p. 103 (Libri III, 5.4)].

Historianët Wilkes, Middleton dhe Jacques, theksojnë se mbreti më i hershëm i Kandavias ishte Iliri, i cili vdiq në vitin 1225 para K. Nga kjo kohë, bashkësia e popujve të epokës të hekurit në trojet ku mbretëroi Iliri, morën emrin e tij Iliria (për grekët Ἰλλυριοίς, për romakët Illyricum). [John Wilkes, *Gli Illirici, Genova, ECIG, 1998*] [John Middleton, *World Monarchies and Dynasties - 1st. Edition, Routledge, New York 2015, p. 428*] [Edwin Jacques. *The Albanians: An Ethnic History from Pre-Historic Times to the Present, 1995, p. 124*]

Ovidi, tregon varjant tjetër. Kadmo dhe gruaja Kandavia, të lodhur nga peripecitë dhe fatkeqësitë në fisin e tyre, e braktisën Tebën dhe shkuan në Beoci. Pas shkatërrimit të pallatit mbretëror nga Dionisi, Kadmo dhe Kandavia shkuan të jetonin në Iliri. Në ditët e fundit të jetës, Kadmo mori përsipër mëkatet dhe gabimet që kishte kryer në jetë, andaj si vetëndëshkim kërkoi të shndërrohej në gjarpër, ashtu si kishte parathënë orakulli Febo i Delfit, pasi Kadmo kishte vrarë gjarpërin gjigand (dragan). Kandavia nuk e braktisi bashkëshortin, por shkoi pas tij, duke u shndërruar në gjarpër e të dy shkuan të jetonin në thellësi të pyjeve të maleve Kandavias ilire. [Publio Ovidio Nasone. *Metamorphosis: IV, 562 - 8.*] [Roberto Calasso. *Le nozze di Cadmo ed Armonia. Milano, 1991, p. 20 - 280.*]

Treva Kandavia.

Në shekullin VII - V para K, Kandavia ishte provincë e mbretërisë ilire të Enkelejeve; në fillim të shekullit IV para K u pushtua nga Ardianët, në gjysmën e dytë të shekullit IV para K u pushtua nga Taulantët, ndërsa në fund të shekullit III para K, u shpëput nga mbretëria e Taulantëve dhe kaloi në bashkësinë ilire të Parthinëve. [Myzafer Korkuti. *Revista Pera; Viti X 2005. Nr. 2, f. 32-45.*]

Në vitin 168 para K, trojet ilire u pushtuan nga romakët dhe me organizimin e ri të territoreve, romakët ia ndryshuan emrin Kandavias duke e quajtur Kunavia. Senati i Republikës Romake, ashtu si bashkësia të tjera fshatare (Civitates rurales) dhe Kandavias - Kunavisë në Epirin e Ri në Provincën Illyricum, i njohu statusin e principatës autonome, të qeverisur nga veteranët e legjioneve romake, por jo nga dinastët vendas.

Ciceroni (Marcus Tullius Cicero), në një letër dërguar Atikut më 28 maj 58 para K, e njoftonte se fillimisht donte të kalonte përmes maleve Kandavia të Epirit, por udhëtimi nëpër Kandavia ishte i vështirë, andaj pranoi këshillën e kuestorit Gneus Plancio dhe së bashku udhëtuan nëpër *via militaris - rruga e ushtrisë*”. [Marcus Tulli Ciceronis. *Epistulae Tomus III: Epistulae ad Atticum. Oxford Classical Texts, Calderon Press 1982.*]

Sipas Strabonit (60 para K - 24 pas K) “Kandavia ishte treva malore e Ilirisë lindore, e banuar nga parthinët. Luftat dhe revolucionet e kishin shkatërruar atë vend, sa shume fshatra ishin shkretuar, aq sa për shumë vite nuk mundën të rindërtohen. Quod est Candavia - kjo është Kandavia dhe vargmalet në

lindje quhen Candaviae Montes, ashtu dhe rruga që përshkonte trevën quhet Via Candavia. Ky rrugëkalim i lashtë, në shekullin II pas K, u quajti rruga Egnatius. [Straboni: *Geographica, libri i 7°, 7,6.*]

Në vitin 48 para K, Jul Çezari tregon se gjatë marshimit për në Maqedoni, kapërceu lumin Emathia në Kandavian e banuar nga parthinët... *praesidium que ibi Parthinorum habitat.* [Julius Cesare. *Commentarii de bello Gallico e bellis civilis*, lib III, p. 79. *Venetis 1783.*]

Marcus Junnius Brutus e përmend trevën e Kandavias në letrën dërguar Ciceronit me 19 maj të vitit 43 para K, me të cilën thekson se e kishte shkruar letrën, kur u largua nga një kështjellë e Kandavias së poshtëme: *ex castris ad imam Candaviam.* [Clarke Martin Louther. *The noblest Roman: Marcus Brutus and his Reputationa. Cornell University Press 1981*]

Seneka (4 para K - 50 pas K), tregon se Çezari marshoi nëpër terrenet e thyera malore të Kandavias, ku kapërceu lumin Emathia. [Lucius Annaeus Seneca. *Tutte le opere. Dialoghi, trattati, lettere e opere in poesia. Editore Bompiani. Milano 2000.*]

Historiani romak Lukani (39 - 65 pas K) thekson: “Çezari marshoi drejt lindjes në rrugën e vjetër (Via Vetus), ku kapërceu lumin Emathia të Kandavia, duke kaluar nëpër terrene të thyera me male të larta e gryka të thella: “Qua vastos aperit Candavia saltus, contigit Emathiam, bello quam fata parabant. [Marcus Annaeus Lucano. *Bellum civile - Pharsalia, vol. II, p. 24.*]

Si në antikitet dhe në mesjetë treva herë quhej me emrin e lashtë Kandavia, pas pushtimit romak përmendet me të dy emërat Kandavia - Kunavia, por shpesh quhej Kunavia, si rezultoi në kronikat bizantine të Gjergj Akropolitit, kur përshkruan kufirin verior të kësaj treve të gjërë (*emensa*): “Dyrrachique negotiis compositis, in viam deducor, & Chunavia emensa & mument, quam Malam Petram cognominant, permeans, Matem progredior, inde que Derbem appello cum universis ...” [Georgii Acropolitae, *Historia bizantinae. Venetiis. Ex Typographia Bartolemei Javarina. 1229, XX, 17. Doc. 39, f. 59 - 60.*]

Johann George von Hahn, pasi vizitoi Martaneshin në vitin 1849 shkruan: “Kjo pamje malore e Martaneshit, që është fqinje me Mollagjeshin, formon hyrjen e pjesës perëndimore të Kandavias së vjetër.”. [Johann George von Hahn. *Albanesische Studien. Jena Verlag von Frodrich Mauke. Edit. in Vienna. 1854, f. 240.*]

Kandavia - Kunavia kishte shtrirje të gjërë. Kufiri verior ishte Mala Petra - Guri i Keq i fshatit Shkalla (Guri i Bardhë), Klosi, Plani i Bardhë (Piana Bianca), Bulqiza, Martis - Martana (Martaneshi); Çermenika; në perëndim Tomadhea dhe Benda; në lindje Ternova, Gryka e Vogël; në juglindje Golloborda, Ohri (Lychnides), Pogradeci; në jug Librazhdi (Liberars), Qukësi, Prrenjësia, Bërzeshia, Mokra; në jugperëndim Mollagjeshi, Labinoti, Shmili, Polisi dhe Elbasani.

Vargmalet Kandavia - Candaviae Montes.

Straboni (60 para K - 24 pas K), thekson: Quod est Candavia - kjo është Kandavia dhe vargmalet në lindje quhen Candaviae Montes - Malet e Kandavias. [Straboni: *Geographica, libri i 7°.*]

Plini i Vjetër (23 - 79 pas K), duke përshkruar Kandavian, tregon “Malet Kandavia shtrihen 78 milje në lindje të qytetit Durrësit (78 milje-115 km)”. [Gaius Plinius Secundus: *Naturalis Historiae, Libri 3, 23, p. 26.*]

Vargmalet Kandavia shtrihen në lindje të trojeve të Parthinëve ndërmjet lumit Mati dhe Drini i Zi, fillojnë me malin e Bardhë në Bulqizë (Mons Bianca), vazhdojnë me malet e Lopës, Dhoksit, Gretës, me vargmalet në lindje të lumit Shkumbin me malet e Shebenikut, të Bërzeshitës, Përrenjësia, Pishkashit, të Qaf Thanës dhe përfundojnë me malin e Thatë dhe Malin Bagora në jugperëndim të Pogradecit, me kufirin jugor trojet e fiseve Dasarete, si e përshkruan Ana Komnena në vitin 1148 në veprën “Alessiade”. [Anna Comnena, *Alessiade. Ediz. italiana 1846 - 1849, Biblioteca Laurenziana Firenze pag. 120.*]

Rruga Kandavia - Via Candaviense.

Në antikitetin para romak, rrugëkalimi që niste në Durrës dhe përshkonte tërthor Ilirinë, fillimisht njihej me emrat Rruga e Vjetër (Via Vetus) dhe Rruga e Ushtrisë (Via Militaris, si tregon Ciceroni), ndërsa sipas Strabonit (60 para K - 24 pas K) kjo rrugë quhej Via Candavia. [Straboni: *Geographica, libri i 7°.* Nga shekulli II pas K, romakët e quajtën Via Egnatia (Egnacia), me emrin e Gnaeus Egnatius, konsulli romak i Maqedonisë, i cili drejtohej punimet e kësaj rruge të lashtë transperandorake. Rindërtimi i kësaj rruge nga romakët filloi në vitin 146 para K dhe përfundoi në shekullin II pas K dhe ishte e gjatë 1120 km. Ky rrugëkalim pasi përshkonte tërthor Epirin e Ri (Durrës, Peqin, Elbasan, Qukës, Ohër, arrinte në Manastir (Heraklea Lynkestidos), zbriste në Selanik dhe përfundonte në Bizanc. [Michele Fasolo, *La Via Egnatia I, da Apollonia e Dyrrachium ad Heraklea Lynkestidos. Istituto grafico Editoriale Romano. II edizione Roma, 2005*]

Rruga Egnazia fillonte me dy degët, njëra niste në Apolloni, tjetra në Durrës dhe pasi bashkoheshin në Clodiana (Peqini), vazhdonte me një trase, arrinte Nimfeun dhe termat e stacionit Mansio Ad Quintum (Bradashesh), përshkonte përmes kështjellën Scampa. Në lindje të Elbasanit kalonte para Teqes së Mansit të sotme, ku ngrihej stacioni Mansio Hiscampis; vazhdonte buzë lumit Shkumbin (Genesis) dhe nëpërmjet urës (Ura e Haxhi Beqarit), ngjitej shpatit verilindor të Polisit dhe më pas zbriste në stacionin Grandavia, që përkon me Rrafjet e Spatharit. Traseja e rrugës Egnacia arrinte në stacionin Tres Tabernas (Qukësi - sipas Burdigala), që ishte tip bujtine, më tej vazhdonte në stacionin Pont Servilio (Uraka), kalonte anash Përrenjësia, përmes fushës së Domozdovës dhe arrinte stacionin Claudanon në Qafë Thanë, më tej zbriste në Ohër (Lychnidòs) dhe vazhdonte për në Manastir (Heraklea Lynkestidos).

Emri Mansio (shumës Mansiones) është latinisht Mansus e do të thotë bujtinë, stacion shërbimi, të ngritura në distanca 12 - 18 milje larg njëri tjetrit gjatë rrugës Egnacia. Në periudhën perandorake shërbënin si stacione poste, ku udhëtarët pushonin dhe ndërroinin kuajt, për të ndjekur rrugën deri në Bizanc. Ndërmjet dy stacioneve Mansio ishin Mutationes, ndërtesa me destinacion ndërrimin e kuajve dhe taverna, si ai në Qukës - Mutationes Tres Tabernas. Ekzistenca e Mansio në rrugën Egnacia, ruhet në toponomastikën e trojeve të Kandavias së lashtë, ku rezultojnë disa toponime Mansi, si Mansi i Durrësit, Mansi në Peqin, Mansi në dalje të Elbasanit etj. Me shthurjen e sistemit skllavopronar dhe pas shkatërrimeve që shkaktuan dyndjet barbare në shekujt IV - VI pas K, rruga Egnacia e humbi rëndësinë e saj ekonomike dhe strategjike, pra e humbi rolin, që historia i pati njohur asaj gjatë periudhave të herëshme ilire dhe më pas gjatë sundimit të romakëve.

Tempulli Diana i Kandavias. (Dianae Augustae Candaviensis).

Banorët e Kandavias së lashtë ishin pagan dhe nderonin hyjnë të veta në tempuj të shumtë, ndër të cilët ishte tempulli i Thana/Zana - hyjnesha e pranverës. Në periudhën helene tempuj e Thana/Zana ilire nuk u shkatërruan, por u përshtatën hyjneshës Artemisë. Edhe romakët nuk i shkatërruan tempujt e Thana-Zana, as tempujt e Artemisë, por i përshtatën hyjneshës së pranverës Diana romake. Historiani R. Del Ponte thekson: “Gjatë sinkretizmit fetar në periudhën e Romës imperiale, hyjnesha Diana u identifikua me hyjnë femëra orientale, dukuri që ndodhi dhe me ilirët”. [Renato Del Ponte. *Capitolo V: Nostra signora delle selve, in opera “Dei e miti italici” Genova, ECIG, 1985, pp. 159 - 197.*]

L'AQUILA A DUE TESTE SEGUE IL SOLE E IGNORA PER CREDEMZA LA LUNA

(Architetto Arbëresë është colui che si adopera per dare forma ai sogni immaginati nei pascoli infiniti)

(Iatrò i thë bënurvàtë Arbëresë, hëstë kusë shiurbënë sant bëgnë thë hëndurvàtë thë haretë pà mòtë)

Di Atanasio Arch. Pizzi Basile - Napoli

Stati, Regni, Imperi e Ambiti di Credenza, tutti, hanno utilizzato quale emblema identificativo, "l'aquila bicipite", per inviare messaggio di luce costante e indivisibile, irraggiamenti che davano l'orientamento per lavia seguita anche dagli arbëresë dal XIII secolo, non volendo seguire gli impositori di credenza altra con lumi e apparati notturni con lo sfondo annerito. A tal proposito si vogliono evidenziare le attività che abbracciano nuovi stati di fatto, avuto inizio nel breve come studente, poi in veste di tirocinante e, da oltre due decenni, professionista ricercatore di ambiti costruiti per essere vissuti dagli arbëresë quale unico e solo ricercatore. Queste attività, per una combinazione di fatti e concatenamenti di cose della vita, sono avvenute sotto il rigido e vigile controllo dell'aquila bicipite che a Napoli è apposta in diverse forme, dimensioni e luoghi. Due per tutte, sono quelle apposte per vigilare sul centro antico di Napoli:

- la prima a Castel Capuano che mira ad est;
- la seconda a Castel Sant'Elmo che guarda a ovest;

Entrambe avvolgono con il loro sguardo il costruito storico della Napoli, Greca, Romana, Bizantina, Araba, Alessandrina, Ispanica, Francofona e tutte le comunità che qui approdarono con l'intento di valorizzare cultura e credenze, in fraterna convivenza, scolpita nelle righe che formavano i due semestri del Calendario Marmoreo del popolo che faceva la credenza partenopea. I fatti che si articolano in un arco temporale di oltre quattro decenni, di lettura e visione dei luoghi, hanno avvio, non per volontà, ma per una combinazione di fortuiti fatti che analizzati ad oggi danno una prospettiva non casuale alle tappe perseguite. Tutto ha inizio, il "17 Gennaio del 1977", giorno della partenza per intraprendere gli studi universitari, trasferitomi all'università di Napoli, Federico II da quella di Reggio Calabria, nelle discipline sempre dell'architettura. La sera del diciassette gennaio quando giunsi a Napoli mi insediai, in Via Tribunali al numero 247 al primo piano. La mia stanza aveva un duplice affaccio, una sulla via tribunali, un tempo detta del Sole e della Luna e, l'altro su Piazzetta Sedil Capuano, contornato da una lunga



Il momento dell'apprendimento dell'arte arbëresë.

balconata, che affacciava sui due toponimi citati. Lo spigolo i ruitojtë, mirava ad ovest e centrava l'ingresso di Castel Capuano, che celebra l'imperatore Carlo V d'Asburgo vittorioso a Tunisi nel 1535 e, una grande "aquila bicipite" di pietra è apposta a memoria e mira della vastità del regno, dove il sole non tramontava mai.

Ed è qui che iniziarono le mie ricerche da studente, parlante e uditore Arbëresë, avendo avuto come incarico dalle genti del mio luogo natio, di tornare un di e riferire, del costruito storico alle nuove leve, onde evitare le incertezze di orientamento, civile e religioso avute qui luogo nel corso della storia. A tal fine, sono state svolte indagini documentali poi rilette sul campo il loco, evitando di allestire incertezze similia quelle della storia di Romani che nel XVIII secolo videro nascere le "diplomatiche della storia", o più comunemente "la diplomatica"; la disciplina che si occupa dello studio critico dei documenti storici, specie gli ufficiali o legali, per verificarne autenticità, datazione, contenuto, origine e contesto. Un campo della storia che si sviluppa all'interno della paleografia e della filologia, con l'obiettivo di comprendere meglio le funzioni delle istituzioni tutte, oltre il maneggiamento del potere nel tempo. I di cui aspetti chiave sono qui riportati:

- Analisi della forma e del contenuto: La diplomatica esamina come i documenti sono strutturati e redatti, valutando aspetti come la calligrafia, i sigilli, le formule utilizzate, e il linguaggio formale per riconoscerne autenticità e originalità.

- Datazione e autenticità: Stabilire la datazione esatta dei documenti è essenziale per capire il contesto storico, studiando eventuali falsificazioni e alterazioni.

- Contesto di creazione: La diplomatica consi-

dera il contesto in cui i documenti sono stati prodotti, i soggetti coinvolti, il pubblico destinatario, e lo scopo che potevano servire.

- Evoluzione delle pratiche documentarie: Analizzare i cambiamenti nei formati e nelle convenzioni dei documenti è utile per comprendere le trasformazioni delle istituzioni politiche, giuridiche e sociali. Essa per questo è stata fondamentale, quando ho assunto il ruolo di storico, utilizzando i documenti come fonti non univoche per ricostruire eventi, pratiche giuridiche, rapporti di potere e dinamiche economiche, sociali e soprattutto del suo costruito di luogo. Allo scopo è diventato fondamentale l'analisi visiva dei luoghi e la definizione di un modello di ricostruzione per i centri abbandonati, secondo le disposizioni e gli usi delle genti che si affidavano al modello consuetudinario di Famiglia allargata Kanuniano, o meglio architettura del bisogno, nota come vernacolare. Ovvero ritrovare quanto in comune accordo con le genti indigene, i nuovi arrivati prima bizantini, poi francofoni di radice cistercense e poi Arbëresë di radice Ortodossa, svilupparono il modello urbano policentrico, oggi noto come "Città Metropolitana".

In tutto quattro rioni tipici, a cui erano associate le pertinenze o meglio cunei agrari della produzione e della trasformazione agro, silvicola e pastorale, l'industria dell'epoca. Per questo nel corso della ricerca sono state intercettate le esigenze della ai tempi della Sibari Fannullona e dei relativi cunei agrari, la terminazione della diocesi di Thurio e la spartizione dei demani a cui faceva seguito, l'istituzione di della diocesi di Bisignano e delle sue pertinenze di confine con quella di Rossano, dove si legge per la prima volta del Casale Terra di Bisignano, che poi ne IX secolo, diventa di Sofia Bizantina. Seguendo un itinerario storico della macroarea di Terra Giordana poi di Calabria Citeriore, intercettando le dinamiche di spartizione e utilizzo, dei relativi sistemi insediativi e di credenza. Una volta acquisiti questi dati generali si è passati all'analisi dei casali oggi Katundë di radice Arbëresë, anche se l'analisi sia dei sistemi urbani che degli elementi modulari in continua evoluzione, intrecciati con i rotacismi linguistici della toponomastica restituiscono il percorso evolutivo che non lasci emergere né ombre né dubbi o velatura di genere. Un percorso urbano fatto in continuo affiancare e mai sovrapporre, necessita consuetudinaria e di credenza, le une alle altre, ma contribuendo alle necessità delle genti qui giunte per secoli, in tutto luoghi e modelli di vita sociale, oggi, solidi esempi di integrazione mediterranea, tra i più solidi dell'antico continente Europeo. Tutto questo oggi consente, seguendo un protocollo di indagine che tiene conto degli intervalli storici, seguendo le necessità degli uomini, in tutto eventi

naturali o indotti dagli uomini. Prima di tutti il permesso di costruire e tramandare discendenza, poi gli eventi naturali, come carestie, pestilenze e terremoti, senza tralasciare carenze geologiche innescate e poste in essere per la trascuratezza degli uomini.

Il susseguirsi di quanto accennato, ha prodotto abitazioni di tipo estrattivo o deperibile in prima istanza, a cui seguirono residenze additive, con l'uso di adobe a cui seguirono quelle più solide di materiali locali non più deperibili, in tutto architettura del bisogno vernacolare. Va in oltre rilevato che sino al XVII secolo la statica di questi moduli abitativi lasciava molto a desiderare, e quando si manifestavano eventi tellurici le carenze strutturali emergevano tutte, solo dopo il terremoto del 1783 si ebbe una svolta che dava risposte più certe alla metodologia di assemblare e coprire i moduli denominati Kalive, Moticellje e Katoj. Gli stessi che garantivano abitabilità in forma monocellulare un solo livello terreno, incastonati nei declivi naturali, poi elevati e, frazionati con i profferli, a cui seguirono le tipologie edilizie dei palazzi nobiliari, gli stessi che divennero esempio da riprodurre come linee e contenuti architettonici nei prospetti principali, specie, per le medio famiglie in crescita economica che, palesavano la loro scalata economica, esponendo i noti ingressi contornate dalle due finestre, con elementi in pietra con architrave ad arco la cui chiave esprimeva gli emblemi distintivi della famiglia e, con la porta di accesso in legno pregiato. Lo studio dello sviluppo urbano ha reso possibile unificare e uniformare la radice distintiva degli arbëresë che giunsero nel meridione Italiano grazie a un accordo preventivo tra i facenti parte l'ordine del drago. E quanti fanno uso del "dicta delle migrazioni numerate" come si fa con le cose che possono apparire simili commette un grave errore. La migrazione per necessità e tutela della propria radice identitaria è una sola, inizia nel 1470 e finisce nel 1535, le altre, non sono altro che impegno di necessità di regia locale o accomodamento di esigenze e finalità altre. Infatti analizzando le varie epoche attraverso "la diplomatica" si intercettano ragioni ed esigenze, che non sono le stesse per le quali gli arbëresë, approdarono nelle rive dell'Adriatico e dello Jonio, alla ricerca della sospirata terra parallela a loro suggerita.

P.S. Oggi il pensiero va a solo unico e completo letterato; il primo della cultura arbëresë, P. Baffi, trucidato per il suo ingegno e ad A. Pizzi, mai nata per impedirle di fare cose buone.

Miestëri Ndonj, Geleu Saturë, Zoti Janarë i geshiurë e Gjuanj Sakëstanz pà truë, con i loro discepoli e magare infedeli, dovranno un giorno rispondere a nostro signore, in perenne attesa, per il male fatto alla piccola Regina, mai nata.


"Miss Mary Edith Durham, Mbretëresha e Maleve (1863-1944)"

Nga Andrea Llukani - Tiranë

Në kuadër të 80-vjetorit të vdekjes së Mary Edith Durham, Muzeu Historik Kombëtar dhe Bashkia Përmet hapën ekspozitën me titull: "Miss Mary Edith Durham, Mbretëresha e Maleve (1863-1944)". Ekspozita u organizua në ambientet e Qendrës Kulturore Multifunktionale "Odhise Paskali". Në ceremoninë e çeljes së ekspozitës, përshëndetën Znj. Elsjona Kote, Drejtoreshë e Muzeut Historik Kombëtar, kryetarja e Bashkisë Përmet, znj. Alma Hoxha, Kastriot Bezati dhe Andrea Llukani.

Kjo ekspozitë na sjell një pamje të paharrueshme të jetës dhe veprës së Edith Durhamit. Ajo ishte një udhëtare e pasionuar, e cila dokumentoi me skica dhe fotografi jetën dhe kulturën e malësorëve shqiptarë. Edith Durhamit e kishte origjinën nga një familje e madhe dhe e pasur nga veriu i Londrës. Ajo ka ndërmarrë shtatë udhëtime nëpër vendet e Ballkanit, mbresat e të cilave i ka hedhur në librat që ka botuar.

Udhëtimi i parë (1900-1901). Pas vdekjes së babait, Durhamit i'u desh të kujdesej për vite me radhë për nënën e sëmurë. Në moshën 37-vjeçare, e këshilluar nga mjeku i saj, ajo shkoi për pushime jashtë vendit për t'u qetësuar. Me anë të detit, duke u nisur nga Anglia deri në bregun e Dalmacisë, duke udhëtuar nga Trieste në Kotor, më në fund shkoi në Cetinje, kryeqyteti i Malit të



Zi. Kjo pjesë e vogël dhe e harruar e botës do t'i linte mbresa të thella.

Udhëtimi i dytë (1902-1903). Pasi kishte mësuar pak serbisht dhe shumë më tepër për historinë e Ballkanit, Durham bëri një udhëtim

në Serbi për të mbledhur të dhëna për librin e saj të parë, "Përmes trevave të Serbit" (Through the Lands of the Serb), Londër 1904. Në libër përfshihen edhe rrëfimet për vizitat e saj në Shkodër dhe në Kosovë. Qenë udhëtime, që kërkonin guxim dhe këmbëngulje të madhe, sidomos për një femër, që udhëtonte e vetëm.

Udhëtimi i tretë (1904). Në fund të vitit 1904, Edith Durham u kthye për një qëndrim pesëmuor në Ballkan, ku punoi për Komitetin Humanitar Maqedonas (Macedonian Relief Committee). Mbresat e këtij udhëtimi përshkruhen në librin "Bregua e Ballkanit" (The Burden of the Balkans), Londër 1905. Në libër përfshihen edhe rrëfimet udhëtimet të saj të parë në Shqipërinë e Jugut dhe të Mesme; Nga Manastiri në Korçë, Leskovik, Përmet, Pojan, Berat, Mirditë, Tepelenë, Elbasan e Shkodër.

Udhëtimi i katërt (1906-1907). Në vitet 1906-1907, Edith Durham udhëtoi në Mal të Zi dhe Bosnje-Hercegovinë për të mbledhur materialin etnografik, që u botua shumë më vonë në librin e saj "Disa prejardhje fisnore, ligje dhe zakone të Ballkanit" (Some Tribal Origins, Laës and Customs of the Balkans), Londër 1928.

Udhëtimi i pestë (1908). Në verën e vitit 1908, Edith Durham ndërmori një udhëtim tjetër në Malin e Zi, prej aty në Shkodër dhe pastaj përmes malësisë së veriut shkoi në Kosovë. Këtë udhëtim e ka përshkruar në librin e saj më të

njohur "Shqipëria e Epërme" (High Albania), Londër 1909.

Udhëtimi i gjashtë (1911-1913). Pas një sëmundjeje të rëndë nga malarja, Edith Durham e kaloi dimrin e vitit 1910 në Egjipt. Në vitin 1911, ajo u kthye në Shkodër dhe u strehua në familjen Shantoja për të rimarrë veten. Libri "Lufta për Shkodrën: turq, sllavë e shqiptarë" (The Struggle for Scutari: Turk, Slav and Albanian), Londër 1914, përqendrohet mbi rrethimin e përgjakshëm malazet të Shkodrës në kohën e pavarësisë së Shqipërisë.

Udhëtimi i shtatë (1921). Për herë të fundit, Edith Durham erdhi në Shqipëri në vitin 1921, ku u takua me Fan Nolin. Mary Edith Durham do të mbetet përgjithmonë një kujtim i bukur për shqiptarët, një personalitet i nderuar dhe i dashur, sepse ajo nga dita që shkeli në tokën shqiptare, u mrekullua jo vetëm nga natyra, por edhe nga shpirti e vlerat e shqiptarëve. Ajo u tregua shqiptare me zemër e me shpirt. Kjo është arsyeja pse ne e konsiderojmë atë si bijën tonë dhe i dhamë titullin e lartë "Mbretëresha e Maleve". Edith Durham është pjesë e historisë së Shqipërisë.

Mbretëresha e Maleve shqiptare njohu nga afër dhe ka pasur letërkëmbime me shumë prej personaliteteve të shquara të vendit tonë, si me Ismail Qemalin, Kristo Dakon, Dervish Himën, Mit'hat Frashërin, Pandeli Evangjelin, Faik Konicën, Lef Nosin, Mehmet Konicën, motrat Qiriazia, Aqif Pashë Elbasanin, Hil Mosin, Hoxhë Kadrinë, Bajram Curin etj.

“Dalle parole ai fatti concreti”

Nasce il Polo Universitario di Grottaferrata nell'Ex Biblioteca di via Della Rovere

Un nuovo punto di riferimento per la cultura e la formazione

Finalmente venerdì 8 novembre, si è svolta l'inaugurazione del Polo Universitario di Grottaferrata, un nuovo punto di riferimento per la cultura e la formazione, parte di un ampio progetto che prende ufficialmente il via, nella sua prima fase, con il Corso di Valorizzazione dei Siti Monastici Italo-Greci, nato dalla collaborazione tra l'Amministrazione Di Bernar-

ria Abbazia di San Nilo e profondamente collegato al cristianesimo orientale, al monachesimo italo-greco e ai suoi risvolti socio-economici nel corso dei secoli – dichiara il Sindaco Mirko Di Bernardo –. Trasmettere tale eredità alle prossime generazioni in un percorso accademico di livello internazionale, possibile grazie alla collaborazione con un partner di altissimo livello come l'Università Europea di Roma, è un'opportunità unica per la nostra città di comunicare il suo valore e la sua storia, con l'obiettivo di



do e l'Università Europea di Roma. Con un'aula dedicata alle lezioni frontali, online e in modalità mista, uno spazio dedicato ad archivio e a progettualità future e un'aula studio a servizio di tutti gli studenti del territorio, il Polo Universitario segna anche il rilancio dell'Ex Biblioteca, immobile comunale di pregio che rinasce con una nuova veste e un'identità precisa, collegata a doppio filo con il patrimonio storico, artistico e culturale della città e con il mondo universitario. Tra i contenuti del Corso, infatti, figurano lezioni proprio su Grottaferrata, l'Abbazia di San Nilo e la Chiesa di Santa Maria in Grottaferrata, che quest'anno celebra il millenario della sua consacrazione (1024-2024).

Ieri pomeriggio il taglio del nastro alla presenza del Sindaco Mirko Di Bernardo e dell'Amministrazione comunale, con il giro inaugurale nei locali riqualificati insieme ai tanti cittadini presenti. L'evento è proseguito nell'aula dedicata alle lezioni, dove il Primo Cittadino ha illustrato i contenuti del progetto affiancato dal cittadino delegato a Università e Ricerca Giorgio Di Giorgio, il cittadino delegato ai Rapporti con l'Abbazia di San Nilo Carmelo Pandolfi (Coordinatore del Corso) e la Professoressa di Storia del Cristianesimo Renata Salvarani, che nella sua Lectio Magistralis ha illustrato aspetti interessanti su temi strettamente collegati al Corso. Una serie di interventi moderati da Elisabetta Sanità, corrispondente di una testata giornalistica locale.

“Grottaferrata diventa Città Universitaria e lo fa attraverso un corso capace di riconnettere la nostra comunità alle sue radici e al suo patrimonio storico-culturale, custodito nella millena-

diventare un centro d'eccellenza per lo studio e la ricerca”.

“Questo splendido luogo, l'Ex Biblioteca, è stato completamente riqualificato e arricchito con importanti tecnologie volte a consentire lezioni multimediali all'avanguardia – continua il Sindaco –. Non solo. Siamo infatti riusciti a donare un nuovo spazio, l'aula studio, a favore di tutti gli studenti universitari di Grottaferrata. Infine, ricordo che questa è la prima fase di un progetto nel quale coinvolgeremo altri Atenei, in particolare l'Università di Tor Vergata, con l'obiettivo di valorizzare temi come il restauro del libro antico, la cui tradizione è ancora oggi una delle peculiarità di Grottaferrata. Ringrazio tutta l'Amministrazione comunale per il lavoro svolto. Ringrazio gli uffici comunali per il supporto. Ringrazio di cuore il cittadino delegato ai Rapporti con l'Abbazia e Coordinatore del Corso Carmelo Pandolfi, il cittadino delegato a Università e Ricerca Giorgio Di Giorgio, la Professoressa Salvarani per il suo intervento, Elisabetta Sanità e i tanti cittadini presenti all'evento.”

(Redazione)

L'8 novembre presso il Polo universitario di Grottaferrata c'è stata l'inaugurazione della sede e, particolarmente, del corso di valorizzazione dei siti monastici italo-greci, con la presenza del nostro Sindaco Prof. M. Di Bernardo, della Prof.ssa R. Salvarani, Docente di Storia del Cristianesimo presso l'Università Europea di Roma, e del nostro amico Prof. C. Pandolfi, responsabile del corso. Questo insegnamento, del tutto nuovo, dà la possibilità di conseguire un titolo universitario, pur a livello di formazione, per quanti intendano approfondire la bellezza delle nostre radici cristiane di matrice ellenica, al di là e al di qua dell'Adriatico e dello Jonio. (comunicato stampa)

Se dovessi scegliere tra il vero della filosofia e la parola di Cristo sceglierei Cristo

Di Prof. Pierfranco Bruni - Rome



Viviamo di domande e andiamo alla ricerca di risposte. Dietro ogni parola cerchiamo una logica. Speculazione nella visione di una ragione. Per tutto dovrebbe esserci una risposta? La ragione come pensiero filosofico non risolve il problema di fondo dell'uomo. Sarebbe meglio affidarsi al mistero? Quale ragione potrebbe dare un senso al tempo? O alla morte? Siamo uomini naufraghi in attesa e in balia del tempo e della morte. La filosofia della ragione è una materia nella quale tutto nasce e tutto perisce. Ma ciò non mi basta. Le parole sono linguaggi tra il corpo e il tempo. Domande e risposte non sono un fatto gratuito. Cos'è la gratitudine? Capire che qualcuno ti ha regalato qualcosa? Semplice. La gratitudine è aver ricevuto la luce. È avverti tirato dalla notte buia. È avverti dato ciò che non meritavi. È aver ricevuto. Gratitudine. È aver chiesto una Grazia. È aver donato più del possibile. È aver saputo accogliere. Insomma non si capirà mai perché si è dato e perché abbiamo accolto. C'è sempre un senso a tutto. Anche nel nulla. Anche nel vuoto. Anche nell'assenza. In questo senso però vive la verità certa che noi non conosciamo. Ma il centro di tutto resta la consapevolezza della mortalità. Vorremmo essere immortali perché vorremmo sfidarci giorno dopo giorno senza temere la fine.

La fine è temuta. Vorremmo però che la fine avesse timore di noi. Ma noi non siamo Dio e non possiamo essere neppure degli dei. Restiamo esseri timorosi della paura. Nessun sapere potrà dirci altro. È terribile conoscere la non conoscenza. O la non riconoscenza? La riconoscenza è un valore che nasce dalla virtù di aver compreso. Il fatto è altro: “Gli uomini muoiono e non sono felici”. Cosa è la conoscenza? Quando gli dei lacerano il mito aspetti che qualcuno ti porti la luna. Quella vera. Solo così potresti sentirti immortale. Ma la realtà forse è altro dal sentire soltanto. Non bisogna affidarsi soltanto alla propria percezione. Ascoltare permette però un

saper ascoltare. Nell'ascolto si potrebbe intuire un'altra verità che a volte non si riesce a leggere con tutti e due gli occhi. Bisogna saper osservare con entrambi. Con i due occhi. Quando non si riesce a guardare con i due occhi occorre necessariamente osservare con il cuore e se il cuore si nega c'è sempre l'anima. Importante è riflettere: “L'uomo è fatto così, caro signore, ha due facce: non può amare senza amarsi”.

Non bisogna abitare il tempo pensando soltanto che la vita sia amore. Bisogna fare in modo che l'amore sia vita. E che la vita sia affidabile in Cristo. Ho imparato dalla necessità di saper cogliere la pazienza senza però farsi dominare dalla pazienza stessa. Il sabotaggio della pazienza è una avvertenza di dominio sulla pazienza. Non dovrà accadere ciò. Altrimenti si corre il rischio di ferire l'intelligenza. L'amore è pazienza. La pazienza non è amore. È saggezza. Se la saggezza non è accompagnata da eresie e da rivolte è subordinazione dell'intelletto. Ciò vuol dire che si entra nella dimensione dell'eresia. È quella che a volte manca per non farsi omologare. Siamo in contesto in cui tutto è pianificato. Ma la vita non si può pianificare. Non è una pianura e non è un piano. È fatta di discese e salite, di scogli e rocce massicce, di tempeste e naufragi, di solitudini e angosce. Bisogna cercare di convivere perché bisogna convivere con se stessi senza finzioni. Senza fingere a se stessi. La gratitudine giunge dell'armonia che dovremmo portare dentro. Non cercarla. Darla. Fino a che punto si potrà arrivare a ciò? Camus ebbe a dire: “Continuo a credere che questo mondo non abbia affatto un significato superiore. Ma io so che qualcosa in lui ha senso ed è l'uomo, perché è il solo essere ad esigere d'averne”. L'uomo ha senso perché tutto ha senso. Anche la gratitudine ha un senso perché è un senso.

Io considero ciò un patto tra me e la vita. Se dovessi venire meno a questo patto non sarei grato più a me stesso. C'è sempre una gratitudine da dare senza aspettare altrettanto. La vita è un racconto con le finestre aperte. Perché “L'uomo ... non è interamente colpevole, non ha dato inizio alla storia; né è del tutto innocente poiché la continua”. In questa continuità non ci si può affidare alla storia. Il fatto che io mi affido non è che affido la mia anima alla storia. Non posso. Ma a qualcosa che va oltre. Alla tentazione della fede. Alla misericordia della fede. Al fatto che tutto questo è inspiegabile con la ragione. Il sacro non ha bisogno della filosofia ma del cuore del linguaggio delle parole. Del verbo che diventa carne. Forse è proprio qui il mistero di tutto. Sono pascaliano? Probabilmente sì. Se dovessi scegliere tra le “cose” illuminanti che portano alla filosofia del vero e la “povertà” e la croce di Cristo sceglierei Cristo.

KANDAVIA: TREVA, MALET, RRUGA DHE TEMPULLI DIANA I KANDAVIA

vijon nga faqja 5

Eruditi Egerem Çabej duke analizuar lidhjet teonome të Zanës ilire me Dianën romake ka thënë: «Diana romake u shtri në Iliri, përmbi përëndeshën e vendit Zana, e cila i ngjante asaj dhe i dha emërin e vet». Krijimi i kultit dhe rritja e hegemonisë të hyjneshës Diana ndër fiset ilire të Parthinëve, dëshmohej me tempullin e famshëm të Diana në Kandavia. Një ndër dokumentat e rëndësishme që dëshmon për ekzistencën e këtij tempulli është Tabula Peutingeriane e shekullit III – IV pas K, ku simboli i tempullit Ad Dianam Candaviense, vendoset në lindje të Skampës (Elbasanit), majtas lumit Genesis (Shkumbini), në rrugën Egnacia. [Annalina Levi e Mario Levi. La Tabula Peutingeriana in scala 1 : 1. Edizione Edizon 1978] [Ciurletti G, Tabula Peutingeriana. Codex Vindobonensis, Trento. U.C.T, 1991]

Njoftimin për këtë tempull e dha austriaku Von Camillo Praschniker, i cili në vitin 1916 zbuloi një pllakë mermeri me mbishkrimin Ad Dianae Augustae Candaviensis - tempulli i të Madhërishmes Diana i Kandavias.

Camillo Praschniker e deshifroi dhe e plotësoi mbishkrimin e gdhendur në pllakën e mermerit, ku krahas emrit Diana Augusta Candaviensis, është emri

Titus Flavius, çka sugjeron se ky tempull ishte ngritur kur Perandor i Romës ishte Titus Flavius Vespasiano (39 - 81 pas K).

Dian (ae); Augustae; Candavie(n)si; T(itus) Fl(avius); Dionysi D(onum) P(osuit) - Aty Dionisi vinte dhuratat.

Bazuar në Tabula Peutingeriana, ku në itinerarin e rrugës Egnacia shënohet stacioni Ad Dianam dhe simboli i tempullit Ad Dianam i Kandavias, Praschniker sugjeroi se ky tempull ngruhej në Babje të Librazhdit duke theksuar: “Pasi kalon Polisin, rruga zbret në Hanin e Babjes, ku në skajin perëndimor të qafës dikur ishte stacioni rrugor Ad Dianam, i shënuar në Tabula Peutingeriana, i cili i referohet faktorës të Dianës, që ishte në këtë stacion”. [Von C. Praschniker und A. Schober. Archäologische Forschungen in Albanien und Montenegro. Wien. In Kommission Bei Alfred Holder. 1919, p. 5 - 12].

Në vitin 1970, arkeologët Neritan Ceka dhe Lazër Papajani, kryen një ekspeditë informativo-arkeologjike përgjatë rrugës Egnacia dhe rezultatet i prezantuan në një artikull të botuar në revistën “Monumentet”.

Në artikull ata kanë hedhur mendimin se stacioni “Grandavia” ndodhej në fshatin Spathar, që është fqinj me Babjen. “Stacioni më i madh në këtë pjesë, shk-

ruajnë Ceka dhe Papajani, ishte në Rafjet e Spatharit, ku gjetëm gjurmë banesash të shpërndara në një sipërfaqe disa hektarësh. Këtu duhet identifikuar stacioni Grandavia dhe jo në Babje, për më tepër se Spathara ndodhet në mesin e distancës nga stacionet Mansio Tres Tabernas (Qukësi) me stacionin Mutatio Treiecto (Miraka), si është përshkruar në itinerarin e Burdigalës (607, 7.8; 608, 1). Në këtë studim Ceka dhe Papajani, theksojnë se ishin informuar nga banorët vendas për ekzistencën e një ndërtesë antike, aktualisht e zhdukur, që konsiderohej vend i shenjtë, që mund të jetë një ruajtje e traditës të Diana e Kandavias. [Neritan Ceka, Lazër Papajani: Revista Monumentet, 1/1971].

Stacioni “Grandavia” në Spathar, pasqyrohet në ditarin e pelegrinit anonim, i cili në vitet 333 - 334 pas K, udhëtoi nga Burdigala (Bordeaux e Francës), për në Jerusalem dhe kthimin në Burdigala. Ky ditar njihet me emrin Itinerarium Burdigalense, pra i udhëkalimi klerikut nga Burdigala, ose Itinerarium Hierosolymitano, udhëkalimi për në Jerusalem. Gjatë kthimit, ai ndoqi rrugën Egnacia, kaloi përmes Epirit të Ri, nga Manastiri në Elbasan, në Apolloni e deri në kepin e Tri Portit në Vlorë. Në ditarin e tij, që është dëshmia më e lashtë e udhëtimit nga Bordò e Francës, për në Jerusalem dhe rikthimi në atdheun e

tij, ka shënuar qytetet, stacionet Mansio dhe Mutatio që frekuentoi, ku pushoi dhe ndërroi kuajt gjatë këtij udhëtimit të gjatë në trojet e Ilirisë.

Gjatë kthimit nëpër rrugën Egnacia kaloi në Heraklea (Manastiri), në Scampa, në Clodiana, në Apollonia dhe arriti në Vlorë, në Mansin te Kepi i Treportit (Mansio Avlona Treiectum), ku ai mori anijen dhe zbkoi në Otranto. Udhëtimin nëpër rrugën Egnacia nga Manastiri deri në Vlorë, kleriku anonim e përshkruan nga rrjeshti 600.1 deri në 617.9 të dorëshkrimit. Ndër të tjera shkruan se pas Manastirit ndaloi në Mansio Claudanon (Uraka), në Mutatio Tres Tabernas (Qukës) dhe në Mansio Grandavia (Spathar). [Joanne Cotovico. L'Itinera-rium a Burdigala Jerusalem usque et ab Heraclea per Aulonam et per urbem Romam Mediolanum usque, Anteverpiae, An. MDCXIX].

Në ditarin e Burdigala rradhiten qytetet, Mansio dhe Mutatio gjatë rrugës Egnacia në Epirin e Ri, por ai nuk e përmend stacionin të Hani i Babjes, si shkruan Praschniker, madje dhe disa nga studiuesit librazhdas, e kanë përshkruar Babjen si vendndodhje e tempullit Diana, ashtu si studiuesit kompetenta Ceka dhe Papajani e kanë përjashtuar Babien si stacion Mansio, duke sugjeruar si Tempulli i Diana i Kandavias ndofta ngruhej në Spathar.

L'Albania salentina, tra gli arbëreshë tarantini

Di Lino De Matteis - Lecce

Un'enclave albanese nel cuore del Salento. È uno degli itinerari suggeriti nel volume **IL GRANDE SALENTO DA SCOPRIRE** Un viaggio insolito nel Tacco d'Italia attraverso quindici itinerari tematici, il volume curato da Lino De Matteis, per le Edizioni Grifo, in vendita nelle edicole di Brindisi, Lecce e Taranto in abbinata col "Nuovo Quotidiano di Puglia" (208 pagine a colori ad euro 8,80 + il prezzo del quotidiano).

Il Salento, come l'intera Puglia e altre regioni d'Italia, è stato, nel XV secolo, terra di accoglienza del popolo albanese in fuga dagli invasori musulmani. Data la vicinanza geografica e religiosa con l'altra sponda dell'Adriatico, la storica provincia di Terra d'Otranto accolse numerosi insediamenti di soldati e profughi albanesi, che, nel tempo, hanno poi dato vita alla così detta *Albania Salentina*. Furono decenni di intense migrazioni di albanesi favorite dal Regno di Napoli: in una lettera del 1452, il re Alfonso d'Aragona ordinava al principe di Taranto, Giovanni Antonio Orsini del Balzo, di «accogliere i buoni cristiani che giungevano dall'Albania per sfuggire



agli ottomani, che erano più potenti di loro». Albanesi sbarcarono in Terra d'Otranto nel 1461, quando il condottiero albanese Giorgio Castriota, detto Skanderbeg, venne per aiutare il discendente di re Alfonso, Fernando I d'Aragona, a combattere le ribellioni dei feudatari locali sostenuti dagli Angiò francesi. Per il suo aiuto, Skanderbeg venne ricompensato con alcuni territori in Puglia, dove si insediarono buona parte dei suoi soldati, raggiunti poi dalle loro famiglie. Alla morte di Skanderbeg, nel 1468, l'Albania cadde nelle mani degli ottomani e molti dei fuggiaschi albanesi giunsero in Terra d'Otranto per stabilirsi proprio in quei territori che erano abitati già da loro connazionali.

Il flusso della migrazione albanese durò fino al XVI secolo. Nel solo Salento furono una sessantina gli insediamenti arbëreshë, distribuiti in tutte e tre le province di Brindisi, Lecce e Taranto. Gli albanesi portarono con sé le loro caratteristiche etniche, culturali e religiose del rito greco-bizantino e per lungo tempo conservarono lingua, abitudini, usi e costumi, ma, col tempo, si assimilarono alla popolazione locale. Un'enclave arbëreshë resta ancora oggi a sud di Taranto, con epicentro il comune di San Marzano di San Giuseppe, insieme ai comuni di Carosino, Faggiano, Fragnano, Monteiasi, Montemesola, Monteparano, Roccaforzata e San Giorgio Jonico.

Tra le comunità arbëreshë salentine, **San Marzano di San Giuseppe** (*Shën Marxani*) continua a mantenere la lingua, la cultura e le tradizioni della madre patria. Di origine albanese il **Palazzo Capuzzimati** (detto anche Palazzo Marchesale o Casalini) con la chiesetta privata di San Gennaro, del XVI secolo, in largo Prete; in via Giorgio Castriota si possono notare ancora



antiche case arbëreshë con i tipici comignoli albanesi. A circa tre chilometri da San Marzano, in contrada Grotte, sulla strada provinciale per Grottaglie, c'è il **Santuario della Madonna delle Grazie** con la chiesa rupestre di origini bizantine. La chiesa ipogea si affaccia su una lama, in un suggestivo scenario di gravina, caratterizzata dalla presenza di grotte lungo i costoni. La chiesa rupestre ha diversi periodi di costruzione: il primo fino al secolo XIV-XV, con la dedizione a San Giorgio; il secondo dal XVI ai nostri giorni dedicato alla Madonna delle Grazie. L'ipogeo ha una forma quadrangolare, con tre accessi diversi, due che si affacciano sulla lama e uno che collega l'ipogeo con la chiesa soprastante attraverso un'imponente scalinata. L'elemento principale è l'affresco della Vergine con Bambino al quale fu attribuito un significato miracoloso. Da vedere anche la **Chiesa Madre di San Carlo Borromeo**, in corso Umberto I; la **Casa Rossa**, antica masseria con comignolo arbëreshë poco fuori del centro abitato, in contrada Ficone; e il **grande trullo del brigante Cosimo Mazzeo**, detto Pizzichicchio, in contrada Bosco.

A San Marzano di San Giuseppe, soprattutto tra le fasce più anziane di popolazione, si continua a parlare la lingua albanese pre-ottomana (*gluha arbëreshë*) e si conservano tradizioni e us-



anze, canzoni e balli della patria albanese. Ogni anno si organizzano manifestazioni pubbliche, in costume e lingua albanesi, che mettono in scena le usanze della loro tradizione, come "Vëj Kurorë" (prendere corona) rappresentazione di un matrimonio tipico arbëreshë. Sono attive alcune associazioni, come la Pro Loco Marciana, impegnate a tenere viva la tradizione albanese, soprattutto tra i giovani. A ricordare le origini, nel centro del paese, nella strada a lui dedicata, campeggia un grande busto del condottiero ed eroe albanese Skanderbeg. Anche la festa del patrono **San Giuseppe**, che si celebra il 19 marzo, a San Marzano di San Giuseppe ha radici antiche ed è vissuta dalla popolazione come un evento molto importante. Legati alle origini



del culto per il santo, vengo praticati alcuni riti, come la benedizione del pane rotondo, la processione delle fascine, che serviranno poi per accendere un grande falò, e l'allestimento delle "Tavole di San Giuseppe". La mattina del 19 marzo, prima della processione del santo, davanti alla **Chiesa Madre di San Carlo Borromeo**, vengono preparate le cosiddette *matte* (tavole per i poveri), con piatti tipici della tradizione culinaria locale, benedetti dal parroco e distribuiti ai presenti, in memoria dell'ospitalità che la Sacra Famiglia ricevette durante la fuga in Egitto.

Anche negli altri centri dell'enclave albanese si possono trovare ancora riferimenti architettonici della cultura arbëreshë, come i tipici comignoli, chiese o resti di chiese, rovine di casali. Nel centro storico di **Carosino**, per esempio, è possibile trovare un comignolo arbëreshë in largo Dante, al civico 41; mentre del Casale Civitella di origine albanese, che un tempo sorgeva a nord-est di Carosino, si può vedere oggi solo la **Masseria Civitella**. A **Monteiasi** tracce albanesi restano in alcuni cognomi tipici del posto. Di un altro casale albanese San Crisperi, frazione di **Faggiano**, restano solo le rovine della **Chiesa di Santa Maria di Costantinopoli**. A **San Giorgio Jonico** c'è un comignolo arbëreshë in via Simone Veil; un altro si trova in via Cesare Battisti, vicino al **Castello D'Ayala Valva** in largo Osanna; in via Madonna



della Croce c'è la **Cappella della Madonna della Croce**, che fu costruita dove un tempo sorgeva la chiesa arbëreshë di Santa Maria della Presentazione; e da via Pier Giovanni Zingaropoli si possono ancora vedere i resti dell'ex **Casale Belvedere** di origine albanese. A circa due km a sud-est di **Roccaforzata** si trovano altre tracce albanesi, come il **Santuario di Santa Maria della Camera** e i resti del **Casale Mennano**.

Visitare l'enclave arbëreshë salentina non è solo vivere l'emozione di un tuffo nel passato delle storiche migrazioni albanesi, ma anche un richiamo alla storia delle più recenti migrazioni, iniziate il 7 marzo 1991, con il primo sbarco di massa a Brindisi, e culminate l'8 agosto dello stesso anno, con l'arrivo a Bari dei 20mila albanesi ammassati sulla nave mercantile "Vlora". Come era già avvenuto nel XV secolo, salentini e pugliesi non hanno fatto mancare la loro solidarietà e hanno accolto i profughi giunti dal Paese delle Aquile, impegnato in una profonda trasformazione politica e sociale. L'enclave arbëreshë salentina è oggi simbolo della vicinanza



con l'altra sponda dell'Adriatico, per i legami che questa comunità continua ad avere ancora con la madrepatria albanese.

L'ANTICO LIQUORE ALBANESE

A San Marzano di San Giuseppe si produce il famoso liquore "Elisir San Marzano" della Borsci, nello stabilimento sulla via per Martina Franca. La famiglia Borsci è originaria di un paesino dell'Albania chiamato Borsci. Da qui, un nucleo della famiglia si staccò al seguito dell'eroe nazionale albanese Giorgio Castriota (detto Skanderbeg) ed approdò in Terra d'Otranto, stabilendosi a San Marzano di San Giuseppe. Nel 1840, Giuseppe, il capostipite, perfezionò la ricetta di un liquore ereditata dai suoi avi, dando vita ad un elisir rimasto inalterato fino ad oggi. Giuseppe Borsci pose sull'etichetta dell'Elisir la dicitura *Specialità Orientale*, insieme all'aquila bicipite, simbolo dell'Albania, che sopravvive tuttora.



Le foto presentate in questo articolo sono scattate da Eduardo De Matteis.

Emri i vendbanimit të vjetër i qytetit antik të Borshit ka qenë Meandria

Nga Ylber Hysi - Borsh

Borshi i Himarës shtrihet në zemër të Rivierës Shqiptare dhe ka qenë një nga vendbanimet më të përmendura dhe të zhvilluara të historisë së asaj treve. Ka qenë pjesëmarrës në të gjitha ngjarjet e rëndësishme në të cilat kaloi e gjithë krahina e Himarës. Për shkak të ekzistencës në territorin e tij të një kalaje të fuqishme si kalaja e Sopotit, Borshi u bë personifikim i faktit se quhej e pushtuar krahina e Himarës kur pushtoheshin kalaja e Sopotit dhe quhej e çliruar kur çlirohej ajo kala. Por, fakt është se në të gjitha këto ngjarje, në të gjitha luftrat kundër çdo pushtuesi, banorët e krahinës së Himarës apo siç quheshin të gjithë himariotë bëheshin bashkë kundër çdo armiku. Emri i vendbanimit të vjetër apo i qytetit antik të Borshit ka qenë Meandria. Historiani i vjetër Plini, gjatë përshkrimit të bregdetit kaon, përmend edhe Burimin e Ujit Mbretëror, që mendohet të ketë qenë Gurra e Borshit, ashtu siç vazhdon të jetë edhe sot. Akoma dallohen gurgelët e ngulur në shkëmb për ankorimin e anijeve në rrëzë të Gurrës së Borshit. I vetmi ndryshim me atë periudhë është se në vend të fushës poshtë Burimit të Ujit Mbretëror shtrihet deti Jon në formën e një gjiri detar.

Gërmimet arkeologjike brenda mureve të kështjellës kanë treguar se vendbanimi më i hershëm aty i takon periudhës së Bronzit të Vonë, rreth shek. XII p.e.s. Ky moment korrespondon me kohën e përfundimit të luftës së Trojës dhe me periudhën e shkatërrimeve të mëdha që ndodhën në zonën e Epirit dhe të Greqisë për shkak të dyndjes së fiseve dore.

Periudha e dytë e fortifikimeve të qytetit antik Meandria lidhet, kryesisht, me periudhën e mbretit mollos Alketa, rreth mesit të shek. IV p.e.s. Qyteti antik, në atë kohë paraqitet i fortifikuar mirë dhe kishte detyrë, midis të tjerave, kontrollin e dy rrugëve që kryqëzoheshin pranë saj, njërin që lidhte përgjatë bregut të Jonit, Kaoninë me Orikun e Apoloninë dhe tjetrin, që të nxirrte, me anë të luginës së lumit të Borshit, në territorin e amantëve e në Bylis. Një numër i madh banesash rrotull kalasë së Sopotit, sot vërtetojnë se territori përreth qytetit ka qenë banuar dendur. Inventari i pasur me sende qeramike, bronzi e ari, të gjetura në varret e nekropolit të qytetit, poshtë kështjellës, tregojnë për banorë të pasur dhe me nivel të lartë jetese.

Bazuar në trashëgiminë burimore, në përgjithësi mbret në të gjithë territorin e Epirit të lashtë është nënkuptuar Pirro i Epirit, i cili sipas studiuesve supozohet të ketë qenë i pranishëm në këtë kështjellë, ndoshta gjatë përgatitjeve për fushatën e Italisë. Aktualisht, specialistët kanë dalluar brenda rrethimit të mureve antike kaone, një rrethim në formën e një akropoli. I veçantë është ndërtimi i tij me blloqe gëlqerore, pa llaç e me përmasa të vogla të cilat kanë qenë tipike për periudhën e ndërtimeve ushtarake të Pirros së Epirit. Edhe varri monumental, i zbuluar në nekropol, në pjesën jugore të kodrës, i takon kësaj periudhe. Megjithatë varri është grabitur qysh



Borsci il vecchio

në lashtësi, disa zbulime ari të gjetura në të tregojnë se ai i takon një personi të rëndësishëm, ndoshta një ushtaraku bashkëkohës të Pirros. Në afërsi të Burimit të Ujit Mbretëror, poshtë qendrës së fshatit të sotëm të Borshit, arkeologët mendojnë se ka ekzistuar edhe një tempull kushtuar Herakliut. Pranë Gurrës është gjetur një topurre bronzi si simbol i kësaj perëndie me një mbishkrim me emrin e personit që e ka dhuruar.

Pas shkatërrimeve romake të konsullit Paul Emili, edhe Borshi, si gjithë krahina, si kudo në Europë përjetoi periudhën e errët të Mesjetës së Hershme, me shumë ngjarje dhe akoma me më pak informacion. Vendbanimi i qytetit antik u tkurr dhe nën rrënojat e tij u ngrit kalaja e Sopotit dhe rreth mureve të saj fshati i Borshit. Nën peshën e rrezikut që vinte nga ana e detit Jon, rreth shek. XIII-XIV fshati i Borshit u zhvendos në gjirin e maleve ku ai pati një zhvillim ekonomik deri diku të konsiderueshëm, në realitetin e kohës dhe të zonës rreth e përqark. Në fillim të shek. XX, Borshi paraqiste një fshat me një jetë social-ekonomike dhe që shtrihet në formën e 6 lagjeve. Ngjarjet e rënda të fillim shekullit patën pasoja edhe për Borshin. Në vitin 1914 Borshi u dogj e u shkatërrua nga andartët grekë dhe popullsia emigroi në rrethinat e Vlorës si muhaxhirë. Pasaotat ishin të rënda, jo vetëm ekonomike por edhe në aspektin humanitar njerëzor. Shumë familje nuk mbijetuan dot dhe shumë të tjera pësuan dëme të parikuperueshme. Mbas mbarimit të Luftës I Botërore familjet borshiote filluan të ktheheshin në vatanin e tyre, i cili tashmë ishte bërë i pajetueshëm. Për këtë arsye, një e nga një ata filluan të zbrisnin me familjet e tyre në drejtim të detit, nga ishin larguar të parët e tyre 4-5 shekuj më parë. Secili pranë pronës së tij, duke ngritur banesa të thjeshta, filluan rimëkëmbjen e Borshit të ri. Aty ku ai është i shtrirë sot.

Qyteti antik i Borshit

Vendbanimi i fortifikuar antik i Borshit ngrihet mbi një kodër në formë piramide me tri faqe, gjë që ka kushtëzuar edhe formën e planimetrit të qytetit. Ai kontrollonte rrugën bregdetare të Kaonisë për në Ilirinë e Jugut dhe rrugën përmes luginës së lumit të Borshit për në territoret e amantëve. Akropoli vrojtohet në anën jugperëndimore nga prania e dy trakteve trapezoidale nën muret e kështjellës mesjetare të Sopotit, e cila është ngritur e gjitha brenda territorit të qytetit antik. Në dy faqet e tjera akropoli zgjatet në formë hunde deri te kreshta verilindore. me një kullë katërkëndëshe. Hyrja e akropolit ka qenë aty ku është sot hyrja kryesore e kështjellës mesjetare. Gjatësia e mureve është rreth 500m. dhe sipërfaqja e rrethuar 2. 5 - 3 ha. Në anën veriperëndimore gjendet edhe një trakt muri i ruajtur mirë, me gjatësi mbi 60 m. e lartësi 4m. Muri mbështetet mbi një themel të fortë me blloqe gurësh të mëdhenj, ndonëse shpesh herë si themel përdoren shkëmbinj të natyrorë. Muri është ndërtuar me blloqe me përmasa 1.10m. x 0.75m. dhe 1.60m. x 0.50m. të punuara e të puthitura mirë midis tyre, me faqet ballore të fryra e kryesisht trapezoidale, ku nuk mungojnë edhe ato poligonale e katërkëndëshe. Qyteti së bashku me akropolin përfshinin një sipërfaqe prej 4. 5 ha. me një gjatësi muresh prej 1 km. Akropoli i qytetit është i pajisur me kulla katërkëndëshe. Studiuesit shprehën se zhvillimi i vendbanimit ka patur një rrugë të ngjashme me Butrintin. Fillimisht, ka ekzistuar një qendër në zonën e akropolit, ku dallohet një trakt me teknike primitive ndërtimi, me blloqe të mëdha e pak të punuara. Më pas është krijuar qyteti dhe pjesa e parë ka mbetur brenda në formën e akropolit.

Në një periudhë të tretë janë bërë meremetimet me tekniken trapezoidale në muret e akropolit. Periudhës së katërt të lulëzimit të qytetit i takon shtresa me muraturë katërkëndëshe dhe të një periudhe të pestë janë rindërtimet në pjesën lindore të qytetit, ku muret janë mbivendosur mbi themelet e mureve antike. Në bazë të kësaj kronologjie rezultojnë që periudha e parë e qytetit antik të Borshit fillimet i ka deri në mesin e shek. IV p.e.s., periudha e dytë vendoset në gjysmën e dytë të shek. IV p.e.s., periudha e tretë vendoset në fundin e shek. IV p.e.s., periudha e katërt vendoset në fillim të shek. III p.e.s. Periudha e pestë përfaqëson një rast të përdorimit të teknikës primitive në fazën e vonë të zhvillimit të qytetit, kur ky kërcënohej nga ndonjë rrezik i papritur, i cili mund të ketë qenë momenti i pushtimit romak. Dinamika e zhvillimit të vendbanimit, sipërfaqja prej gati 5ha, ekzistenca e akropolit, niveli i lartë i fortifikimit dhe pozita e përshtatshme strategjike, vërtetojnë se qyteti antik Meandria (Borshi i sotëm) ka ekzistuar dhe lulëzuar në formën e një qyteti antik, nga shek. IV p.e.s. deri në fundin e shek. II p.e.s. kur mendohet se u shkatërrua nga konsulli romak Paul Emili në vitin 167 p.e.s.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Il nome dell'antico insediamento di città antica di Borshi era Meandria

Borshi di Himara si estende nel cuore della Riviera Albanese ed è stato uno degli insediamenti più importanti e sviluppati della storia di quella regione. Ha partecipato a tutti gli eventi significativi che hanno coinvolto l'intera area di Himara. Grazie alla presenza sul suo territorio di una potente fortezza, come il castello di Sopot, Borshi divenne il simbolo della conquista o della liberazione della regione di Himara: era considerata occupata quando cadeva la fortezza di Sopot e liberata quando questa veniva ripresa. Tuttavia, è un fatto che in tutti questi eventi e in tutte le guerre contro ogni invasore, gli abitanti della regione di Himara, noti come himarioti, si univano sempre contro qualsiasi nemico. Il nome dell'antico insediamento o città antica di Borshi era Meandria. Lo storico romano Plinio, nella sua descrizione della costa caonia, menziona anche la Sorgente dell'Acqua Reale, che si ritiene fosse la Fonte di Borshi, la quale esiste ancora oggi. Sono ancora visibili gli anelli fissati nella roccia per l'ancoraggio delle navi ai piedi della sorgente di Borshi. L'unica differenza rispetto a quel periodo è che al posto della pianura sotto la Sorgente dell'Acqua Reale, oggi si estende il Mar Ionio, con la forma di una baia marina. Gli scavi archeologici all'interno delle mura del castello hanno rivelato che il primo insediamento in quell'area risale al Tardo Bronzo, intorno al XII secolo a.C. Questo periodo corrisponde alla fine della guerra di Troia e all'epoca delle grandi distruzioni che interessarono l'Epiro e la Grecia a causa delle invasioni delle tribù doriche.

La seconda fase di fortificazione della città antica di Meandria è legata principalmente al periodo del re molosso Alcheta, intorno alla metà del IV secolo a.C. In quel tempo, la città era ben fortificata e svolgeva un ruolo strategico nel controllo di due importanti strade che si incrociavano nelle sue vicinanze: una che collegava lungo la costa del Mar Ionio Caonia con Orico e Apollonia, e l'altra che attraverso la valle del fiume di Borshi portava al territorio degli Amanti e a Bylis. Numerose abitazioni attorno al castello di Sopot dimostrano che il territorio circostante era densamente popolato. Il ricco inventario di oggetti in ceramica, bronzo e oro trovati nelle tombe della necropoli della città, ai piedi del castello, testimonia la presenza di abitanti benestanti con un alto tenore di vita. Sulla base delle fonti storiche, il sovrano dominante nell'antico Epiro era considerato Pirro dell'Epiro, che secondo gli studiosi potrebbe essere stato presente in questo castello, forse durante i preparativi per la campagna in Italia. Attualmente, gli esperti hanno individuato, all'interno del perimetro delle mura antiche, un recinto che ha la forma di un'acropoli. Particolare è la sua costruzione in blocchi di calcare, senza malta e di piccole dimensioni, tipici dell'architettura militare del periodo di Pirro. Anche la tomba monumentale scoperta nella necropoli, nella parte meridionale della collina, appartiene a questa epoca. Sebbene la tomba sia stata saccheggiata in antichità, i decori in oro trovati al



Castello di Borsci

suo interno indicano che apparteneva a una persona di rilievo, forse un militare contemporaneo di Pirro.

Nei pressi della Sorgente dell'Acqua Reale, sotto l'attuale centro del villaggio di Borshi, gli archeologi ipotizzano che esistesse un tempio dedicato a Eracle. Vicino alla sorgente è stata rinvenuta un'ascia di bronzo, simbolo di questa divinità, con un'iscrizione che riporta il nome del donatore.

Dopo le distruzioni romane ad opera del console Paolo Emilio, anche Borshi, come tutta la regione, attraversò il periodo oscuro dell'Alto Medioevo, caratterizzato da molti eventi ma poche informazioni documentate. L'insediamento dell'antica città si ridusse e sulle sue rovine sorse il castello di Sopot e, attorno alle sue mura, il villaggio di Borshi. Per via dei pericoli provenienti dal Mar Ionio, tra il XIII e il XIV secolo il villaggio di Borshi si spostò nell'entroterra montano, dove conobbe uno sviluppo economico relativamente significativo per l'epoca e la regione circostante. All'inizio del XX secolo, Borshi era un villaggio con una vita socio-economica organizzata in sei quartieri.

Gli eventi tragici dell'inizio del secolo ebbero gravi conseguenze anche per Borshi. Nel 1914 il villaggio fu incendiato e distrutto dagli andarti greci, costringendo la popolazione a rifugiarsi nelle aree circostanti Valona come profughi. Le conseguenze furono devastanti, non solo economicamente ma anche umanamente. Molte famiglie non sopravvissero e altre subirono danni irreparabili. Dopo la Prima Guerra Mondiale, le famiglie di Borshi iniziarono a tornare al loro territorio, ormai diventato inabitabile. Per questo motivo, gradualmente, iniziarono a trasferirsi verso il mare, dove si erano insediati i loro antenati 4-5 secoli prima. Vicino alle loro proprietà, costruirono semplici abitazioni e iniziarono la ricostruzione del nuovo Borshi, là dove si trova oggi.

La città antica di Borshi

L'insediamento fortificato antico di Borshi sorge su una collina a forma piramidale con tre lati, caratteristica che ha influenzato sia la forma che la planimetria della città. Essa controllava la strada costiera della Caonia verso l'Iliria meridionale e la strada che, attraverso la valle del fiume di Borshi, conduceva ai territori degli Amanti. L'acropoli è visibile sul lato sud-occidentale per la presenza di due tratti trapezoidali sotto le mura del castello medievale di Sopot, il quale è stato costruito interamente all'interno del territorio della città antica. Sugli altri due lati, l'acropoli si estende come una penisola fino alla cresta nord-orientale, dotata di una torre rettangolare. L'ingresso dell'acropoli era situato dove si trova oggi l'entrata principale del castello medievale. Le mura si estendono per circa 500 metri e l'area circondata copre una superficie di 2,5-3 ettari. Sul lato nord-occidentale si trova un tratto di muro ben conservato, lungo oltre 60 metri e alto 4 metri. Il muro poggia su una base solida costituita da grandi blocchi di pietra, anche se talvolta la roccia naturale è stata utilizzata come fondazione. È costruito con blocchi dalle dimensioni di 1,10 m x 0,75 m e 1,60 m x 0,50 m, lavorati e ben incastrati tra loro. Le superfici frontali dei blocchi sono leggermente convessi e prevalentemente trapezoidali, anche se non mancano blocchi poligonali e rettangolari. La città, insieme all'acropoli, occupava una superficie di 4,5 ettari, con una lunghezza complessiva delle mura di circa 1 km. L'acropoli era dotata di torri rettangolari. Gli studiosi affermano che lo sviluppo dell'insediamento ha seguito un percorso simile a quello di Butrinto. Inizialmente esisteva un centro nella zona dell'acropoli, distinguibile per un tratto di mura costruito con una tecnica primitiva, utilizzando blocchi grandi e poco lavorati. Successivamente venne creata la città vera e propria, con l'acropoli che rimase al centro. In una terza fase, le mura dell'acropoli furono ristrutturate utilizzando la tecnica trapezoidale. Alla quarta fase di prosperità della città risale uno strato di muratura rettangolare, mentre la quinta fase è caratterizzata da ricostruzioni nella parte orientale della città, dove le mura furono sovrapposte alle fondamenta delle mura antiche. In base a questa cronologia, risulta che la prima fase della città antica di Borshi risale fino alla metà del IV secolo a.C.; la seconda fase è databile alla seconda metà del IV secolo a.C.; la terza fase alla fine del IV secolo a.C.; la quarta fase all'inizio del III secolo a.C.; e la quinta fase rappresenta un esempio di utilizzo di una tecnica costruttiva primitiva durante la fase tarda dello sviluppo della città, quando questa era minacciata da un pericolo improvviso, probabilmente l'invasione romana. La dinamica dello sviluppo dell'insediamento, la superficie di quasi 5 ettari, l'esistenza dell'acropoli, l'elevato livello di fortificazione e la posizione strategica favorevole dimostrano che la città antica di Meandria (l'attuale Borshi) è esistita e ha prosperato come città antica dal IV secolo a.C. fino alla fine del II secolo a.C., quando si ritiene sia stata distrutta dal console romano Paolo Emilio nel 167 a.C.

(continua al prossimo numero)

FEJA E SHQIPTARIT ËSHTË SHQIPTARIA

Nga Imer Xhemail LLadrovci - Gjermani

Ky është një varg në poemën e Pashko Vasës „O moj Shqypni“ që ka arritur deri në kohën tonë dhe na trondit në shpirt sa edhe bashkohësit e poetit, të cilëve iu është drejtuar në momentin kur u botua. Supozoj se në zemrat e shqiptarëve të të gjitha kohëve kjo poemë do të ndez një furi zjarri atdhedashës. Një vepër arti mund të quhet e realizuar kur nxit të lexuesi ide e veprime që e ripërtrijnë botën, shkurt kur ajo jep shtytje të reja reflektive e vitalizuese. Poema është një odë dashurie për atdheun me vlefshmëri mbikohore. „Feja e shqiptarit është shqiptaria“ është një metaforë gjeniale që u kthye në parullë politike praktike, pa fajn e autorit të tij që e donte atdheun e tij të nënshtruar e të përburzur, të rrezikuar ekzistencialisht nga të gjitha anët në Ballkanin e kohës së tij. Nëse shqiptarët nuk do të mobilizoheshin në mbrojtje të territoreve të tyre, Shqypnia gjymtuar do të zhdukej tërësisht s’do të ekzistonte më, kështu që kjo poemë mund të thuhet se ka dhënë alarmin me kohë dhe kështu ka ndikuar që shqiptarët të bashkohen rreth një kërkesë politike që i siguroi vendit tonë mbijetesën në Europën Juglindore që përshkohej nga një ideologji e fortë kundërshqiptare që nxitte dhe ushqejte me ide e veprime nga Rusia cariste. Pashko Vasa si poet shkroi për vendin e tij të zhytur në mjerim, me një ndjeshmëri të madhe dhe me kreativitet gjenial, madje me një intuitë të mprehtë i parandjeubragjedditë e tij që do të vinin në një kohë kur ai nuk do të ishte më në këtë botë. Pashko Vasa vdiq në vitin 1892 kur ishte në postin e guvernatorit të Libanit, njëzet vjet para shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë nga bashkëluftëtari i tij Ismail Qemali, dmth. shumë vjet para se Shqypnia e tij të ndahej e coptohej nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin e mbrapshtë 1913, vit ky që është i pranishëm në letërsinë shqiptare me romanin e Ismail Kadaresë „Viti i mbrapshtë“.

Hemorragjia etnike e hapësirës shqiptare që tematizohet në këtë poemë do të vazhdojë në mënyrë intenzive deri në Luftërat Ballkanike kur popullsia shqiptare, sipas një historiani irlandez të kohës, do të humbiste më shumë se gjysmën e popullsisë së saj. Poema e rilindasit Pashko Vasa „O moj, Shqypni“ u shkrua një shekull e gjysmë më parë, saktësisht mes viteve 1878 e 1880, por jo vetëm s’është harruar, por është kthyer në një hymn të kombëtarizmit kombëtar, në një manifest të tij poetik. Pashko Vasa nuk mund ta dinte në momentin kur e shkroi këtë poemë se po shkruante në vargje një program uni-



Poeti e atdhetari Pashko Vasa

kal kombëtar për shqiptarët, për jetësimin e të cilit do vdesin dhjetëramijë atdhetarë shqiptarë në rrjedhën e kohës. Mund të themi se asnjë popull tjetër në botë nuk ka një manifest të tillë ku poetika dhe politika gërshetohen mes vete për të dhënë një kryevepër arti. Poeti shprehte ndjenjat e tij të thella ndaj atdheut të shtypur e të zhytur në mjerim, pa e njohur në detaje faktin se në një raport të ngjashëm ndjenjor ndaj Shqipërisë ishin edhe miliona të tjerë shqiptarë të kohës së tij dhe të kohëve të pastajme. Jo vetëm xhamia që ishte në dorën e pushtetmbajtësve osmanë, por edhe kisha ortodokse që drejtohej nga greko-sllavët i çorodiste shqiptarët me qëndrimet e saj, kështu që në vargjet „mos shikoni kisha e xhamia, feja e shqiptarit është shqiptaria“ nuk bëhej fjalë për ndonjë fikson ideologjik kombëtarist, por në këtë metaforë strehohet një realitet dhe përvojë e dhimbshme që peshonin rëndë në jetën e shqiptarëve për shkak se faktet në terren ishin tepër dëshpëruese, duke qenë se xhamia dhe kisha ortodokse ishin bashkuar për ta gjunjëzuar shqiptarin imagjinari kryengritës në një kohë që ky shqiptar nuk kërkonte asgjë tjetër veç normalitetit dhe uljen e zjarmisë ideologjike kundërshqiptare që vinte nga rradhët e teologëve që e kishin harruar parimin themelor të fesë: paqen. Xhamia nga shqiptarët prodhonte turq, kurse kisha grekë dhe sllavë. Për këtë transformim kërkohej dhunë, diçka malinjje që ndërfaqej në jetën e shqiptarëve të rëndomtë.

Në vargjet e Pashko Vasës ende gjen shqiptarë ortodoksë „shqeh“, që sot nuk i gjen askund në realitet. Madje për këtë brez vetë tematizimi i ekzistencës së tyre duket si një lloj ekstremizmi kombëtarist. Ruajtja e status quos është kthyer në apologji. Nëse në Maqedoni sot mund të gjejmë aty-këtu ndonjë shqiptar ortodoks që ende di të flasë në gjuhën shqipe dhe s’e mohon prejardhjen e tij, në Serbi dhe në Mal të Zi shqiptarë të tillë nuk gjen dot, ndoshta serbë të tillë shqiptarë ka, por ata nuk e marrin guxim të paraqiten si të tillë në publik.

Në kohën e komunizmit, poema „Moj Shqypni“ që kthyer në një model se si duhej kënduar vendit duke i shpërfillur në mënyrë paushalle fetë e tij. Duke qenë se dorëshkrimi i autorit nuk është ruajtur, të paktën gjurmimet albanologjike nuk e konstatojnë këtë gjë, pas rënies së komunizmit dikush bëri përpjekje për t’i ndryshuar këto vargje në përputhje me rrethanat e reja me synimin që autorin ta shpëtojë nga interpretimet e njëanshme. Në komunizëm, Pashko Vasa që kthyer në njëfarë mënyre në një poet ateist, edhepe ai nuk ishte i tillë. Çdo kush që e njeh jetëshkrimin e poetit Vaso Pashë Shkodrani e di që ai ishte një besimtar katolik tolerant, aspak fanatik, por ateist nuk ishte pa asnjë dyshim. Në poemën e tij, ai u bënte thirrje shqiptarëve që ta duan vendin dhe kombësinë e tyre me përkushtim fetar, që shqiptarinë ta shikojnë si një forcë kohezive shpirtërore kryesore në marrëdhëniet mes tyre, por nuk bënte thirrje kundër fesë si të tillë. Shqiptarët në kohën e tij ishin të ndarë si dhe sot në shumë fe. Vaso Pashë Shkodrani si zyrtar i lartë i Perandorisë nuk mund të fliste hapur kundër regjimit osman që e përdorte islamin për t’i sunduar më lehtë shqiptarët dhe ortodoksinë, përmes mekanizmave që i kishte nën kontroll për t’i përçarë dhe shfaktorizuar ata. Por kur thotë se shqiptarët nuk duhet të shikojnë se ç’bëjnë e ç’thënë kishat dhe xhamiat, ai i referohet këtij realiteti të dhimbshëm, nuk e shpik atë për të ndërtuar një atmosferë poetike të kontrastit, ai thjesht nxjerrë në letër atë që sheh në realitetin shqiptar. Metaforat e tij janë të gjalla, ato kanë një fundament real në shoqërinë shqiptare të kohës.

Ç’është metafora si figurë letrare? Në krahasim pa shenjat e dukshme gjuhësore të krahasimit. Shqiptaria si fe është metaforë, jo një lloj feje e re, siç duan ta paraqesin disa imamë sot. Shqiptaria ishte dhe është themeli etnik i bashkësisë shqiptare, një materie shpirtërore e përbashkët për të gjithë shqiptarët, pavarësisht se cilës fe i takojnë ata. Dhe, poeti rilindas kërkon nga shqiptarët të mos e mohojnë këtë fakt fundamental, për shkak se këtë gjë e kërkon ndonjëra nga fetë. Turqit përmes

islamit i detyronin shqiptarët ta deklarorin veten si turq, kurse priftërinjtë ortodoks bënin propagandë në kishat e tyre kundër atyre që duke qenë ortodoks e quanin veten edhe shqiptarë. Sipas priftërinjëve grekë dhe serbë, ortodoksia nuk pajtohej me këtë përkatësi etnike të besimtarëve. Një ortodoks duhej të ishte për priftërinjtë grekë grek, për ata serbë serb, ose thjesht i pafe, gjë që nuk ishte një gjë e vogël, por një ekskomunikim i tërthortë. Sipas tyre një shqiptar mund të ishte vetëm ai që ishte katolik, dmth. një armik i perandorisë dhe i fesë. Përballë kësaj dihotomie, besimtarët frikësoheshin, ndaj dhe me kohën u tretën. Edhe brenda ortodoksisë, priftërinjtë serbë nuk e toleronin një ortodoks shqiptar që njihete autoritetin grek në kishë. Në këto rrethana, për një besimtar shqiptar ishte tepër vështirë të ruante bashkë me besimin edhe përkatësinë etnike shqiptare. Shqiptaria shihej si diçka e keqe, malinjje, që nuk shkonte aspak me besimin ortodoks. Ortodoksia, për të cilën paraardhësit ilirë dhe arbërorë të shqiptarëve kishin dhënë një kontribut kaq të madh, u kthye në një armë me të cilën luftohej shqiptaria. Albanologu gjerman Gustav Majer (Gustav Mayer) ka shkruar shumë për këtë dukuri, që sot papritmas merrë një rëndësi të madhe. Publiku shqiptar duhet të njihet me studimet e tij, sepse ato janë poaq të rëndësishme sa edhe studimet e tij mbi gjuhën shqipe. Albanolog një studiues nuk e bën vetëm ajo që ka shkruar e botuar ai për gjuhën shqipe. Një çasje e tillë përbën një formë alarmante të reduksionizmit, një reduksionizëm që i dëmton rëndë studimet në albanologji. Albanologjia është shkencë mbi shqiptarët, që në parim nuk e lejon përjashtimin e asnjëlloj dijeje e asnjë lloj njohje faktesh për ta. Konstatimi i këtyre fakteve në rradhë të parë, dhe jo interpretimi i tyre dogmatik është detyra e saj kryesore. Poema e poetit Pashko Vasa na shpie tek ky mendim kritik bashkëkohor. Albanologjia merret me shqiptarinë dhe jo vetëm me një formë të saj. Rrjedhojat e vargjeve të rilindasit tonë të madh janë jo vetëm politike, por edhe shkencore, ndaj dhe ai është luftuar egërsisht në të gjitha kohët nga armiqët e shqiptarëve. Pashko Vasa nuk ka thënë kurrë që shqiptaria është një fe e re që i konkurren fetë abrahamike, por një qëndrim shpirtëror pohues ndaj realitetit etnik. Shkurt, ai u bënte thirrje shqiptarëve që të mos e shohin përkatësinë e tyre etnike si një deficit në raport me besimin. Nëse besimi, islami dhe ortodoksia në rastin konkret, nuk mund ta ndryshojnë dogmën e tyre për shqiptarët si armiq, atëherë shqiptarisë nuk i mbetet gjë tjetër në aksionin e saj vetëmbrojtës veçse të distancohet nga këto besime.

Das Massaker an 4000 Tataren an der albanischen Bevölkerung

Aus Wien / vom 15. Januar:

Am vergangenen Freitag kam aus Albanien der neulich dorthin entsandte Eilkurier zurück und brachte Nachrichten aus Pristina vom 1. dieses Monats mit. Darin heißt es, dass der Herzog von Hessen nach seiner Genesung von einer schweren körperlichen Unpässlichkeit auf die Nachricht hin, dass der Feind mit einer großen Streitmacht plane, die kaiserlichen Quartiere anzugreifen und das Land in Schutt und Asche zu legen, alle notwendigen Vorkehrungen getroffen habe, um Widerstand zu leisten. Zudem sei es den albanischen Arnauten befohlen worden, nach Tetovo vorzurücken und die dort stationierten feindlichen Truppen anzugreifen und sich selbst dort einzumarschieren. Der Patriarch des Landes sei nach Pristina gekom-



men, um über die aktuelle Lage und mögliche Vereinbarungen zu sprechen.

Am 30. Dezember seien 4000 Tataren zwischen Kacencet und Tetovo über das Gebirge ins Kosovo-Feld vorgedrungen, zwei Stunden von Pristina entfernt, und hätten Bauern getötet und einige Dörfer niedergebrannt. Oberst Straßer und der Prinz von Hannover seien mit einem Kommando gegen die Tataren vorgegangen und hätten sie in einem Dorf gestellt, woraufhin der Feind die Flucht ergriff, dabei jedoch etwa 100 Tataren niedergestreckt wurden.

Auszug-Schreiben:
Aus Wien, Ungarn, Paris, Mainz, Frankfurt, Rom und den Niederlanden, etc.
Was es Neues in diesen Orten gab.
Gedruckt im Jahr 1690, am 21. Januar.

Masakrat e 4000 tartareve mbi popullatën shqiptare

Nga Vjena / më 15 Janar:

Të premtën e kaluar mbërriti nga Shqipëria korrieri i dërguar rishtazi dhe solli lajme nga Prishtina të datës 1 të këtij muaji. Në të thuhet se Duka i Hesenit, pasi u shërua nga një sëmundje e rëndë, pasi mori lajmin se armiku po përgatitej të sulmojë kampet perandorake dhe të shkatërrojë vendin, ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të bërë rezistencë. Gjithashtu, është urdhëruar që arnautët shqiptarë të marshojnë drejt Tetovës për të sulmuar trupat armike të stacionuara aty dhe për të zënë pozicionet e tyre. Patriarku i vendit ka ardhur në Prishtinë për të diskutuar situatën aktuale dhe mundësitë e marrëveshjeve.

Më 30 dhjetor, 4000 tartarë kanë kaluar përmes Kacencet dhe Tetovës, kanë kaluar malet për në Fushë Kosovë, dy orë larg nga



Pristina, dhe kanë vrarë fshatarë dhe kanë djegur disa fshatra. Koloneli Straßer dhe Princi Hanoverit kanë ndërhyrë kundër tartarëve, i kanë ndjekur në një fshat dhe armiku është tërhequr, duke humbur rreth 100 tartarë.

Shkresë ekstrakti:
Nga Vjena, Hungaria, Parisi, Mainzi, Frankfurti, Roma dhe Holanda, etj.

Çfarë ka ndodhur rishtazi në këto vende.
E shtypur në vitin 1690, më 21 Janar

Perktheu nga gjermanishtja Luljeta Rakipi

St. Louis Post-Dispatch (1913)

“Nëse Roosevelt-i dëshiron të bëhet mbret i Shqipërisë, ne do ta vendosim atë përpara të gjithë kandidatëve të tjerë të përmendur”

— Intervista ekskluzive me Ismail Qemalin në hotelin Cecil, në Londër

Nga Aurenc Bebja - Francë

“St. Louis Post-Dispatch” ka botuar, të dielën e 11 majit 1913, në faqen n°8, intervistën ekskluzive me Ismail Qemalin në hotelin Cecil, në Londër, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Theodore Roosevelt mund të jetë mbret (i Shqipërisë) nëse kërkon punë

“Ai thjesht duhet të na afrohet,” deklaroi lideri i kombit në kërkim të një monarku të fortë.

“Vendi im ka nevojë për një njeri”

Shpresojmë që ish-presidenti amerikan të përfillojë nga kjo hapje.

Kablo speciale për The Post-Dispatch dhe New York World.

Copyright, 1913, nga Press Pub. Co. (New York World.)

Londër, 10 maj. - The Post-Dispatch dhe New York World janë në gjendje t'i ofrojnë fronin e Shqipërisë Theodore Roosevelt-it. Negociatat janë çuar tashmë deri në atë pikë sa koloneli duhet vetëm të nënkuptojë gatishmërinë e tij për të pranuar dhe kurora është e tij.

“Nëse Roosevelt-i dëshiron të bëhet mbret i Shqipërisë, ne do ta vendosim atë përpara të gjithë kandidatëve të tjerë të përmendur. Personalisht, do ta votoja me siguri.”



Qeveria e përkohshme e Shqipërisë në Romë (Foto : Scavalli Vecchia) — Burimi : L'Illustrazione Italiana, 13 prill 1913, faqe n°348

Këtë e deklaroi sot me forcë Ismail Qemali, presidenti i përkohshëm i Shqipërisë dhe kreu i delegacionit të popullit shqiptar përgjegjës për gjetjen e një lideri të pranueshëm për ta nga konferenca e ambasadorëve të Fuqive të Mëdha. Qemali i shoqëroi fjalët e tij me gjeeste dramatike, sikur ta kishte vendosur me vendosmëri Roosevelt-in në fron.

Audienca e korrespondentit të The Post-Dispatch dhe The World me Qemalin u zhvillua në Hotelin Cecil, ku ai po qëndron, i shoqëruar nga bashkëdelegatët Luigj Gurakuqi, ministër i Arsimit dhe Noga, Konica dhe “Deletgus”. Ata e përshëndetën korrespondentin e The Post-Dispatch me përzemësi dhe mirësjellje të theksuar. Qemali është një zotëri flokëbardhë, mjekërbardhë, me të folur të ngadalte, dinjitoz dhe sjellje oborrtare (mbretërore). Djali i tij, i cili është me të, është një djalë i shkurtër, esmer, rreth 30 vjeç, vigjilent dhe i gjallë. Gurakuqi është më i gjati i delegacionit, me mbi gjashtë këmbë. Ai është i zgjuar dhe i fortë, me një çelhe të bronzit dhe mustaqe të zeza të trasha. Noga është një diplomat, i butë, i lëmuar dhe i rezervuar. Konica dhe “Deletgus” janë ushtarakë në dukje, me tipare të zbehta dhe trupa të thurur mirë.

I interesuar për sugjerim.

Të gjithë ata shprehën interesin më të madh dhe u befaskan dukshëm nga sugjerimi i The Post-Dispatch në lidhje me Roosevelt-in. Ismail Qemali tha duke buzëqeshur me kënaqësi:

“Kjo është më të vërtetë një ide amerikane, por përse duhet të kujdeset Roosevelt-i për t'u bërë sundimtar i Shqipërisë kur ai tashmë është pothuajse një Mbret në vendin e tij?”

Korrespondenti shpjegoi se perspektiva e

mbretërimit shqiptar dukej më e prekshme. Qemali u guduks nga risia e sugjerimit, të cilin ai e pranoi si kompliment për vendin e tij. Anëtarët e tjerë të grupit u ulën me padurim përpara në karriget e tyre, me ankh të mos humbisnin asnjë fjalë nga biseda, e cila u zhvillua në frëngjisht, pasi delegatët flisnin pak anglisht. Korrespondenti sugjeroi disa nga kualifikimet e veçanta të Roosevelt-it për këtë pozicion. Për shembull, ai do të ishte plotësisht i pamposhtur nga ndikimet evropiane. Qemali u pajtua, duke thënë :

“Ajo që thoni është e vërtetë. Roosevelt-i do të ishte i lirë nga ndikimi dinastik, i tillë që mund të binte mbi të emëruarit e tjerë, të cilët mund të kenë interesat e tyre për të mbrojtur.”

Korrespondenti vuri në dukje se Roosevelt-i kishte një forcë të madhe karakteri dhe nuk do të duronte asgjë të pakuptimtë nga jashtë, duke qenë si vetë shqiptarët, një luftëtar i lindur. Kësaj Qemali iu përgjigj:

“Kjo është e vërtetë. Roosevelt-i është një njeri i madh, i guximshëm dhe i drejtë; ai zotëron pikërisht karakterin e përshatshëm për mbretin tonë.”

Doli nga populli.

Korrespondenti dha më pas emra monarkësh të ardhur nga njerëz që kishin arritur famë të pavdekshme, ndaj të cilëve Qemali ngrii supet si për të thënë se nuk ishte i aftë të kundërshtonte të padiskutueshmen. Ai shtoi :

“Unë pajtohem që Roosevelt-i është një njeri i jashtëzakonshëm, i aftë për të përballuar një situatë të jashtëzakonshme dhe se ai është njeriu që i duhet vendit tim në këtë moment, kur ne kemi nevojë për një burrë

të fortë. Roosevelt-i i mbetet vetëm të na afrohet. Unë nuk e propozoj atë, por nëse ai do të propozojë veten, kjo është çështje tjetër. Ju ma keni sugjeruar emrin e tij dhe përgjigja ime është, pse jo?”

“Nuk ka njeri më të përshatshëm se ai për t'u ngjitur në fronin tonë. Unë ju them, nëse Roosevelt-i sugjeron veten, ne do ta vendosim atë përballë të gjithë të tjerëve. Nuk ka asnjë formë të veçantë etiketimi që duhet respektuar në paraqitjen e kandidatës së tij, sepse në krizën që po përballon Shqipëria nuk mund të bëjmë asnjë ceremoni se si mund të na paraqitet emri i Roosevelt-it.”

Korrespondenti vuri në dukje se Roosevelt-i nuk ishte një njeri që të qëndronte në ceremoni, nëse donte diçka. Ai nuk ishte skllav i mirësjelljes më shumë se shqiptarët. Qemali vazhdoi :

“Roosevelt-i është një gjuetar i madh dhe njerëzit tanë janë të famshëm për entuziazetë e tyre të gjuetisë, kështu që kjo lidhje simpatie na bashkon.”

Ismail Qemali shtoi me entuziazëm: “Nëse ai pranon të prezantohet, unë do të shkoj ta marr. Unë dëshiroj shumë të vizitoj Shtetet e Bashkuara.”

Deri te Roosevelt-i i ri. Pastaj dyshimi i çastit dukej se e pushtoi Ismail Qemalin, i cili pyeti: “Unë e di që Roosevelt-it i përshatet karakteri, trajnimi dhe aftësia dhe se ai mund të përshatet me çdo rethanë, megjithëse historia ka treguar se princat e importuar rralë kanë qenë në gjendje ta bëjnë këtë në mënyrë të kënaqshme, por a do të kishte para të mjaftueshme? Unë kurrë nuk kam dëgjuar se ai është një nga milionerët amerikanë. Do t'i duheshin mijëra e mijëra dollarë për të mbajtur një oborr mbretëror, qoftë edhe në Shqipëri. Kjo është një pikë që, për fat të keq, duhet ta kemi parasysh në zgjedhjen e një mbreti.”

Korrespondenti guxoi të sugjeronte se Partia Republikane, nga mirënjohja ndaj shërbimeve të kaluara të Roosevelt-it, pa dyshim do të ishte e gatshme ta subvenciononte atë për sa kohë që ai të qëndronte në Shqipëri. Qemali replikoi :

“Ah, kjo është mirë. Sugjerimi juaj na intereson thellësisht. Shpresoj se Roosevelt-i do të përfillojë nga mundësia që po i ofrojmë përmes The Post-Dispatch për t'u bërë lider i vendit tonë.”

Qemali nuk ishte në gjendje të thoshte se sa do të qëndrojnë delegacioni në Londër, por ndoshta do të qëndrojnë për të paktën dhjetë ditë. Aktualisht ata janë në pritje të çështjes së konferencës së ambasadorëve. Lëvizja tjetër qëndron tek Roosevelt-i.

* Çdo gazetë online apo print, çdo portal që merr këtë shkrim duhet të citojë autorin në fillim të shkrimit (Nga Aurenc Bebja, Francë) dhe burimin e informacionit në fund (Blogu © Dars (Klos), Mat – Albania), si dhe të vendosë linkun e burimit : . Në rast të kundërt mos e publiko.



Burimi : St. Louis Post-Dispatch, e diel, 11 maj 1913, faqe n°8

“Roosevelt-i është një nga njerëzit më të jashtëzakonshëm në botë, duke qenë për nga natyra në një nivel më të lartë se princat e thjeshtë.”

Duhet të kesh rrënjë të forta, që të mos shkosh atje ku fryn era!

Nga Muharrem Salihu - Venezia

- Protestë në Medvegjë kundër “spastrimit etnik dixhital”

Sot në Medvegjë, qindra qytetarë u mbledhën për një protestë domethënëse kundër praktikës së “pasivizimit të adresave”, e cila po denoncohet si një formë e spastrimit etnik dixhital kundër pakicës shqiptare në Luginën e Preshevës. Sepshku me mua dhe AFEDS, në vijën e parë të protestës ishin liderët lokalë si deputeti Shaip Kamberi, Ardita Sinani, kryetare e Preshevës, Nevzad Lutfiu nga KKSH, Shqiptim Musliu (LPD), Ragmi Mustafa dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit shqiptar dhe të Kosovës.

- Akuzë: fshirje e detyruar e shqiptarëve etnikë
Eliminimi i rreth 6.000 adresave të qytetarëve shqiptarë është një praktikë sistematike që, në fakt, e privon komunitetin shqiptar nga mundësia për të banuar ligjërisht në territoret e tyre. Kjo masë i kthen njerëzit e gjallë në të “vdekur de jure”, duke shkelur të drejtat individuale dhe kolektive.

- Një histori presionesh dhe padrejtësish.
Protesta synon të tërheqë vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar ndaj një praktike që vazhdon prej dekadash. Që nga riorganizimi territorial i viteve '50 deri të “pasivizimi” i fundit, popullsia shqiptare e Medvegjës ka përjetuar presione dhe migrime të detyruara, në atë që shumë e përshkruajnë si një spastrim i mirëfillt etnik.

- Brukseli dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të ndërhyjnë!



Protestuesit po bëjnë thirrje të fortë që institucionet evropiane dhe ndërkombëtare të ndalojnë këtë padrejtësi dhe të kundërshtojnë me vendosmëri politik diskriminuese të qeverisë serbe.

#Medvegja #LuginaePresheves #TeDrejtatNjerezore #SpastrimiEtnik #Pasivizimi #Bruksel

Devi avere radici forti per non andare dove soffia il vento!

Di Muharrem Salihu - Venezia

- Protesta a Medvegjë contro la “pulizia etnica digitale”

Oggi a Medvegjë, centinaia di cittadini si sono riuniti per una protesta significativa contro la pratica della “passivizzazione degli indirizzi”, denunciata come una forma di pulizia etnica digitale contro la minoranza albanese nella Valle di Presheva. Insieme a me e all'AFEDS, in prima linea alla protesta c'erano i leader locali, come il deputato Shaip Kamberi, Ardita Sinani, presidente di Presheva, Nevzad Lutfiu del KESH, Shqiptim Musliu (LPD), Ragmi Mustafa e altri rappresentanti della comunità albanese e del Kosovo.

- Accusa: cancellazione forzata degli albanesi etnici

L'eliminazione di circa 6.000 indirizzi di cittadini albanesi è una pratica sistematica che, di fatto, priva la comunità albanese della possibilità di risiedere legalmente nei propri territori. Questa misura trasforma persone vive in “morte de jure”, violando i diritti individuali e collettivi.

- Una storia di pressioni e ingiustizie

La protesta mira ad attirare l'attenzione della comunità internazionale su una pratica che prosegue da decenni. Dalla riorganizzazione territoriale degli anni '50 fino alla recente “passivizzazione”, la popolazione albanese di Medvegjë ha vissuto pressioni e migrazioni forzate, descritte da molti come una vera e propria pulizia etnica.

- Bruxelles e la comunità internazionale devono intervenire!

I manifestanti chiedono con forza che le istituzioni europee e internazionali pongano fine a questa ingiustizia e si oppongano con determinazione alle politiche discriminatorie del governo serbo.

#Medvegja #ValledellaPresheva #DirittiUmani #PuliziaEtnica #Passivizzazione #Bruxelles

You need strong roots to not be swayed by the wind!

By Muharrem Salihu - Venice

- Protest in Medvegjë against “digital ethnic cleansing”

Today in Medvegjë, hundreds of citizens gathered for a significant protest against the practice of “address passivation,” which has been denounced as a form of digital ethnic cleansing against the Albanian minority in the Presheva Valley. Alongside me and AFEDS, local leaders at the forefront of the protest included MP Shaip Kamberi, Ardita Sinani, the president of Presheva, Nevzad Lutfiu from KESH, Shqiptim Musliu (LPD), Ragmi Mustafa, and other representatives of the Albanian community and Kosovo.

- Accusation: forced erasure of ethnic Albanians

The elimination of around 6,000 addresses of Albanian citizens is a systematic practice that effectively deprives the Albanian community of the right to legally reside in their own territories. This measure turns living people into the “deceased de jure,” violating both individual and collective rights.

- Brussels and the international community must intervene!

Protesters are strongly calling on European and international institutions to stop this injustice and resolutely oppose the discriminatory policies of the Serbian government.

#Medvegja #PreshevaValley #HumanRights #EthnicCleansing #Passivation #Bruxelles

Studime e përshkrime me vlerë të Eugenio Barbarich mbi qarkullimin rrugor në trojet shqiptare

Nga Bajram Peçi- Tiranë

Prej botimit “Shqipëria etnike dhe gjeografike”, vepër e Eugenio Barbarich, i përruar para pak muajsh si një nga prurjet e fundit më serioze dhe me vlera plotësuese për historinë, për gjeografinë dhe antropogjeografinë e trojeve shqiptare, zgjodha t’i kushtoj një vështrim kapitullit mbi rrugët e lëvizjes dhe komunikimit të ndërmjetëm mes krahinave e vëndeve fqinje.

Vepra voluminoze e autorit, e vitit 1905, sjell të dhëna të mjafta përshkuese e plotësuese. Me një karrierë ushtarake të ngjeshur e të ndritur, autori shkëlqeu në hartimin e monografive. Prej tyre veçon vepra “Albania” e cila rrjedh nga shënimet studimore gjatë eksplorimit të trojeve shqiptare dhe rajoneve kufizuese të tjera të Ballkanit. Duke përshkruar vendet që kishte vizituar, përpos çështjeve politiko-ushtarake të kohës së tij, ai u kushtoi vëmendje përshkrimit të trojeve male e fusha; brigjeve dhe ujrave; klimës e bimësisë; popullsisë e gjuhës; rrugëve e toponimeve; historisë, ekonomisë dhe traditave. Ishte hera e parë që vëndit tonë do t’i kushtohej një studim kaq kompleks dhe i shumëanshëm.

Vëndet e Ballkanit, ndonëse lehtësisht të arritshme nga Gadishulli Apenin, për qytetërimin latino-roman, mbeteshin njolla të zeza, posaçërisht Shqipëria në tërësinë e 4 vilajeteve ku shtrihet. Deri në fundshekullin e 19-të hyrja ka qenë e kufizuar, ngase pushtimi i gjatë otoman, edhe pas pavarësisë greke, ruante me fanatizëm në bregun jugo-lindor të Adriatikut sundimin ushtarako-feudal dhe pushtetin politiko-fetar.

Kronikat e shekullit 19-të na japin shënime udhëtarësh në Shqipëri, si Ami Boue, Johan Georg fon Hahn, në konsullit francez, Aleksandër Degrand; arkeologut gjerman Trager, Edith Durham, etj., që kanë sjellë vëzhgime ose studime të pjesëshme. Europeanët perëndimorë dinin pak për Shqipërinë e shqiptarët, deri kur Porta e Lartë, sundimi Osman, fillon të lëkundet në pjesën e gadishullit ilirik dhe dyert lirohen paksa nën tryninë e fuqive. Ora e rënjes së Perandorisë Turke kishte ardhur! Pikërisht në këtë periudhë hyn me mision në Shqipërinë e robëruar ushtaraku i rangut të lartë, Eugenio Barbarich, që vrojton, studion, mban shënime, i sistemon ato, prej të cilave do rrjedhë më pas vepra antropogjeografike. Orvatia ime synon të shkëpus e të jap nga vepra “Albania” disa nga prurjet që i përkasin komunikimit rrugor e që paraqesin interes për të njohur gjendjen e asaj periudhe.

Për Via Egnatia ose rruga Ilire

Në krye, për këtë rrugë sunduese, sepse ka qenë i pari element i dukshëm i civilizimit në trojet tona, vjen si vepër prej pushtetit romak, i cili shprehej në ndërtimin e rrugëve ushtarako-tregtare. Nga lindja vinin drejt Romës mallra pa fund, drithra, pëlhura e pije, që ushqente e vishte Romën perandorake. Kjo rrugë duhej të ruhej nga grabitësit e shkelësit e ligjit. Rruga i shërbente Romës për të mbrojtur të nënshtruarit dhe të nënshtronte të pabindurit. Të gjitha degët e rrugëve lindore, që përfundonin në Dyrrah, Apoloni, Skutari dhe Aulona, mbroheshin në thellësi nga legjione romake. Në përshkrimin e hollësishëm të stacioneve, autori i “Albania” cilëson Kavajën si Klodianën, pikën e takimit të dy degëve, si duket me informacion të gabuar për Peqinin. Të dyja këto ishin Mansions (bujti për udhëtarët) dhe mutation (stacione postare dhe vend ku ushqeheshin dhe këmbeshin kuajt). Në rrugët romake mansiones ishin në të njëjtën distancë nga njëri-tjetri, mesatarisht 15 milje. Janë pikërisht distancat milje që provojnë Peqinin si pikë takimi.

Romakët ndërtuan gjatë Egnatias një rrjet rrugor, të sigurt për çdo mot. “Ata ndërtuan - thotë historiani Georges Castellani - një rrjet rrugor që depërtoi thellë në kaosin ballkanik. Rruga Egnatia ishte më e njohura. Të gjitha u paisën me kalldrëmin për kalimin e karrove, katër kalorësve sup më sup”. Porta e hyrjes në Ballkan ishte Durrësi”. “Çdo përura, çdo lumë - thotë historiani Faverial - kishte një urë të fortë”. Ndërtimi i një zinxhiri fortesash romake



Gjurmë të rrugës Egnatia krah Lumit Shkumbin

përgjatë rrugëve, çoi në lindjen e bashkësive të mëdha. Rruga Egnatia, që për shekuj të tërë kish lidhur Romën perandorake dhe Venedikun e shkëlqyer, me trojet ku banonin shqiptarët, në kohën kur shkeli Barbarich nuk përdorej më. Po kështu, nga sa na kanë lënë trashëgim Itinerari i Antoninit dhe Itinerari i Burdigalës ose Hierosolymitani, edhe rruga prej Apollonisë në Larisë përgjatë luginës së Vjosës dhe asaj të Drinos; rruga prej Shkodrës në Danub si dhe rruga e bregdetit nga Acta Nicopoli (Preveza) deri në (Dalmaci), nuk njiheshin më të kishin lëvizje dhe madje nuk njiheshin egzistenca e tyre. Për këtë rrugë autori jep detaje me interes që rrjedhin prej Luftës Maqedonase (fq.182), kohë kur konsulli Galba fillon të përshtasë rrugët midis lumenjve Shkumbin dhe Seman për të siguruar komunikim me “Liqenet e mëdhenj” (Ohër e Prespë) të cilat më pas do jenë zëfilli i rrugës së ardhshme Egnatia. Autori shënon se konsulli Galba la garnizona të forta me ilirë e dardanë në rrugën nga Apollonia në liqene.

Autori gjithashtu thekson se kjo rrugë, e ndërtuar ekskluzivisht për qëllimet ushtarake të lëvizjeve të legjioneve të Romës, ka përfaqësuar në çdo kohë lidhjen më të shpejtë dhe më efektive midis qytetërimeve lindore dhe atyre perëndimore. Gjithë mallrat që Venediku shkëmbente me Lindjen kalonin në këtë rrugë.

Në 1900-tën, në kohën kur E. Barbarich ndoqi linjën e kësaj rruge të famshme, pa ende gjurmë të saj vënde-vënde dhe përmend faktin se traseja e hekurudhës moderne nga Manastiri në Selanik shtrihet, në disa pjesë të saj, në gjurmët e rrugës Egnatia.

Elementët urbanë të rrugëve që pa autori

Perandoria osmane është një prapambetje feudale në tërësinë e territoreve ku ajo shtrin sundimin, por edhe më e prapambetur është në Shqipëri. “Rrugët-shënon autori-në përgjithësi ndjekin një gjurmë të mundimshme, kanë fund të parregullt dhe kthesa shumë të forta. Ato i nënshtruan rrëshqitjeve të dheut... ndryshimeve të papritura të kursit, për të shmangur përmbytjet në fushat kënetore. Prandaj ka dy rrjete rrugore...për periudhën e thatë, tjetri për gjatë periudhës me shi”. Si ushtarak autori fillimisht dallon kryesisht ato rreth kështjellave dhe ndërtimeve të natyrës ushtarake, si Drishti, Drivasti me rrugët e Kirit, Danjës, Sardës. Të gjitha këto lidheshin me kështjellat e Shkodrës dhe Lezhës. Më tej, Kruja që lidhej me Durrësin dhe kështjella e Kaninës që lidhej me Vlorën.

E. Barbarich në veri dallon tre rreze kryesore të komunikimit me brendësinë, rruga që kufizohet me bregun lindor të liqenit dhe shtegu të mushkës për Guci, rruga nga Shkodra për Gjakovë e më tej, rruga shteg mushke drejt Krujës, Tiranës dhe Elbasanit. Nga bregdeti kryesisht shkohej drejt kështjellave dhe qyteteve me karroca ose rrugë kafshësh pjesërisht të mirëmbajtura. Gjithashtu, autori veçon gjurmët e rrugëve të Beratit, Gjirokastrës e Janinës, që korrespondojnë me vënde topografisht të identifikuar mirë me historinë ushtarake shqiptare dhe vë në pah se rrugët e komunikimit të Vlorës me brendësinë e saj malore, me drejtim Gjoro-

kastrën dhe Janinën nuk janë të mira, ndërsa drejt Sarandës si rrugë dhe shteg mushkash kalon më me siguri në ultësirën e Muzinës.

Autori pranon që në krye të përshkrimeve se njohja e itinerareve nuk mund të jetë e plotë dhe as e saktë, ndonëse ka patur ndihmë dhe ka përdorur hartën austriake të shkallës 1: 200,000. Hyrje-daljet detare përmenden për portet Shëngjin, Durrës e Vlorë. Në Durrës operon Llojdi austriak, Ragusa dhe Pulja. Në Shëngjin operojnë 4 kompani navigimi: Llojdi austriak, Pulja e Barit, Ragusa dhe Ungaro-Kroati. Grykëderdhja e Bunës ka qenë mirë e lundrueshme, deri kur Drinasa kapërxeu më 1859 dhe Drini humbi rrjedhën e mbushi Bunën. Në kohën kur autori i shkel këto vënde, në liqen e Lumin Bunë hynin e dilnin varka të vogla ose mesatare me vela, por dhe me avull. Kompania anglo-malazeze e lundrimit gjithashtu e përdorte linjën deri në grykëderdhje. Në Vlorë operonin shoqëritë detare të Llojdit, Puljas dhe disa kompani greke e turke. Lumi Vjosa, që dikur kish qenë e lundrueshme deri në Apoloni, nuk del të kishte më rëndësi komunikimi për transportin e mallrave.

Mbi komunikimet e pellgjeve të lumenjve Drin-Shkumbin-Vjosë

Autori i nis vëzhgimet nga veriu shqiptar. Prej Ulqini dallon se kalohet me mallra dhe njerëz për në Shkodër përmes një shtegu “të mirë” mushkash, bregut të djathtë të Bunës dhe lidhet me rrugën tjetër të mushkave, që vjen nga Tivari. Në mbërritje nga Ulqini ka një copë rrugë karrosh, deri te ura e Bunës.

Rrugët e karrocave janë fare pak. Nga Durrësi në Tiranë janë 37 km; Shëngjin-lezhë 7 km; nga Shkodra në Koplak disa km rrugë karro dhe nga Vruja në Guci e Plavë; nga Peja në urën e Dresnikut; Gjakovë-ura Terziut; nga Prizreni rrugë karro për Ferizaj dhe Prishtinë; Larushk-Valias disa km rrugë karrocash dhe Vlorë-Skelë 2 km. trase karrosh. Për transport me qerre funksiononte rruga Korçë-Manastir dhe Berat-Përmet. Një rrugë karrosh lidhte edhe Strugën me Manastirin. Përmendet një rrugë legjionesh (këmbësore) që niste nga Lezha që të çonte në rrugën Egnatia.

Kufizimi dukshëm i rrjetit rrugor me trase karrocash kish përhapur transportin me mushka, që vinte si përvojë nga lashtësia. Autori përmend përdorimin e rrugëve të mushkave nga Pulaj në Bushat-Shkodër. Një shteg mushkash përshkonte alpet nga Boga në Pejë dhe një shëg tjetër përshkonte prej Shkodrës në Prizren; në udhëkryqin e Gjonpepajt bashkohen dy rrugë mushkash që vijnë nga Oroshi e prej këtej shtegu i çon tek Ura e Vezirit. Nga Prizreni shënohet një shteg mushkash përmes maleve të Sharrit që mbërrin në Tetovë; në të djathtë të Drinit niset prej Shkodrës një rrugë mushkash që kalon në Pukë-Qafë Mali e mbërrin në Kukës. Prej Kukësi një shteg mushkash të nxirrte në Dibër. Një tjetër shteg mushkash prej Beratit t nxirrte në Korçë. Në Shqipërinë e mesme autori përmend rrugët e mushkave Tiranë-Qafë Krabë-Fushë Mret-Elbasan. Copa të rrugës Egnatia përdorëshin për rrugë mushkash nga Elbasani në Qukës, Strugë e Manastir. Plotësisht e pa kalueshme për në Korçë në dimër ishte zona kënetore e Maliqit.

Kalimi i pengesave ujore, siç del nga vepra “Albania”, ka qenë një sfidë serioze për qarkullimin. Shënohen në këtë kohë një urë mbi Bunë, tre ura guri mbi Drin, një mbi Kir, një urë mbi



Urë druri në veriun shqiptar dhe mushka transporti në vitet 1900

Shkumbin që vijon me rrugë mushkash e të nxjerr në Berat, një urë mbi Osum (e Beratit). Mbi Shkumbin ishte edhe ura e gurtë e Kamares. Një urë druri kalonte mbi Drenicë e një tjetër mbi Sitinë. Ka patur disa ura druri mbi përrenjtë e Mërturit. Në jugun shqiptar, me rëndësi ka qenë ura e Kordhocës në luginën e Drinos, që në atë kohë ishte ura lidhëse për qytetet Gjirokastrë, Libohovë dhe Janinë. Përdorimi për transport i kacakëve me lëkurë të dhisë ka qenë shumë i përhapur për kalimin e mallrave dhe njerëzve në Drin e Mat. Në lumenjtë Vjosë, Seman e Shkumbin, në segmentet e poshtme, përdorëshin barka ose lundra të gdhëndura nga trungjet e pemëve. Në Shqipërinë e mesme dhe jugore përdorej lundra prej dërrase. Kalimi në va (cektina lumore) ishte një zgjedhje shumë e përhapur, por varej gjithnjë nga kushtet e motit.

Transporti i mallrave

Në rrugët, që E.Barbarich përmend, bëhej transporti i mallrave për eksport apo import ose shpërndarje sipas nevojave në brendësi. Autori i “Albania” përmend si mjete transporti karrocacat bujqësore, që janë tip arabas, të gjata dhe të ngushta. Tërhiqeshin nga kuajt, qetë dhe buajt. Nga veriu dhe nga jugu, drejt Durrësit dhe Vlorës, produktet tokësore të Shqipërisë rrjedhin nga brendësia në bregdetin e Adriatikut, drejt Manastirit e Selanikut. Autori përmend përvojën me tregun e Venedikut, pas pushtimit të egzistuarit të tregtisë së serenitas, ndjekjen e tranzitit në po ato gjurmë rrugësh. Vepra sjell disa të dhëna me shumë interes për llojshmërinë dhe sasinë e një sërë mallrash që qarkullonin në këto nyje lidhëse rrugore, karrocash ose mushkash. Kështu, përmenden eksporti i 10 mijë kv drithëra nga fusha e Zadrimës drejt Triestes; 200 mijë lira (monedhë e Italisë) dru kedri nga vilajeti i Janinës dhe dru lisi e valanidh nga malet e Himarës; nga Durrësi 30 mijë kv vaj ulliri, që vinin kryesisht nga Kruja; 3000 kv bishtajore; 25.000 kv kripë nga kriporet e Durrësit dhe 40.000 kv nga kriporet e Kavajës. Për transportin e 35 mijë kv bitum nga Selenica ishte një rrugë pjesërisht e mirë fushore kafshësh, e mirëmbajtur nga shoqëria franceze që bënte shfrytëzimin e minierës e që e çonte prodhimin deri në skelë, nga ku eksportohej me anije.

Vepra “Albania” del dhe bëhet e njohur në kohën kur shqiptarët luftonin për shtetësinë e tyre e cila, siç do të shihet më vonë, ajo nuk do ta fitonte dot pavarësinë pa mbështetjen e plotë të dy fuqive, Austro-Hungarisë dhe Italisë. Hija e Perandorisë Ruse ishte e pranishme përherë edhe në këtë skaj të Perandorisë Otomane, çka rrezikonte humbjen e identitetit shqiptar, coptimin e saj. Ata që kishin dëshirë e mundësi të shihnin me sytë e tyre përhapjen e qytetërimit në një Shqipëri të pavarur, u lejuan nga qeveritë e tyre të vinin, të udhëtonin e shkruanin për këtë vend. Ishin të shumtë qëmtuesit hungarezë, austriakë, gjermanë dhe italianë. Mes tyre, pamëdyshje, shquhet Eugenio Barbarich, i cili, me veprën studimore që botoi, lajmëroi praninë së shpejti në këtë hapësirë të një qytetërimi europian. Vepra e tij gjeti terren dhe u përhap atëbotë te intelektualët arbëreshë të Italisë dhe atdhetarët rilindas të Shqipërisë, shpresëtarja liberale e të cilëve ishte tipar i fillim viteve ‘900.


Autori-studiuues i para 120 vjetëve, me vërtetësinë e tablosë shqiptare (një pjesë të vogël të së cilës e sollëm këtu), na njeh me realitetin e kohës së karrove, kuajve e mushkave, të cilat kanë ecur krah për krah me historinë njerëzore. Studimi i gjithanshëm e i dokumentuar i trojeve shqiptare prej Eugenio Barbarich na jep modelin e të shkruarit për emanicipimin e një populli të shtypur për një periudhë kaq të gjatë kohe, duke qenë pjesë e pandashme e Europës. Në mbyllje të këtij vështrimi në ndihmesë të të shumënjohurës, organit “Rrënjët”, patjetër që jam i prirur të falënderoj si lexues z. Hasan Aliaj, znj. Fitije Picari dhe përkthyesen nga italishtja në shqip, znj. Meri Gjoleka Shaqiri. Përkushtimi i tyre bëri të mundur të na sjelli veprën “Albania”, deri tani e panjohur për lexuesin shqiptar.

Fokusimi i lashtësisë shqiptare në thellësitë e shekujve

Nga HASAN GREMI - Tiranë

Këto ditë më ran në dorë monografia "SHQIPËRIA ETNIKE DHE GJEOGRAFIKE", e cila është e veçantë në llojin e vet e autorit italian Eugenio Barbarich, përgatitur për botimim shqip nën kujdesin e veçantë të drejtorit editorial të gazetës "Rrënjët" z. Hasan Aliaj, znj. Fitije Picarit, redaktorit z. Andrea Llukani dhe përkthyeses znj. Meri Gjoleka Shaqiri të cilët i japin lexuesit shqiptar me zë historik lashtësinë e këtyre trojeve sa të

Në pjesën e dytë autori shpalos me vëmendje botën shpirtërore të shqiptarëve, gjuha e veçantë që nuk ngjason me gjuhët e vendeve të tjera, epokat historike (Iliro-Romake, Bizantine et.), besimet fetare, ku spikat thekshëm heroizmi i shqiptarëve deri në madhësi gjatë luftave shekullore, për mbrojtjen e tërësisë së territoriale nga sulmet e pushtesve barbarë, konkretizuar me figurën legjendare të Gjergj Kastriotit etj. Autori i kushton vëmendje edhe traditave, etnografisë etj, dhe kodit zakonor "Ligji të Maleve" që rregullon marrëdhëniet



lashta aq edhe të vuajtura, fatëkeqësisht sot të copëtuara...

Në përmbajtjen e kësaj monografie spikasin prurjet e dëshmime të pathëna që sjell zoti Aliaj nga një hulumtim dhe studim disaveçar i fakteve historike dhe i dokumente qëmtuar në shtypin e huaj nëpër kohërave etj, të cilat me induksion dhe deduksion të shpien nëpër thellësitë e shekujve me fokusim qartasi dhe të pakontesueshëm në identitetin e etnosit të lashtësisë së kombit tone, si dhe luftrat në rrjedhën e historisë për të ruajtur ekzistencën dhe vazhdimësinë kombëtar në shtrirjen gjeografike në Gadishullin Ilirik, (në pushtimin ottoman me emrin Ballkan), të cilat janë një zë i fuqishëm i dëshmime të lashtësisë që bëhen të dukshme jo vetëm prej shqiptarëve, po edhe të huajve që, jo pak herë janë munduar ta errësojnë këtë lashtësi.

Mund të themi se monografia është një antologji e përbërë prej tri pjesësh të cilat autori i lidh organikisht nëpërmjet interpretimit të fakteve dhe dëshmime të historigrafisë, të cilat jepen në pjesën e parë që nga Etnosi dhe shtrirja gjeografike ndarë në "Pellgje" të emërtuara me emrin e vendeve ku shtrihen bashkë me fushat, malet, ujërat mbitorësore (lumenj e liqej), nëntokësore, bregdeti etj, bimësia dhe klima të cilat i "pikturon" qartë.



Z. Fitije Picari duke dhuruar librin "Shqipëria Etnike dhe Gjeografike"



Akademiku z. Neritan Ceka duke lexuar librin "Shqipëria Etnike dhe Gjeografike"

sociale dhe ekonomike midis tyre, ku vendoste drejtësia me gjykim popullor, për shurjen e konflikteve sociale. Autori nuk lë jashtë vëmendjes edhe zhvillimin ekonomik të bujqësisë kultivimi i llojeve të tyre, dhe zhvillimi i zejtarisë, njohur edhe jashtë kufijve të Arbërisë. Në pjesën e tretë vihet në dukje se Shqipëria nuk është vend i izoluar nga Europa, po historikisht ka patur marrëdhënie tregëtare me të nëpërmjet limanëve dhe rrjetit rrugor tashmë të njohur rruga Egnatia si urëlidhëse e Lindjes me Perëndimin. Është për t'u nderuar puna e vyer e autorëve se sjellin vlera të veçanta në historografinë shqiptare, aq të domosdoshme për lashtësinë tonë.

Pa pretenduar se është thënë gjithçka për këtë monografi e cila për nga rëndësia e përmbajtjes mund të quhet një miniciklopedi që hap shtigje të reja për studiuesit albanologë, historianë, etnografë...

Libri dallohet për një gjuhë, hartografi dhe etnografi të qartë për lexuesin.

Faji i Emës

(tregim psikologjik)

Nga ALMA ZENELLARI - KUÇOVË

Janë orët e para të mëngjesit. Ajri i nxehtë i korrikut ka mbështjellë plotësisht bibliotekën. Pavarësisht nxehtësisë së çmendur njerëzit nuk vonojnë të vijnë, sikur duan të shuajnë etjen aty, mes librave. Pas përshëndetjeve të zakonata, ata humbasin nëpër raftet duke kërkuar tituj dhe autorë. Ulem dhe diçka shkruaj në regjistër. Papritur një zë i mprehtë gati si piskamë thyen qetësinë. Ngrita sytë habitshëm dhe pranë meje pash statujën e tretur të Emës, me flokë të pakrehur, të lyrtë dhe fytyrën krejt të zvogëluar. Nuk e prisja. Mbete krejt e befusuar nga pamja e saj.

Dy rruaza qelqi futur thellë në zgavrat e përskuqura, lëviznin me shpejtësi plot ankth e alarm duke vështruar herë mua, herë lexuesit, herë nga raftet me libra. Goja e saj gati e çapëlyer hapje e mbyllej duke nxjerrë jashtë ca tinguj të paqartë. Mbi trup i varej një fustan i çrregullt, i gjerë me ngjyra të zbehta, të përhumura i cili ia vinte në dukje peshën e humbur trupore. E përshëndeta, por ajo si të vinte nga një tjetër dimension fliste me një ton të lartë acarues dhe pse i bëja shenjë ta ulte pak zërin sepse ishim në bibliotekë. Gishtat e Emës si zgjatime kërcësh (të një bime të tharë që nuk arriti kurrë të lulëzonte), lëviznin të tensionuar mbi kartelat e renditura mbi tavolinë. Gjithë qenia e saj fërgëllonte para meje. Luhatej majtas djathtas si gjuhëz e zbehtë qiriri.

U plotësova kartelat dy vajzave që me sy më kërkonin tu shërbeja me shpejtësi. Isha e sigurt se sjellja e Emës dhe era e rëndë e trupit të saj u kishte shkaktuar frikë dhe neveri njerëzsh. Ikën nxitimthi duke lënë mbi të vështrime të hidhura. U ktheva sërish tek Ema, zëri i së cilës nuk di pse më shkaktonte një ndjesi të keqe. E pyeta qetësisht për të kuptuar se çfarë e shqetësonte. Pse ishte e acaruar, dhe a kishte marrë mjekim gjatë këtyre muajve. Por Ema nuk tundej nga e saja, vazhdonte të njëjtat pyetje, të njëjtat fraza. E preka paksa nga krahët hollakë si për ta kthyer në realitet. Çuditërisht iu shmang prejjes sime a thua se edhe unë i shkaktova frikë. Me sytë e tejhapur, papritur mu drejtua "unë nuk orientoem dot, më duket se po çmëndem. Më jep një libër... Po ti më ndihmon dot?".

Shtanga. Fjalët e saj më rrëqethën. Për një çast mu bë sikur diçka e fortë më kish goditur pas koke. Një dhimbje therëse më kaploi trurin.

Ema 30-vjeçare, e cila vuante prej kohësh nga simptomat e depresionit, tani gjendej plotësisht e mbërthyer nga kthetrat e tij. Herët, kohë më parë i jepja ndonjë këshillë a detyrë të thjeshtë me shpresën se ajo do bashkëpunonte për të shpëtuar jetën e saj. Por kuptoja se nuk bënte asgjë nga ato ç'ka i thosha. Një ditë kërkova edhe nga nëna e Emës që ta ndihmonte të bijën duke i bërë të qartë rrezikun që po i kanosej. Por as prej saj nuk pash ta merrte seriozisht problemin e të bijës.

Tani, Ema fatkeqe ndodhej përpara këtij çasti fatal, e vetme. Gjendja mendore ishte rënduar aq sa edhe ajo vet nuk i duronte dot lojërat e hidhura që i sajonte truri.

Qëndronte ballë meje. Më shihte e trembur, e thyer, e pashpresë duke klithur si një zog vajtimtar. Zëri i saj më godiste si një toptih i zjarrtë timpanët e veshëve. Vështrimi i alarmuar më rrëqethte dhe më bënte të

ndihesha e pafuqishme për të bërë diçka. Dhe pse m'i kish ngulur sytë sikur të kish gjetur tek unë një dritare a një portë shpëtimi, për të dalë nga ai tunel i errët, nga ajo gropë thithëse që rrezikonte ta përpinte të tërën.

"O zot, i thash vetes pa zë. Si katandiset njeriu nga mungesa e përkujdesjes, si deliron dhe humbet shpirti kur gjendet i braktisur". Dëshpërimisht i kthehem - Ema, ti ke nevojë për mjekim. Një këshillë e imja tani nuk të vlen. Duhet urgjentisht të shkosh tek një mjek.

-Po më ndihmo ti, se ti di...

-Ema- e shkunda nga supet. Unë nuk jam mjek. Ty të duhet një mjek...

Fjalën "psikiatër" nuk e përmenda sepse nuk e dija si mund të reagonte ajo dhe aq më tepër i druhesha lexuesve të cilët tanimë e kishin dëgjuar bisedën dhe po e shihnin me dhembshuri. Ema e frikësuar prej tyre u struk më pranë meje. Unë i zgjata një libër, të cilin e rëmbeu dhe e ngjeshi në krahë. Nuk di çfarë i tha këtë herë truri. Ngrita sytë që s'di pse mu dukën të lagësht prej lotësh të paderdhur dhe... iku.

Iku dhe unë shihja si lëkundej nëpër rrugë trupi dhe shpirti i saj i grabitur nga përbindëshat e padukshëm. Si rendte duke lënë pas zurmën e sandaleve, që më ngjasonin me dy pranga të vogla të cilat i gjymtonin kyçet e këmbëve skeletike..., dhe ajo pengohej. Iku ankthioze, e tronditur. E trembur nga kushedi ç'djaj, të cilët i kishin zaptuar dhe po i hanin trurin, trupin, pse jo vet jetën. Fustani i saj i dalëboje dukej sikur mbështillte gjithë tmerret dhe frikërat e saj duke mos e lënë të lakuriqtë përballë syve përcmues, përballë indiferentizmit njerëzor në këtë shekull të pazakontë.

E ndoqa me sy derisa trupi i saj i drobitur u shndërrua në një trajtë të paformë që luhatej mbi horizont. Nuk isha në gjendje të mirë shpirtërore. Ardhja e befutë e Emës, tikitë tinzare të gishtave të palarë, tingujt e pakuptimtë, të paqartë që nxirrte me shpresën për ta ndihmuar dikush, për t'ia sosur tmerrin e vetmisë që po e çmendte; të gjitha këto më bënë të kuptoja se sa të brishtë jemi të gjithë kur fillojnë të këputen hallkat mes njerëzve, kur mbetesh i pambrojtur, i papërkrahur nga askush. Kuptova për fat të keq boshësinë e frikshme që rrethon jetët tona, ashtu si Ema e cila kish kohë që kish humbur në një botë të shkretët pa tinguj, pa melodi, pa ngjyra e drita. Nuk dija ç'përgjigje mund tu jepja pyetjeve që çdokush mund t'ja thoshte vetes kur e shihte në rrugë a ndonjë kthinë me trupin që sa vinte i kërrusej, me fytyrën që sa vinte i zvogëlohej, dëshmi e qartë e harresës.

Cili ishte faji i Emës ndaj kësaj bote të verbër që kish mbyllur sytë, veshët përballë fatkeqësisë së saj... Cili ishte faji i Emës, që tani gjendej në fund të një humnere, në një zgrip të humbur e mbërthyer nga kthetra demonësh. Vuante nga ethet e përditshme të ankthit, stresit, e pasigurtë dhe e paafitë për ta shkundur këtë pluhur dhimbjesh nga vetja. Bindja ime më thoshte se do të mjaftonte vetëm "një dorë" për ta tërhequr me forcë nga ai ferr, për ta nxjerrë këtë grua të re, nga kurthet e trurit të sëmurë, për ta shpëtuar nga ai moçal i pistë që po ia mbyste jetën me shpejtësi. Duhet patjetër "një dorë" për t'ia mbledhur dhe qetësuar me kujdes peizat e shpirtit, për të ndezur një dritë brenda errësirës që e kish zaptuar, brenda atij terri të trashë që e bënte botën e saj të rënkonte.

"E vetme nuk do të mundej kurrë".

OMAGGIO A MADRE MACRINA RAPARELLI

Di Marina Gentilini – Grottaferrata

Il 3 ottobre 2024, nella prestigiosa cornice dell'Abbazia di San Nilo in Grottaferrata, l'Azione Cattolica del Sacro Cuore, la Comunità Monastica, con il patrocinio del Comune, hanno inteso rendere un particolare omaggio di stima e di affetto a Madre Macrina Raparelli, fondatrice della Congregazione delle Suore Basiliene.

Elena Raparelli, nativa di Grottaferrata, crebbe nella spiritualità della tradizione cattolica di rito bizantino della religiosità connotante la vita della Chiesa di Santa Maria, la cui dedizione giunge nell'anno in corso a celebrare il suo Millenario. La concomitanza dell'anniversario ha reso pregnante l'incontro di istituzioni, cittadini, familiari, chiamati a testimoniare il loro tributo di gratitudine alla donna che ha fatto della sua vita una missione caritatevole di umiltà cristiana, alimentata dalla fede indefettibile nella forza della comunione dello spirito, del principio salvifico dell'unità.



Il convegno si è aperto con il saluto di Padre Francesco De Feo, egumeno dell'Abbazia, di Don Claudio Cirulli, parroco e assistente diocesano della Diocesi di Frascati, del sindaco Mirko Di Bernardo.

Sono seguiti interventi di escursione storica sulle caratteristiche sociali ed economiche della



nostra realtà urbana ai suoi albori, considerata nel passaggio cruciale dal XIX al XX secolo. I dati riferiti da Alberto Procaccini, Ludovica Pagano Procaccini e Stefano Paolucci, scrittore ed archivist, hanno restituito l'identità originaria di una compagine civile nata nelle pertinenze del monastero, alla sua presenza intimamente legata, per un fattore di riconoscimento criptense inscindibile e per questo connaturante. Sorprendono la bellezza e l'intensità di una vocazione che ha ispirato un progetto di vita fondato sul dono, sul sacrificio, sul soccorso fraterno nel bisogno ad alleviare la sofferenza. E ciò si offre con chiarezza alla nostra coscienza, svelando il potere rivoluzionario del coraggio di saper rinunciare al conforto domestico di certezze esistenziali per un'avventura sconvolgente di amore senza condizioni, risparmio e riserve.

Questi elementi valoriali sono emersi dalle parole di Fratel Clemente Corsaro, della Madre Generale Michaela Toma, di Madre Elena Lulashi, Suore Basiliene Figlie di Santa Macrina, che hanno illustrato l'esperienza delle sorelle Raparelli, Macrina ed Eumelia, al secolo Elena e Agnese, fedelmente solidali, in Italia meridionale, in Albania, in Kosovo, per giungere sul loro esempio alle opere di apostolato missionario in India. Si è dichiarato il carattere fondante di un carisma che nasce ai primordi della cristianità, in Oriente, con riferimento ai primi cenobi religiosi di Santa Macrina e San Basi-

lio, compenetrato di passione e nascondimento, con l'affidare pienamente a Gesù il progetto di prossimità all'uomo affinché si stabilisca il regno dell'amore. Determinata e mite, obbediente alla purezza della dedizione filiale a Maria, mamma e protettrice della Congregazione, ha lasciato il segno del suo passaggio terreno in grandi presidi di apostolato. Serva nella povertà ha percorso strade lastricate di tenerezza. Sua è tutta la formidabile intuizione del sacrificio vissuto con partecipazione gioiosa come vittoria sull'inerzia dell'egoismo e sull'improduttività del male. La sua storia è narrata come paradigma della creazione dei giorni della speranza, che nascono



ogni volta con l'esordio della luce della carità.

Una particolare menzione a Mezzojuso si è posta nella prospettiva di rievocazione di fatti, luoghi, persone che raccontano questa bellissima storia di fede. Nella realtà di questo piccolo paese palermitano madre Macrina gode di una venerazione commovente e profonda. Il corredo di documenti fotografici tratti da archivi privati e dal patrimonio delle Suore Basiliene, ha descritto il dialogo tra luoghi e persone, in un'intima corrispondenza sentimentale di pensieri e di Credo. Sono state percorse le tappe del processo di Beattificazione di Madre Macrina Raparelli, che annovera tra i suoi affezionati promotori la Comu-

nità Albanese. Si sono susseguite le testimonianze dei familiari, esaurientemente rappresentate nel racconto di Maria Laura Raparelli, nel ricordo e nell'invocazione poetica di Elvira Vinciguerra. La musica ha contrassegnato momenti profondi di celebrazione, con esecuzioni strumentali al clarinetto di Oriana Santini e corali, su intervento della complesso Ottava Nota e proposta di brani tratti dalla tradizione melurgica bizantina a cura di Fratel Clemente Corsaro. Ancora, a corredo, abbiamo accolto le letture dei testi poetici di Cinzia Gargiulo e di Marina Gentilini, dedicati alla Theotokos. Non poteva mancare il riferimento all'iconografia bizantina, espressione artistica illustrata dal responsabile dello Scriptorium San Nilo, il Maestro Roberto Roncaccia. Impeccabile e delicata la moderazione dell'incontro di Veronica Pavani, componente della Commissione cultura del Comune di Grottaferrata.

L'esposizione di opere pittoriche aventi come tema Grottaferrata e l'Abbazia di San Nilo ha implementato la cornice dell'evento, con la partecipazione di Renato Testa, Giuseppe Felicioni, Paola Fratticci, Marina Gentilini.

A chiudere la manifestazione, un respiro conviviale di saluto con il contributo di realtà produttive agroalimentari ed esercenti di Grottaferrata. Possiamo dire che il genio femminile della vocazione di madre Macrina è in movimento nella nostra comunità, con la volontà divina che, quando si esplica, diventa sostanza di cose buone, di alta e nobile umanità. Ci piace riportare in conclusione il pensiero fondante dell'apostolato di Madre Macrina: "Lo scopo della nostra Congregazione è andare verso l'Oriente cristiano con l'opera e la preghiera. Con il nostro esempio e con il nostro lavoro di carità dobbiamo cercare di unirli a loro nello spirito, nella mente, nella volontà e nel cuore, perché tutti siano una cosa sola e si cresca inondati dalla potenza del vivere".


“MOSSANGA”, KJO SAGË E NDËRPRERË

Nga Lame Fandi – Tirane

S'ka kaluar shumë kohë nga dalja në dritë dhe romani "Mossanga" i Fate Velajt, tashmë është bërë pronë kulturore e të gjithë lexuesve. Përhapja e gjerë e veprës të kujton se sa me vend janë fjalët e arta të Hans-Georg Gadamer-it: "Kultura është e vetmja pasuri e njerëzimit që, e ndarë me të tjerët, në vend që të zvogëlohet, zmadhohet".

Fillimisht nisa të mendoj se "Mossanga" është romani i parë i një "sage" sepse ai nuk pasqyron vetëm jetën e një grupi fëmijësh të sjellë prej Kongo-s në Shqipëri, të cilët për vite të tëra jetuan në Vlorë, në qytetin, që megjithë vështirësitë e kohës, i bëri bij të saj. Fati i tyre u ndërthur me fatet e dy-tre brezave vlonjatësh dhe pikërisht këtu nis saga e tyre dhe e gjithë qytetit. Për t'u bindur se është sagë, veprës do t'i kërkohej pasqyrimi në vazhdimësi i jetës së disa brezave. E gjithësesi, gjatë leximit njihesh jo me një, po me disa fate familjesh të qytetarëve, që u ndërthurën me ato të të miturve afriknë etapat e ndryshme të formimit të tyre.

Më shumë se sa për një sagë, Fate Velaj ka synuar që romanin më të mirë ta bëjë për Vlorën, qytetin e dashur ku lindi e ku kaloi vitet e para të jetës së tij. Me lehtësinë e një rrëfimi të çlirët e karakteristik autori vjen te lexuesi duke ia bërë të tijat të vërtetat e shumta, të cilat shtrësëzohen me qartësi habitëse në ndërjegjen e secilit. Në vend që të mendojë për klasifikime teorike letrare, lexuesi më shpesh pyet veten se ç'është bën këtë libër kaq të afër me të. Shumë vlonjatë, sidomos ata që ishin në moshë të re si dhe mjaft prindër, që i ndihmuan fëmijët kongolezë për të mos u ndier të vetmuar, gjatë leximit të romanit rikujtojnë e rijetojnë plot ngjarje e njerëz të asaj kohe. Veçoria filmike e sjelljes me shkathtësi të situatave prej autorit ka bërë që të shihen qartë e bukur jo vetëm portretet e fëmijëve, por dhe të banorëve të qytetit që, me zemër të madhe, i "birësuan" ata. Krahas tyre na vijnë përpara edhe figura të shquara të



historisë qytetare, ku mbi të gjithë spikat portreti i gdhëndur me dashuri i mësuesit të gjuhës frënge Nestor Nepravishita. Libri është i tejpulluar me personazhe që paraqiten edhe me emra të vërtetë, si drejtori i gjimnazit Spiro Jovani, apo figura fisnike e mjekut Pavlo Flloko, që gjithë vlonjatët e quanin "Doktori Ynë". Bukur e interesantë vijnë gjithashtu edhe portretet e Llambi Pazollit, Todi Drizës etj. që sfiduan me guxim ligjin e urryer të propagandës e agjitacionit. Shumë nga personazhet shfaqen me karakteristika të papara apo të padëgjua e që ende të bëjnë të pyesësh veten se ç'është e ç'bënte enigmatiku "Tol francezi", që "mbiu papritur" në jetën e qytetit. Ashtu si në realitet, edhe në roman ai paraqitet befasues, teksa bërtiste rrugëve si i çmendur në frëngjisht parrulla

të revolucionit francez, krahas me shprehje që ironizonin diktaturën. Si një tjetër befasi, po ndryshe, tepër e trishtë dhe tronditëse shfaqet gruaja gjermane Elke Schmidt, e cila në vend që të bashkohej me korin e atyre që thërrisnin "Rroftë shoku Enver!" ngrinte dorën, si dikur nazistët, duke lëshuar britmën "Heil Enver!". Frika dhe pasiguria e njerëzve gjatë diktaturës ka zënë vend në roman krahas me një ndjenje ankthi që e ka hijen e saj edhe sot, sado që kanë kaluar 34 vjetë nga rënia e atij regjimi. Klima e pasigurisë dhe frika që sundonte kudo përshkruhen me mjaft vërtetësi. Te njerëzit e thjeshtë po e po, por edhe te i gjithë aparati që mbante në këmbë diktaturën, madje dhe te vetë diktatori, që hiqej sikur nuk ia kishte frikën askujt. Skena e ndjekjes së ceremonisë së varrimit të Titos nëpërmjet televizorit, ku diktatori është strukur i vetmuar në studion e tij për të fshehur zilinë e makthin e vet, vjen e përshkruar mjeshhtërisht, duke të kujtuar teatrin shekspirian. Vërtetësia e detajeve bën të mendosh se autori po ta sjell dramën që po përjetonte Enveri, si një filmim të xhiruar nga dikush që ka qënë i fshehur aty pranë.

Libri shquhet si i veçantë edhe për tendencën e dukshme të bërjes së autorit një me lexuesin. Për ta forcuar këtë mendim do t'ia vlen të vija në dukje kënaqësinë, që ma kanë përmendur mjaft nga lexuesit kur janë ndeshur me shumë shprehje thukëse, që dikur ishin në gojë të të gjithëve dhe që kanë ngelur të magazinuara që prejasaj kohe në mendjen e vlonjatëve.

Shumëkush, duke mos iu ndarë leximit, teksa sheh dhe gjendet mes situatave të vështira që trajtohen, e gjen lehtësimin në flladin karakteristik të rrëfimit intim si në të gjitha veprat e Fate Velajt. Disa prej lexuesve janë çuditur edhe nga fakti që "Mossanga" erdhi te lexuesit shpejt, pa kaluar shumë kohë nga dalja e romanit "Mi manchi" që në Itali, aty ku zhvillohen dhe ngjarjet e tij, u vlerësua me Çmim të Parë. Gjatë bisedave më kanë pyetur shpesh se si ka mundësi që romanin "për Vlorën", të cilin, siç më tha autori ditën e ceremonisë së

marrjes së çmimit në Bari, "do ta niste javën tjetër", arriti ta shkruajë në një kohë rekord, brenda tre muajve. Nuk besoj të kem gabuar kur e kam nisur shpjegimin me fjalët që Fate Velaj nuk u shfaq te ne rastësisht. Ndërkaq, më është dashur të shtoj që sipas Ismail Kadaresë ai "... erdhi në letrat shqipe si një autor origjinal, si një ngjarje letrare dhe si një risi ...". "Kemi të bëjmë – ka vazhuar Kadareja – me një autor tejet të veçantë, ndryshe nga gjithçka, me një gamë të gjerë larushmërie përthithëse, plot freski dhe stil rrëfimtar të magjishëm...". Duke patur parasysh korpusin e veprave artistike të Fate Velajt si dhe gjithçka është thënë për të si piktor e fotograf i pasionuar, plot kulturë e përvojë e kam gjetur me vend të shprehem që ai erdhi në fushën e letrave si në shtëpinë e tij. Kur them si piktor, më duhet të saktësoj cilësimin si piktor abstrakt. E kam parë prej kohësh se si i realizonte pikturat në formate të mëdha, se si i derdhte në telajo ngjyrat të cilat, ashtu si llava e vullkanëve i përhapeshin duke krijuar nënshtresa burimesh të emocioneve. Janë po këto ngjyra që, duke dalë në dritë me mënyra e penelata të ndryshme, të vrullshme, të shkathëta e çlirëta, ndërthuren e krijojnë një atmosferë të ngrohtë shpirtërore. Fate Velaj ka krijuar një individualitet të menjëherëdukshëm si në pikturë, ashtu dhe në fotografi e letërsi. Duke punuar shpejt e shpejt e me abstragime befasuese, në veprat e tij merr vrulle të papara liria e shprehjes. Dhe pa vrullet e lirisë së shprehjes nuk mund të arrihen rekorde kohore në krijime veprash me peshë si "Mossanga 406 faqëshe, që të gjithë e lexojnë pa e lëshuar nga dora. Nuk duhet të harrojmë edhe se Fate Velaj është vlerësuar prej kohësh në Shqipëri dhe në botë për artin dhe letërsinë e tij, njëherësh edhe si arkitekt e realizues i urave kulturore midis vendeve e popujve të botës. Veç kësaj, duhet thënë me plot gojë se urat e këtij arkitekti janë unikale. Ato duken menjëherë që janë të veçanta sepse janë përbëra nga tre harqe: piktura-fotografia artistike dhe letërsia, të cilat lidhen dhe e mbajnë fort njëra tjetrën.

LETRA NGA HIMARA E 1700

Nga Dr. Nusha Zhuba - Rome

Në arkivat e Vatikanit janë të shumta letrat e nisura nga Himara drejt Romës. Pothuajse i gjithë Jugu o ishte kthyer, në fenë myslymane o ishte kthyer në ritin ortodoks, vetëm Himara rezistonte akomna në ritin Bizantino-katolik. Ushtritë turke kishin shkatërruar herë pas here kishat, duke dëbuar edhe priftërinjtë nga aty. Ishin ato vite të vështira sidomos kur fshatra të tëra Himariote linin vndilindjen për t'ju drejtuar Italisë. E linin nga lufta, e linin nga varfëria e linin nga influencat fetare, por herë pas here populli trim i Himarës ngrinte kryet për të rikthyer duek mos ju nënshtruar askujt.

Lettera di Capi e Primati della provincia di Cimarra.

Li Capi e Primati della numerosa popolazione della Provincia di Cimara nell'Albania col più profondo ossequio rappresentano all'Eminenza Vostra dove nella detta Provincia esiste una Chiesa, con cosa per la Missione de Sacerdoti Religiosi di Rito Greco li quali forniti di Esemplari costumi e di letteratura potessero esercitare la detta Santa Missione e attendere la cultura Spirituale e temporale dei loro figli con istruirli, no solo nelle doveri della vita Cristiana ma anche in quelli della vita civile e della scienza e delle più costumata educazione e che ridonda in Gloria del Signore Iddio in vantaggio della Cattolica Religione, e in edificazione di quei popoli qui "qui petierut panem et non erat qui frangeret eis".

E desiderando con pieni voti la ripristinazione di detto Missione per dimostrare la loro costanza implorano come figli fedeli del Paterno cuore dell'Eminenza Vostra e benignarsi di facilitare un opera cotanta Pia giacche la detta Missione è rimasta interrotta per motivo della chiesa, e casa sono rimaste divute, a in abitabile, ne si possono esercitare le sacre funzioni e tanto meno gli esercizi dell'educazione Spirituale e temporale dei loro figli. Supplicano intanto la Sacra e Religiosa Pietà dell'eminenza Vostra a Destinarli Religiosi di Rito Greco, li quali saranno accolti colle più sincere dimostrazioni di nuovo stima e di cordiale affetto al tempo istesso compiacersi di far restaurare la detta Chiesa e cosa in cui dimoravano i due Sacerdoti Religiosi ad esercitare le loro fun-



Castello di Himara

zioni giacche si come si è detto sono nello stato presenta inabitabilità e divute. Tanto sperano di ottenere dalla esemplare e nota (incomprensibile) dall'Eminenza Vostra ad oggetti che i supplicanti non restino privi di un tanto beneficia e la beneficenza e provvida cura della Sacra Congregazione de Propaganda, continui a Diffondere le sue Grazia in questa remota e abbandonate parti, con farle godere degli effetti salutari della loro meleccolissima Protezione, essendo pronto a dire il Signor Andrea Gini de Lazzari nobile della Cimarra in carica loro cui ritrovassi in Napoli, come anche Zaccaria Gicca nipote del reverendissimo, Sacerdote Greco D. Zaccaria Dima Priifti per scortare in Cimarra i due Religiosi Missionari. Facendo anche presente all'Eminenza Vostra che i Turchi in due invasioni che fecero di note tempo fa, anno 1758 e 1775 nella detta Chiesa nominata B. L. M. fu saccheggiata di tutta l'argenteria e di sacri arredi.

Tanto umilmente imploro i supplicarli quali non lasciano di porgere la più formide preghiera al Signor Iddio per la maggio Glorie ed esultazioni della Cattolica religione. Tanto più che la detta Chiesa di cambi in Cimarra in altra occasione di sua calamità ha sperimentato per mezzo dell'Arcivescovo di Corfù. Il detto religioso D. Zaccaria Dima Priifti come comproprietario di detto Chiesa. Salutandoli effetti dalla carità e sommazioni della Sacra Congregazione di Propaganda e lo riceveranno ut Deus.

Andrea Gjini De Lazzaro per Commissario de Capi della Cimarra Supplicò Sacra Congregazione. 13. dicembre 1778

Si è scritto anche per l'informazione anche al Signor Vescovo di Corfù

Letër nga Krerët dhe Parët e Krahinës së Himarës.

Krerët dhe të Parët, përfaqësojnë me respektin më të thellë popullatën e shumtë të Krahinës së Himarës në Shqipëri. Shkëlqesia e Juaj, në Krahinën në fjalë ekziston një Kishë për Misionin e Priftërinjve Fetarë të Ritit Grek, të cilët të pajisur me zakone ekzemplare dhe literaturë mund të ushtrorjnë në këtë Mision të Shenjtë dhe të mirë presin kulturën shpirtërore dhe materiale të fëmijëve të tyre duke i udhëzuar ata, jo vetëm në detyrat e jetës së krishterë, por edhe në ato të jetës civile dhe të shkencës, dhe më së shumti në edukimin zakonorin i cili është në Lavdinë e Zotit për të mirën e fesë katolike dhe në ndërtimin e këtyre popujve këtu "qui petierut panem et non erat qui frangeret eis". (që kërkuar bukë dhe nuk kishte kush t'ua jepte)

Duke dëshiruar me vota të plota kërkojmë rivendosjen e Misionit në fjalë për të demonstruar qëndrueshmërinë e tyre, si fëmijë besnikë të zemrës Atërore të Shkëlqesisë Suaj dhe me sjelljen e tyre të lehtësojnë një punë të tillë të devotshme

pasi misioni në fjalë ka mbetur i ndërprerë për arsye se kjo kishë dhe shtëpia, kanë mbetur të pabanueshme, dhe aty nuk mund të ushtrorjnë funksionet e tyre të shenjtja, aq më pak ushtrimet e edukimit shpirtëror të përkohshëm të fëmijëve të tyre. Ndërkohë duke ju përgjyruar Devotshmërisë së Shenjtë dhe Mëshirës së Shkëlqesisë suaj që t'i emërojë ata Fetarë të Ritit Grek, të cilët do të priten me demonstrimet më të sinqerta me vlerësim të ri, dhe me dashuri të përzemërt. Në të njëjtën kohë kemi kënaqësinë që Kisha në fjalë dhe shtëpia të restaurohet dhe aty të jetojnë dy priftërinjtë fetarë për të ushtruar funksionet e tyre pasi, siç u tha, ata janë (kisha dhe shtëpia) në një gjendje të pabanueshme dhe të dëmtuar. Ata shpresojnë shumë nga kërkesa e veçantë për Shkëlqesinë e Juaj për objektet, në mënyrë që lutësit të mos mbeten të privuar nga një përfitim i tillë, dhe nga kujdesi bamirës dhe kujdestar i Kongregatës së Shenjtë të Propagandës, e cila vazhdon të përhapë Huret e saj në këtë pjesë të largët dhe të braktisur, duke i bërë të shijojnë efektet e shëndosha të Mbrojtjes së sajë.

Duke qenë se zoti Andrea Gjini de Lazzari fisnik i Himarës i ngarkuar në krye thotë se është i gatshëm dhe gjendet në Napoli, si dhe Zaccaria Gikaa nipi i të nderuarit, D. Zaccaria Dima Priifti për të shoqëruar dy Misionarët Fetarë në Himarë. Gjithashtu i vëmë në dukje Shkëlqesisë suaj se turqit në dy pushtime të njohura të disa kohë më parë, në 1758 dhe 1775, plaçkitën të gjitha sendet e argjendta dhe orenditë e shenjtja në kishën në fjalë të quajtur B.L.M.

Përgjyrohëm me përvujtëri që lutësit t'i bëjnë lutjen më të fuqishme Zotit të Madh për Lavditë dhe Lartësim të fesë Katolike. Aq më tepër që Kisha e përmendur e Himarës ka përjetuar fatkeqësi edhe në raste të tjera, nëpërmjet kryepeshkopit të Korfuzit, i cili ka përmendur D. Zaccaria Dima Priiftin si bashkëpronar të kishës në fjalë. Duke marrë efektet nga bamirësia e shumtë e Kongregatës së Shenjtë të Propagandës dhe ata do t'a marrin "ut Deus". (shpresën në Zot)

Andrea Gjini De Lazzaro, përfaqësues i Krerëve dhe të parëve të Himarës i lutet Kongregatës së Shenjtë.

13 dhjetor 1778

Për informacionin i shkruam edhe Peshkopit të Korfuzit

(Materiali i marrë nga Arkivat e Propoganda Fide-Rome)

Një javë në vizitë studimore në Yerevan të Armenisë

Nga Mark&Prenda Palnikaj - Tiranë

Besoj se për çdo njëri që do ta lexojë titullin e këtij shkrimi, me një fare të drejte pyetje e parë e tij do të jetë "Çfare kërkonin ju në Yerevan?". Mbas kërtimeve të mija prej vitesh në arkivat e Italisë dhe të Vatikanit më ka rezultuar që për arsye të besimit të krishterë kanë ekzistuar lidhje të forta midis popullsisë të Shqipërisë veriore, Libanit dhe Armenisë. Këto lidhje i kemi cekur në dy librat e mi në relacionet e Sospellos dhe të Buçarelit. Një ambassador i Shqipërisë në Moskë i cili mbulonte edhe shtetin Armen, vite më parë kishte shkruar në Armeni për të paraqitur letrat kredenciale Presidentit të shtetit të Armenisë. Atje i kishin rezervuar një pritje shumë miqësore dhe kishte qëndruar dhjetë ditë i shoqëruar nga Ministri i Kulturës dhe personalitete të tjera Armene. Gjatë kësaj kohe atë e kishin dërguar për të vizituar edhe Arkivin Armen të Shkrimeve të vjetra. Aty i kishin thënë se ka mijëra dokumente për Shqipërinë dhe i kishin premtuar të na i jepnin të gjitha pa asnjë kufizim. Mbas një bisede të gjatë, ishin marrë vesh që të shkonin dy studentë nga Shqipëria në universitetet shtetërore të Armenisë me bursë të plotë për të mësuar gjuhën dhe shkrimin armen për të bërë të mundur që të merreshin këto dokumente. Megjithatë kërkesën e ambasadorit, qeveria shqiptare nuk dërgoi asnjëherë student në Armeni dhe oferta bujare armene mbeti një propozim i pa realizuar. Në një bisedë miqësore me këtë ish ambasador, ai më tregoi mua historikun e kësaj vizite dhe unë vendosa të shkoj në Armeni për të verifikuar për këto dokumente. Ky ka qenë shkaku pse unë vendosa të shkoj në një vizitë studimore në Armeni.

Vizita ne Armeni

Gjatë muajit tetor 2024, unë shkëmbeva mesazhe me Arkivin e Shtetit të Armenisë dhe me disa institucione të tjera në mënyrë që vizita ime atje të mos ishte diçka rastësore por një vizitë e programuar me kontakte të paralajmëruara. Gjatë vizitës time atje unë pata rastin të vizitoj Arkivin e Shtetit, Institutin



Në Bibliotekën Kombëtare, në Muzeun Historik Kombëtar, në Institutin e Historisë të Armenisë dhe në Bibliotekën Shkencore të Akademisë.

për Studime Lindore dhe Institutin e Historisë të Armenisë pranë Akademisë së Shkencave, Bibliotekën Kombëtare, Bibliotekën Shkencore të Akademisë, Muzeun Historik Kombëtar, Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës, Muzeun e Genocidit armen dhe muzeun e luftës së dytë botërore.

Në Arkivin Qendror të Shtetit Armen.

Me datën 10 nëntor 2024 u nis nga Tirana dhe ditën e hënë, me date 11 nëntor 2024 në orën 900 u paraqita në Arkiv, sipas paralajmërimit dhe 3 bisedave telefonike që kishim bërë. Kryem formalitetet e nevojshme dhe u futëm në sallën e kërtimeve. Sipas marrëveshjes, na pritën një punonjëse mjaft e pregtitur nga ana kulturore dhe mjaft e sjellëshme nga ana njerzore. Kjo ishte përgjegjëse për mardhëniet ndërkombëtare dhe quhej Varditer Varel Grigoryan. Na ofroi çdo mundësi që mund të na ofrohej por skedarët ishin të gjithë në gjuhën armene dhe ishte e pamundur që të bënim asnjë lloj kërkimi. Ajo me durim dhe me respekt na njoftoi se nëse na paraqesim një kërkesë me mesazh ku të përcaktohen kërkesat me specifikim se çfarë kërkojmë, ky arkiv kishte njerëz të ngarkuar që të bënin kërkimet e nevojshme, të skaneronin dokumentat dhe ti dërgonin në mënyrë elektronike kundrejt një pagese e cila ishte e caktuar zyrtarisht nga shteti. Para se të largoheshim, ajo mori



në telefon Drejtorin e Institutit për Studime Orientale Z. Aleksan Hakobyan dhe fiksuam që të takoheshim në zyren e tij në orën 1500.

Vizita në Institutin për Studime Lindore.

Drejtori i Institutit Z. Aleksan Hakobyan na pritë me përzemësi me një staf prej tre personash, punonjësit të Akademisë dhe mbas prezentimit në paraqitëm kërkesat tona për ndihmë. Midis personave që na pritën ishte edhe një professor, specialist i studimit krahasues të gjuhëve me emrin Harutyun Khudanyan i cili ishte përkthyes në gjuhën armene në këtë takim. Aty u bisedue kryesisht për mundësinë e gjetjes së dokumenteve dhe fakteve për të dy vendet tona. Ju prezantova tre libra të mija të botuara në dy gjuhë njëkohësisht (shqipe dhe italiane) ku flitej edhe për Armeninë. Në fund të bisedës shkëmbyem disa libra me autograf. Ata biseduan me Zv/drejtorin e Muzeut të Librave dhe të Shkrimeve Armene të quajtur Mate-danaran Z. Vahe Torosyan. Takimi u la për ditën e nesërme, 12 nëntor, e martë ora 1200.

Në Muzeun e Shkrimeve të Vjetra Matadanaran.

Të martën, me datë 12 nëntor ora 900, u futëm në muze dhe e vizitua me vemendje dhe kënaqësi shumë të madhe. Personeli i muzeut na pritën me shumë respekt dhe u interesuan që të na spjegonin me hollësi

materialet e ekspozuara dhe rëndësinë e tyre. Na prezantuan të dhëna për shkrimin armen që nga shekulli IV dhe shkrime të ndryshme në gjuhën armene. Aty ruheshin shkrime nga Shek. IV dhe libra të shkruara me dorë nga Shek VI. Si studiues i të drejtës zakonore të shqiptarëve, më bëri përshtypje një libër dorëshkrim i vitit 1303 në gjuhën armene me titull "E Drejta Zakonore". Mbase vizitova stendat e muzeut, në orën 11 e 30 minuta u paraqita tek sekretaria e drejtorit dhe i thash sekretares që të njoftonte drejtorin se ne kishim ardhur. Ai na pritë menjëherë. Drejtori quhej Vahe Torosyan dhe mbulonte dy sektore të këtij institucioni, muzeumin dhe bibliotekën. Duke i kërkuar ndjesë që shkova para orarit të fiksuam më parë dhe duke e falenderuar për pritjen filluam bisedën për shkaqet dhe qëllimin e vizitës time aty. I spjegova me hollësi punimet e mija në arkiva dhe kërkova të më ndihmonte për të më dhënë dokumentet për Shqipërinë nëse ato ekzistojnë. I kërkoja të kontrollonte listën me librat e vjetra nëse janë aty dy libra në gjuhën shqipe të shkruara në vitin 1555 dhe 1574. Ai thirri aty drejtoreshën e bibliotekës Znj. Ani Petoyan e cila ishte edhe grauja e drejtorit. Ishte një grua shumë e pregtitur nga ana shkencore dhe njëjtë me kompetencë gjuhën italiane. Kjo për mua ishte një avantazh i madh sepse unë mund të komunikoj në këtë gjuhë me atë dhe ajo njëjtë dhe lexonte pa vështësi dorëshkrimet mesjetare në këtë gjuhë.

Ani na dërgoi në bibliotekë dhe na ndihmoi me çfarë ishte e mundur. Edhe këtu ju dhurova libra të mi në versionin dygjuhësh. Rezultoi që në këtë bibliotekë kishte mijëra dokumente dorëshkrime të vjetra në gjuhë latine, italiane, franceze dhe gjuhë të tjera. Sipas kësaj drejtoreshë, mijëra faqe dokumente shkruanin edhe për Shqipërinë. Koleksioni i dorëshkrimeve të Matadanaranit është një nga më të mëdhenjtë në botë. Depozita përmban mbi 17300 dorëshkrime, 450 mijë dokumente arkivore, 3000 libra të lashtë. Mbi 14200 dorëshkrime të mbajtura në SRI janë në gjuhën armene, të tjerat janë në gjuhë të huaja - greqisht, latinisht, aramaisht, hebraisht, arabisht, persisht, sllavishten e vjetër, etiopisht, japonisht e të tjera.

(vijon në faqen 23)

Nga cikli i shkrimeve "Shqiptarët e shquar nëpër Botë"

KARL GEGA inxhinieri virtuoz, i mendimeve, projektive dhe zbatimeve të veprave hekurudhore

Nga Vlasi Fili - SHBA

Inxhinieri virtuoz, i mendimeve, projektive dhe zbatimeve të veprave hekurudhore, që e tha fjalën e vet me nivel profesional, pavarësisht se kjo shkencë, në atë kohë nuk ishte formuar ende, si një degë e dijes, që u bë i njohur në epokën e tij dhe që njihet ndryshe me emrin "Babai i Semeringut (Semmeringbahn)" Me rastin e 221 vjetorit të lindjes dhe 163 vjetorit të vdekjes. Kush ka patur fatin të udhëtoji me tren, nga Italia për në Austri dhe anasjelltas, nuk ka si të mos mahnet nga një mrekulli inxhinierike, rrugën hekurudhore që lidh këto dy shtete. Kjo mrekulli inxhinierike, bëhet e pabesueshme kur mëson se nuk është ndërtuar në kohën e sotme, kur shkenca dhe teknika kanë ecur shumë, por më shumë se një shekull e gjysëm më parë, kur të gjithë mendonin se ndërtimi i kësaj hekurudhe, nëpër zëmren e malit të Semeringut, ishte jo vetëm i pamundur, por e qanin projektimin dhe ndërtimin e saj, një marrëzi inxhinierike. Të gjithë trenat që vijnë nga Italia për në Austri, në dalje të tunelit, apo ata në hyrje nga Austria, aty ngadalësojnë shpejtësinë, kurse trenat u bien burieve të lokomotivave, në shënjë kujtimi, përshëndetje dhe respekti, për projektuesin dhe ndërtuesin e kësaj hekurudhe, inxhinierin virtuoz, Karl Gega (Carl Ritter von Gega).

Por kush ishte Karl Gega, nga cila familje rridhte dhe nga është origjina e tij?

Shumë autorë e biografë të Karl Gegës, krahas madhësisë së këtij njeriu theksojnë se, megjithëse kanë arritur të japin një përshkrim me detaje të gjithëveprimtarisë së Gegës, si arkitekt dhe inxhinier, nuk kanë mundur të bëjnë të njëjtën gjë për jetën personale të tij. Biografi më i fundit i Gegës, autriaku Wolfgang Straub, në vitin 2004, ka botuar librin me titull "Carl Ritter von Gega", ku pohon: "... per njeriun Gega, ne nuk kemi trashëguar pothuajse asgjë. Jeta e tij private, në të gjitha botimet letrare e shkencore, është trajtuar në përgjithësi, në mënyrë të mjegullt apo hipotetike. Sigurisht edhe prejardhja e tij është trajtuar në mënyrë hipotetike, duke e konsideruar herë austriak e herë Italian"[1]. Një problem të tillë si [1] e trajton edhe [6]. Mos pasja e paqartësive të jetës së Karl Gegës, e kanë vështirësuar edhe disa nje të vecanta të jetës së tij, si data e lindjes, data e vdekjes, apo edhe shkaku u vdekjes. Për këto do të bëjmë fjalë me hollësi, në vazhdim të këtij shkrimi, por ajo që duam të themi, për problemin e datës së lindjes, është qartësuar nga autori Albert Vataj, në studimin e vet [2], mbështetur në studimin e autorit [1].

Jeta e Karl Gegës

Si fillim do të shohim se si ka ecur jeta e tij dhe nëpërmjet saj do të sqarojmë edhe ato pjesë të jetës që kanë ngelur me pikëpyetje nga shumë autorë, mbasi një pjesë e mirë e tyre janë qartësuar nga dokumentet e gjetura kohët e fundit. Më 10 Janar 1802, 221 vjet më parë, në familjen e kapitenit të marinës venedikase, Anton Gega, kishte një gëzim të madh, lindi djali, Karli. Prindërit e djalit, Anton Gega i martuar me Anna Pribich, banonin në lindje të qytetit, në "Sistere de Castello", lagje e oficerëve dhe nëpunësve të marinës venedicane, pranë rrugës Via Garibaldi dhe Rio di S. Anna[1]. Pagëzimi i tij u bë në ishullin e Olivolo-s, në kishën San Pietro në Castello, ku ishte rezistenca e Peshkopit të Venedikut. Dokumenti më i rëndësishëm për lindjen e Karl Gegës është regjistri pagëzimit të kishës në të cilin shënohet: "Më 10 Janar 1802, lajmërohet lindja e Karlit, birit të zotit Anton Gega, bir i Gasparit, oficer marine dhe i zonjës Anna, me mbiemrin vajzërie Pribich". Si thekson [1], në disa botime, datëlindja e Karl Gegës, figuron më 13 Qershor 1802, por këtë ngatërrësë e ka shkaktuar, pa dashje, vet Karli, mbasi në regjistrin e punës, i plotësuar nga vet ai, ka shënuar për datë lindje, datën e pagëzimit (të dhënies së emrit), 13 Qershor 1802. Kjo është bërë për arsyen se në atë kohë i jepëj rëndësi e madhe, ditës së emrit. Megjithatë, dokumenti i lindjes që përmendëm më parë e qartëson përfundimisht, se data e lindjes është 10 Janar 1802. Arsimin fillor, Karl Gega, e



mori pranë familjes, në Venedik. I ati i tij, Antoni, shpresonte që djali i vetëm, da të vazhdonte traditën e familjes, në karrierën ushtarake detare, por nuk ndodhi ashtu.

Pa mbushur 13 vjeç, kariera e ardhëshme e djalit, mori drejtim tjetër. Duke qenë se Austria rimori edhe një herë në zotërim Venedikun, në vitin 1814, i ati i Karlit, parashikoi mungesën e perspektivës, në marinën venedicane dhe duke vlerësuar cilësitë e të birit, ndryshoi mendim dhe vendosi t'i japë të birit një drejtim tjetër në jetë. Në atë kohë, Karli ishte në Kolegjin Real të Marinës, nga ku largohet dhe kalon në Kolegjin Ushtarak të Shën Anna-s, të cilin e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Në vazhdim, Karli i vë qëllim vetes, që të thellonte njohuritë tij në matematikë. Për këtë, ndoqi disa muaj një institut privat marine. Me dëshmitë e dy shkollave, në Janar 1818, kur ishte vetëm 16 vjeç, regjistrohet në vitin e dytë të kursit tre vjeçar në Fakultetin e Shkencave të Filozofisë dhe Matematikës në Universitetin e Padova-s. Ky universitet, në ato vite, ishte me emër, mbasi



në të punonin si pedagog, shkencëtarët më të dëgjuar të asaj kohe. Kalimi në vitin e dytë të universitetit u bë i mundur nga fakti se studenti i talentuar Karl Gega, e zotëronte lëndën e vitit të parë. Por edhe viti i dytë, nuk zgjati shumë, mbasi mbas 8 muajve, Karli dha me sukses, provimet përkatëse dhe u emërua "Inxhinier Arkitekt", kurse më 11 Qershor 1819, u diplomua "Doktor në Matematikë" [1,2,3,4,5].

E veçanta e këtyre viteve ishte, se Karl Gegës, krahas ndjekjes së shkollës, qysh në tetor 1817, pa mbushur ende moshën 16 vjeç, ishte besuar detyra e anëtarit, në Inspektoriatin Qëndror të Ujrave dhe Rrugëve, të Qeverisë së Krahinës së Veneto-s, pjesë e Perandorisë Austro - Hungareze. Njëkohësisht, ai ndiqte edhe kurse në Akademinë e Arteve të Bukura, në qytetin e Venedikut. Kjo bënte të mundur që Karl Gega të kishte një formim të plotë në fushën e arkitekturës. Talenti i këtij gjeniu dhe mbështetja fillëtare që i kishte dhënë i ati, tashmë dukeshin qartë, se jeta e tij në fushën e shkencave natyrore e teknike do të ishte e suksesshme.

Kariera e Karl Gegës dhe veprat e tij.

Cjenialiteti i këtij inxhinieri virtuoz del qartë po të bëhet një krahasim i vogël me të sotmen. Duke patur parasysh fushat në të cilat punoi dhe dha ndihmesën e tij Karl Gega, një inxhinier sot, i duhet të studio e të përgatitet në disa fusha si atë të ndërtimit të rrugëve hekurudhore, të studimit të ujrave, të përgatitjes në gjeodezi, arkitekturë, inxhinieri mekanike, shkencat e natyrës, etj, etj. Në kohën që punoi inxhinieri Karl Gega, shkenca e ndërtimit të hekurudhave, ishte në hapat e para e për më tepër ajo e hekurudhave malore, nuk ishte formuar ende si degë e shkencës. Karl Gega studio, punoi dhe krijoi në shumë sektorë të tjerë, jashtë atij të ndërtimit të hekurudhave, ku ai grumbulloi një përvojë të madhe. Kjo e bëri atë që të futet në grupin e njerëzve më të shquar të kohës, në të gjitha fushat e jetës. Kariera e Karl Gegës si mendimtar shkencor, projektues, zbatues dhe udhëheqës punimesh, që filloi qysh në moshë të re, vazhdoi deri në fund të jetës së tij, pa ndërprerje, për më shumë se 40 vjet, në shërbim të Perandorisë Austro - Hungareze, prej të cilave, vetëm në Venedik për 17 vite. Me dhjetra rrugë, hekurudha, ura dhe vepra të tjera, në pjesë të ndryshme të Perandorisë Austro - Hungareze të asaj kohe, në Austri, Gjermani, Çeki, Hungari Slloveni e Itali, kanë vlerën e mendjes gjeniale të Karl Gegës. Rruga që lidh Venedikun me Tirolin, (1820), projekti për ndërtimin e rrugëve në Vittorio, Veneto dhe Conegliano, ndërtimi i ndërtesës së gjykatës në Trevo, projekti për disiplinimin e ujrave të lumit midis Piave-s dhe Tagliamento-s (1827), projekti për rregullimin e ujrave të lumit Po në zonën e Rovigo-s (1830), drejtimi i punimeve për rregullimin e segmentit të hekurudhës Tirol - Ravensburg - Brno (Çeki), 140 kilometra i gjatë (1839), drejtimi i segmentit hekurudhor Tirol - Voralberg (1840), drejtimi i punimeve për lidhjen e Trento-s me Pergine-n, përmirësimi i rrugës së vjetër

romake "Via Klaudia Augusta", drejtimi - punimeve për segmentin hekurudhor Murzushlag - Grac (1844) dhe Grac - Celje (Slloveni), projektimi i linjave hekurudhore për në Ljublanë dhe Trieste (1845), kanë dorën dhe mendjen e gjenit Karl Gega.

Pa dyshim, kryevepra e Karl Gegës, mbetet hekurudha e Semeringut, një kryevepër e mendjes njerëzore, por për këtë do të bëjmë fjalë me detaje, në vazhdim të këtij shkrimi. Karrierën si inxhinier e filloi me ndërtim rrugësh dhe udhëjellsish në Venedik. Në vitet 1830 - 1833, Gega punoi si inxhinier në Rovigo, kurse nga 1833 deri 1836, u caktua në Departamentin e Ujrave, pranë Drejtorisë së Bujqësisë në Venedik. Gjatë viteve 1836 - 1837, studio shkencat hekurudhore në Angli dhe disa vende të tjera europiane. Në vitin 1836 deri 1840, ishte udhëheqës i ndërtimit për pjesën e rrugës hekurudhore "Kaiser Ferdinand - Nordbahn", prej Ludenburg-ut deri në Brno. Në vitin 1840 u bë zvendës drejtor për ndërtimim e mbarë Tirol-it. Aty projektoi rrugën malore që kaloi për Val Sugano, pastaj atë që kalon nëpër Oberinthal, tek Qafa e Finstermussen-it si dhe projektoi urën e varur mbi Etsh, pranë Moresë. Në vitin 1842 emërohet udhëheqës planifikimi për gjithë jugur e Perandorisë Austro - Hungareze. Për këtë arsye, dërgohet nga Qeveria Austriake, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të përfutur nga përvoja amerikane në projektimin dhe ndërtimin e hekurudhave. Veç këtyre ai publikoi shumicën e studimeve të tij, jo vetëm në gjuhën gjermane, por edhe në italisht dhe frëngjisht. Pas kthimit nga Amerika, u caktua me projektimin dhe ndërtimin e hekurudhës në drejtim të jugut, nga Muzushlag nëpër Grac dhe deri në Trieste, ku pjesa më e vështirë, që konsiderohej si e pamundur, ishte kalimi i malit të Semeringut.

Në vitin 1844 Gega e përfundoi projektin, ku parashikonte kalimin e malit me lokomotivë pa rrota me dhëmbë, por me lokomotivë normale, e cila mund të përballonte pjerrësitë e malit. Në vitin 1848, si inspektor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndërtimeve, drejton ndërtimin e hekurudhave të jugut deri në Laihal, ndërsa në vitin 1849, u bë drejtor i SekSIONIT të Ndërtimit të Hekurudhave. Në vitin 1851, para përfundimit të hekurudhës së Semeringut, Karl



Gegës, iu dha titulli i lartë "Ritter" (Kalorës). Në vitin 1852, kur punohej për hekurudhën e Semeringut, Karl Gega caktohet Drejtor i Përgjithshëm për Ndërtimin e Hekurudhave, post ky që krahasohej me atë të një këshilltari perandorak. Me këtë emërim, ai arriti postin më të lartë të një nëpunësi të Perandorisë Austro - Hungareze. Megjithë postin e lartë që iu besua, Karl Gega nuk e ndërpreu asnjëherë punën projektuese, ndërtuese dhe drejtuese. Gjatë viteve të fundit të ndërtimit të hekurudhës së Semeringut, Karl Gega planifikoi të gjithë rrjetin hekurudhor të monarkisë Habsburgase. Mbas përfundimit të hekurudhës së Semeringut, iu dha detyra e planifikimit të rrugës hekurudhore në Siebenburgen. Vdekja nuk e la që ta përfundonte.

Vdiq më 14 mars 1860.

Hekurudha e Semeringut

Pa dyshim, kryevepra e Karl Gegës mbetet hekurudha e Semeringut, punimet e së cilës filluan në vitin 1848 dhe përfunduan në vitin 1854. Kjo hekurudhë nuk ishte vetëm një diçka e re në fushën e ndërtimit të trasës për konstrukcionin e lokomotivave malore, apo teknikën e sigurisë, por ajo shënonte një përparësi në drejtim të ndërtimeve malore dhe një arritje të dukshme në studimin e teknikës së ndërtimit me shina. Vështirësitë e ndërtimit të kësaj hekurudhe, kishin të bënin, me terrenin malor, rreth 1000 mëtrë lartësi, një terren tepër i thyer, me vështirësitë që lokomotivat ekzistuese për tu ngjitur në ato lartësi, me pjerrësi të thjeshtë, me vlerë deri 25 për mijë dhe me reze të harkimeve rreth 180 metra. Shtu këtu kushtet e vështira të dimrit të egër, mungesa e mekanizmave dhe veglave të punës të përshtatshme për një ndërtim të ri, me efektivitet mjaft të ulët, mbasi dinamiti

ende nuk ishte shpikur dhe për hapjen e vrimave ishte vetëm turjela e dorës. Gega, me shumë guxim, i parashikoi këto vështirësi saqë kërkoi të marrë përsipër kalimin e tyre. Ai duket sikur e ka pikturuar hekurudhën mbi shkëmbinjë të luginat e thella apo humnerat. Ai e projektoi hekurudhën në shpatin e malit ku ajo të lë përshtypjen e një skice mbi një mur. Herë - herë ai e fut atë në një tunel, nga i cili pasi del, e fut në një tjetër dhe here - herë e harkon si një gjarpër mbi një luginë, nga një mbikalim (viaduct) në një tjetër. Të gjitha këto, pikërisht në Semeringut, që është pika më e lartë e vargmaleve, ku pak rajone malore janë po aq piktoreske dhe madhështore.

Për punën gjeniale të bërë në këtë hekurudhë, ku u punua për 6 vjet, po japim disa shifra të përgjithshme. U ndërtuan 16 udhëjellsa me gjatësi të përgjithshme prej 1502 metra, 15 tunele me gjatësi prej 4520 metra, nga të cilët ai i Semeringut 1430 metra në lartësinë 818 metra mbi nivelin e detit, u ndërtuan disa dhjetra ura dhe një mori muresh mbajtës, për sigurimin e trenave nga shëmbjet e dheut, u hodhën në erë rreth 1.500.000 metër kub shkëmbinj, u çvendosën rreth 3.500.000 metër kub dhë, u stivuan 65.000.000 tulla dhe u ngritën 80.000 blloqe guri. U ndërtuan 41 kilometër hekurudhë, me 16 mbikalime (viaducte) me gjatësi 1502 metra, disa prej të cilëve, me dy kate [3]. Gjatë gjashtë vjetëve të punës për ndërtimin e kësaj hekurudhe, punuan rreth 20.000 vetë me familjet e tyre nga ku rreth 1.000 prej tyre nuk u kthyen më nga ky kantjer i madh pune, duke humbur jetën në aksidente apo sëmundje të ndryshme [1,2]. Edhe në ndërtimin e ujsjellsave, pati vështirësi të shumta, për arsye, se në atë kohë, nuk njiheshin vinçat e mëdhenj. Ndërtimi i shtyllave me madhësi që arrinin deri 45 metra lartësi dhe 20 metra gjerësi, bëhej me ndihmën e skelave të lëvizëshme. Vështirësitë e shumta u shfaqën gjatë shpimit të tunelit kryesor, ai i Semeringut. Ky tunel, për shkak të gjatësisë së tij, nuk u shpua vetëm horizontalisht nga dy drejtime, por edhe vertikalisht. Në gjashtë pika mbi të, u hapën puse, nga të cilët nxirrej gurët e dheu. Gega u çvendos në një lokal fshati dhe e transformoi atë në shtabin e tij të përgjithshëm. Ai u mbështet nga specialis-



ti Lohr, që merrej me ndërtimin e ndërtesave dhe anekseve të tjera të hekurudhës dhe kishte rreth 50 inxhinier dhe arkitekt në drejtimin e punimeve, të ndarë në lote (sektorë). Vështirësia e këtij revolucionit u ndje edhe në mes të luginave të thella e të ashpëra të Semeringut, ku u shfaqën luftëra të brendëshme, sabotime e sulme, si dhe paqartësia e ndërtimit të lokomotivës deri në pranverën e vitin 1851, lokomotivë që do të ngjitej në ato terene të vështira. Të gjitha këto vështirësi, Gega i përballoi me punën kolosale, aftësitë, pasionin, besimin dhe guximin e jashtëzakonshëm e të rallë, çka bënte që të arrinte një fitore historike në shkencën e ndërtimit të hekurudhave, që u emërua "Revolution" në këtë shkencë.

Zgjidhja e problemeve të hekurudhës së Semeringut, u kundërshtua nga shumë specialistë, mbasi veç të tjerave, në atë kohë, diskutohej shumë rreth vështirësive që shfaqte ngjitja në atë lartësi e lokomotivave ekzistuese. Për këtë qëllim, qysh para se të fillonin punimet në hekurudhën e Semeringut, enkas për të, u shpall një konkurs, midis konstruktorëve të dëgjuar të lokomotivave, për të ndërtuar një të tillë më të fuqishme, të aftë që të tërhiqte të paktën 125 ton, me shpejtësi jo më të vogël se rreth 11 kilometra në orë, në një pjerësi 25 për 1.000, për më tepër ajo lokomotivë duhet të ishte në gjendje të ndalonte në distanca të shkurtëra, mbasi në atë kohë, nuk njiheshin frenat e tipit Westinghouse, të cilat u arritën të projektoshin vetëm mbas 20 vjetëve. Në këtë konkurs fitoi shoqëria Maffei e Monakos së Bavarisë, që mori përsipër të ndërtonte një lokomotivë që të tërhiqte 150 ton me shpejtësi 16 kilometra në orë [2].


vijon numrin e ardhshëm

Le Basiliane nella storia del Millenario dell' Abbazia di Grottaferrata

Di Elena Lulashi - Albania

Il 3 ottobre 2024, nella Sala Conferenze dell' Abbazia di S. Nilo a Grottaferrata, c'è stato un omaggio di stima e di affetto alla Venerabile M. Macrina (Elena) Raparelli, fondatrice della nostra Congregazione delle Suore Basiliane di S. Macrina. L'idea, nata su iniziativa dell'Azione Cattolica del Sacro Cuore in collaborazione con la Comunità Monastica Basiliiana e l'Amministrazione Comunale, è stata realizzata con successo. Apprezzabile il disegno di Marina Gentilini, usato per i manifesti del convegno, nel quale l'artista è riuscita ad esprimere la spiritualità e il carisma della nostra Madre. Per questo motivo vorrei condividere le mie riflessioni sull'opera.

Al centro risplende la figura maestosa della Madre, simbolo della forza di una vocazione al femminile. Sembra cantare "Laudato sii, o mio Signore". Le sue braccia aperte sono ali che accarezzano la Chiesa Bizantina e quella Latina di Mezzogiorno (PA), dove la Madre con sua sorella Eumelia (Agnese), nel 1921, fondò la nostra Congregazione. Il capo chino è l'umiltà della Madre e il volto indefinito e velato ne indicano la sua straordinaria offerta di "vittima per l'unità dei cristiani": ogni suo respiro, le opere di beneficenza, i sacrifici, le preghiere... tutto era rivolto a Dio per l'unità. Ancora la vaghezza del ritratto potrebbe rappresentare le basiliane, quelle di ieri, di oggi e quelle del futuro che annunceranno l'ideale e il carisma dell'unità, che la Madre aveva avuto in dono dallo Spirito Santo. Rispetto alle dimensioni del corpo, la grandezza della croce che illumina l'abito monastico esprime le parole della Madre: la Croce di Cristo ci salverà. La bambina alla sinistra di chi guarda la foto è felice, il suo viso è sorridente, i suoi capelli ricci sciolti, l'abito verde speranza, i piedi scalzi e liberi sono passi di danza. Spensierata e determinata segue la Madre, la mano tesa ne vuole accarezzare il volto, ma è anche lo



Disegno di Marina Gentilini

slancio di un abbraccio. Il bambino seduto sulla destra appare triste, il suo sguardo pensieroso è orientato lontano, i vestiti sono scuri e dal cappellino esce solo un ciuffo rosso. Sembra in atteggiamento di una preghiera di intercessione. Possiamo leggere nel suo intimo: "Signore proteggi ogni bambino. Dobbiamo tutti essere una sola cosa, figli dello stesso Dio Padre. Questo è meraviglioso! Unità, perdono, condivisione dei beni, non più guerra, non più odio, ma bontà e amore come ci dice Cristo Signore". Si notano un albero, dei bei fiori variopinti, una farfalla, l'oro al centro e tantissima luce dentro. Ecco due colombe bianche, una spiga di grano maturo e al centro, a sfiorare la terra, sul riflesso blu del cielo, prolungamento dell'abito monastico della Madre, una croce latina.

Sullo sfondo, disegnate in miniatura, si intravedono delle suore vestite di bianco con la croce bizantina e poi altre suore con il loro vescovo e la croce pastorale latina. Sembrano tutti uniti nello stesso ideale di unità! Processione di preghiera per la pace del mondo. La cornice è allegra, briosa. Sembra un cancello aperto al mondo e alla vita coi suoi fiori festosi. E così sia: apertura, non chiusura. Unità, fraternità, non uniformismo. Carità, non egocentrismo. Libertà e verità, non schiavitù e guerra. Così sia.

Dopo queste mie considerazioni porgo un ringraziamento cordiale a tutti. Grazie a P. Pierfrancesco De Feo, Egumeno dell'Abbazia di S. Nilo che ci ha accolto sottolineando il forte legame spirituale che esiste tra i monaci basiliani e le suore basiliane. Grazie al Sindaco di Grottaferrata, Mirko Di Bernardo, a Mons. Claudio Cirulli, Assistente Diocesano di Azione Cattolica della Diocesi di Frascati, a Fra Clemente Corsaro per la sua straordinaria testimonianza e i trofari in onore di S. Macrina. Grazie ai relatori Ludovica Procaccini Pagano, Alberto Procaccini, Stefano Paolucci, agli artisti Roberto Roncaccia, Renato Testa, Giuseppe Felicioni, Paola Frattucci che hanno ornato la Sala Convegno con le loro opere pittoriche. Emozionante vedere il quadro dell'Ultima cena, opera di uno dei nipoti della Madre, Adriano Vinciguerra, che da anni abbellisce la sala Convegni dell'Abbazia. Hanno rallegrato i cuori i canti del Coro "L'ottava nota" diretto dal Maestro Fabio De Angelis, il clarinetto di Oriana Santini, le poesie di Cinzia Gargiulo e di Elvira Vinciguerra. Grazie ai parenti della nostra Madre, da noi chiamati affettuosamente nipoti e cugini, (citiamo Maria Laura Raparelli per la testimonianza profonda ed Elvira per i versi che hanno commosso tutti). Sono stata felice di constatare l'interesse dei Grottaferratesi nel celebrare la memoria dei loro concittadini, favorendone la conoscenza, specialmente di quelli che, con il dono della propria vita, sono riusciti a lasciare un segno positivo nella società e hanno

seminato speranza, testimoni di carità. Grazie alla signora Antonella Fusillo, Presidente dell'Azione Cattolica, alla moderatrice dell'incontro Veronica Pavani. Grazie all'assistente tecnico Mirko Buttiglieri, a Paolo Vinciguerra. Grazie a chi ha partecipato al convegno per onorare la figura e la missione di Madre Macrina Raparelli. Grazie a coloro che hanno contribuito con il loro omaggio conviviale e a quanti hanno allestito la sala. Grazie di vero cuore a tutti.

Credo sia stato importante commemorare la nostra Madre Fondatrice, Venerabile Macrina Raparelli, nel Millenario della consacrazione della Chiesa di S. Maria di Grottaferrata. Cito in conclusione la frase emblematica di Papa Leone XIII "La Basilica di S. Maria di Grottaferrata è una gemma orientale incastonata nella tiara pontificia", e aggiungo con certezza, se pur in punta di piedi, che nascoste nel cuore di questa gemma sulla tiara papale, ci siamo anche noi suore. Sì, vero, lì ci siamo e lì rimaniamo per grazia del Signore, perché siamo suore basiliane, radicate nella tradizione orientale di rito bizantino greco cattolico, unite totalmente al papa di Roma e aperte alle altre realtà anche non cattoliche, legate spiritualmente a tutte le chiese d'Oriente, uguali alle sorelle e ai nostri fratelli ortodossi riguardo la Divina Liturgia, ai Santi, all'iconografia, agli Inni dedicati alla Madre di Dio e a Gesù...ereditari per grazia di Dio di una tradizione antica in questa realtà unica, un pozzo di sapore orientale a soli due passi da Roma. Le Suore Basiliane sono una Congregazione Orientale nel cuore dell'Occidente. Continuiamo ad offrire la nostra vita al Padre, come Cristo, come la Madre, per l'unità, pregando ed operando... affinché tutti siano una sola cosa. (Gv17,21). Così visse la nostra Madre Venerabile Macrina Raparelli, così cerchiamo di vivere noi suore basiliane, sue figlie spirituali, che svolgiamo la missione di Unità nella carità in Italia, nel Kosovo, in Albania, in India. Grazie e pregate per noi.

Duke përshkuar gjurmë të arta

Projeksion mbi librin "Gjurmë të arta" të autorit Zydi Fortuzi.

Nga Ndue Shabaku - Brescia

Nëse një shkëndijë duket në shtjellën e territ, tërheq sytë dhe vëmendjen e të gjithëve. Nëse drita e saj vjen gjithnjë duke u rritur, do të thotë se terrin e ke lënë pas. Një shkëndijë e lindur nga kontrastet e jetës shoqërore dhe dëshira për përparim, është shprehja e parë "Ju flet Tirana" e dëgjuar në në altoparlantët e kryeqytetit. Kjo ndodhi në një ditë jo dosido, por në ditën më të madhe të historisë së kombit tonë, më 28 nëntor 1938. Kjo ditë shënoi, siç thotë autori, zgjimin nga gjumi i thellë, që shekujt i diktuan popullit tonë.

Libri "Gjurmë të arta" doli në qarkullim në vitin 2021. Autori i këtij libri, ka lënë edhe vetë gjurmë të arta. Është tipiku i njerëzve të përkushtuar në punën profesionale, i cili ka investuar gjithçka nga vetja për të dhënë gjithçka për publikun. Ai ka synuar të përcjellë tek lexuesi punën e vyer të institucionit të parë të rëndësishëm të medias, Radio Tiranës, kontributin e çmuar të pionierëve dhe, më vonë, të një armate të tërë profesionistësh. Edhe pse eviton të vërë në dukje kontributin e tij intelektual dhe përkushtimin profesional si muzikant i kompletuar, lexuesi e ka të lehtë të kuptojë rolin tepër të çmuar të dhënë për Radio Tirana, në veçanti, e për muzikën, në tërësinë e saj.

Me penelata të kursyera, por domethënëse, autori vë në dukje ndikimin tepër pozitiv dhe energjinë që përçoi tek dëgjuesi Radioja e parë shqiptare. Me keqardhje vë në dukje që vetëm pak muaj pas fillimit të punës, pas shtatë prillit 1939, Radio Tirana u vu në shërbim të italianëve e më vonë të gjermanëve, pra, të luftës, duke dëmtuar rëndë programet edukative. Vetëm pas vitit 1944 nisi maratona e programeve të larmishme argëtuese e edukuese për fëmijë e të rritur. Me interes për publikun gjenden në faqet e librit emrat e programatorëve të parë, të folësve të parë, të autorëve të parë, të këngëtarëve të parë, të muzikantëve të parë ...

Duke qenë në thelb muzikant që ka studiuar jashtë dhe në Tiranë, autori ka një orientim të vetvetishëm të theksosë rëndësinë e madhe që ka muzika për jetën artistike dhe për ndikimin që ka ajo për publikun e gjerë. Veç rolit të drejtuesit të parë të Radios Gjergj Bubani, në libër do të gjenden pasazhe të këndshme dedikuara edhe muzikantëve të parë si, Pjetër Dúngu, Jorgjia Truja, Vitori Xhaxhika, Marie Kraja e tj. Po kështu edhe gjallëria që sollën orkestrat e para në shumë qytete të Shqipërisë. Me një fjalë, lëvizja e madhe në drejtim të një profesionalizmi dhe gjallëria e jetës kul-

turore në vend, të cilat u bënë materia që i dha jetë Radio Tiranës.

Krahas programeve edukative kushtuar luftës, heronjve, punës, rinisë, arsimit e tj, autori nxjerr në evidencë rritjen eksponenciale të forcave krijuese në fushën e muzikës. Me nderim të veçantë përmendet puna e kompozitorëve të parë si Nikolla Zoraqi, Çesk Zadeja etj, e cila u pasua nga një armatë e tërë kompozitorësh tepër të zotët. Autori shpreh gjithë ngazëllimin e tij, disa ngjarje të mëdha për artin muzikor. Më 15 janar 1962 hapi dyert Konservatori Shtetëror i Tiranës (sot Akademia e Arteve të Bukura). Në prill 1962 u krijua Orkestra Simfonike e Radio Tiranës. Në fillim të vitit 1962, nga Abdulla Grimci u hodh ideja e organizimit të Festivalit të Këngës në RT, i cili u vu në akt në dhjetor 1962.

Janë pikërisht Festivali e Këngës së muzikës së lehtë ata që autori muzikant Zydi Fortuzi, i prezanton me adhurim romantik. Jeta që mori ky festival (i cili vazhdon jetën edhe në ditët e sotme,) është oksigjen për autorin profesionist, për gjallërinë që i dha jetës kulturore, për shenjat që ka lënë në breza të tërë për mbi gjashtë dekada. Sa e sa këngë ruajnë aktualitetin dhe bukurinë e shumë prej tyre këndohen në mjedise festive e familjare gjatë gjithë kohëve. Autori e konsideron Festivalin e Këngës së muzikës së lehtë një manifestim të bashkëpunimit të suksesshëm mes autorëve, kompozitorëve, instrumentistëve, orkestruesve, dirigjentëve, këngëtarëve e gjithë atyre që mbështesin logjikën për t'i vënë në skenë krijimet.

Duke u mbështetur në faktin që populli bashkëjeton me muzikën, me intensitet në rritje thekson rritimin e hovshëm që mori arti muzikor, duke pasur parasysh rolin e Konservatorit Shtetëror. Në të morën kulturë muzikore, u perfektionuan si specialistë një plejadë e tërë kompozitorësh të rinj, këngëtarësh, instrumentistësh, orkestruesish, dirigjentësh. Nëpër qytetet kryesore të vendit u rritën profesionalisht orkestrat. Në shumë vende u krijuan orkestrina amatore, por me cilësi profesionale. Këto ndikuan shumë në rritjen e shijeve estetike të dëgjuesve dhe lindi nevoja e zgjerimit të veprim-

tarisë së Radios. Pas vitit 1965 Radio Tirana kaloi nga transmetin tetë orë në ditë, në program njëzet e katër orë. Lindi nevoja e përfshirjes së specialistëve dhe redaktorëve të rinj. Ndër ta, edhe Zydi Fortuzi, i cili u emërua Përgjegjës i Radaksisë së Krijimeve dhe Regjistrimeve Muzikore.

Festivalin e parë të Këngës në RT, zhvilluar më 21-23 dhjetor 1962, autori e cilëson pasqyrë reale të potencialit krijues e interpretues, i cili u bë baza për të ndërthurur një të ardhme. Ky ishte sinjal progresi e stil i ri, ku dolën në evidencë artistë të rinj. Vazhdimësia e festivaleve deri në të 14-in që na sjell autori, pati uljet e ngritjet e nivelit artistik. Këto autori i argumenton me fakte konkrete dhe, jo pa zemërim, reagon ndaj ndërhyrjes së autoriteteve të kohës, për të pasur nën kontroll kategorinë e artistëve profesionistë dhe aktivitetin e tyre krijues. Gjatë kësaj periudhe, dalin në dukje marrëdhëniet mes artistëve me eksperiencë dhe atyre të rinj, si tregues i përtëritjes së vazhdueshme të aktivitetit, por edhe i tërheqjes së publikut.

Bazuar në atë çka përcjell përmes librit, është me vend të shkruhet diçka mbi karakterin e personalitetin edhe në rolin e autorit të librit "Gjurmë të arta". Muzikanti Zydi Fortuzi, ashtu siç janë në përgjithësi artistët, është tepër i ndjeshëm ndaj ngjarjeve ku protagonistë është pikërisht

muzika. Në këtë ndjeshmëri, ajo që bie në sy, është pozitiviteti. Edhe reagimi është pozitivitet, kur vlerësohet me objektivitet një aktivitet i rëndësishëm i jetës shpirtërore të një populli e, në veçanti, kur frenohet veprimtaria e artistëve përkundër edhe logjikës më të thjeshtë. Është e papranueshme që drejtues të veshur me pushtet bëhen shkatërrues e vrasës të shpirtit krijues profesionist. Detyrimisht ndihemi keq kur mësojmë reagimin e autorit ndaj veprimit të partizanëve më 1944 që asgjësuan gjithçka ishte regjistruar gjatë viteve të luftës. Po aq keq ndihemi kur kritikata pa sens profesional e logjik drejtohen ndaj autorëve të teksteve, kompozitorëve, këngëtarëve, skenografëve e tj, në emër të luftës imagjinare e propagandës së verbër, për ta futur artin në kanalën e politikës. Kulmi ishte qëndrimi i instancave shtetërore ndaj festivalit të 11 dhe pasojat fatale ndaj shumë artistëve me potencial të madh

krijues. Nga pikëvështrimet e autorit kuptojmë se ai tenton me gjithë forcën të shkëputet nga mediokriteti, nga varfëria e elementeve ritmike, nga mosdhënia vlerë theksit kombëtar në krijimtari. Duke qenë muzika e lehtë diçka e re në kulturën tonë, ajo përvetësohej më shpejt nga rinia. U kalua nga tonalitetet e qeta, në ritme dinamike dhe alegre. Ky fakt çon në një angazhim gjithnjë e më serioz e profesional, për t'i dhënë fizionominë origjinale kombëtare e të konsiderohej si diçka moderne dhe shenjë civilizimi e përparimi.

Në vlerësimet e shkurtra që ka shkruar për festivalin, për secilin ka përmendur risitë. Autori ka shumë respekt për frymën e re dhe për talentet e reja në çdo specialitet të muzikës, si kompozitorët, orkestruesit, këngëtarët, autorët e teksteve e dirigjentët. Nëse do të sillja një shembull, do të përmendja me sa adhurim shkruan për prezantimin si konkurues në skenë vetëm 13 vjeç të David Tukçit dhe suksesin e paimagjinuar. Tepër interesante dhe me informacione e vlerësime në libër janë skemat për artistët protagonistë. Ato shoqërohen me foto dhe me cilësimin e momenteve kulmore në krijimtarinë e tyre. Për secilin shton se sa i vyer është kontributi i tyre në dobi të kulturës dhe publikut tonë. Ato janë të ilustruara me foto dhe portreti i shkurtër me fjalë është si kurorë për ta. Për ilustrimet në libër kontribut ka dhënë edhe bashkëshortja e tij, zonja Lumturije Fortusi, e pasionuar dhe e afirmuar si piktores.

Duke qenë në shpirt artist, duke qenë intelektual dhe personalitet me përgjegjësi shtetërore, autori nuk i ndau kurrë nga vlerat humane që manifeston. Për asnjë rast nuk përmend punën intensive dhe cilësore që ka zhvilluar në shërbim të artit dhe të transmetimit të tij tek publiku. Gjithnjë shohim të vlerësojë folësit, prezantuesit, autorët, muzikantët, teknikët, dhe kjo tregon shpirtin e tij të pasur e modest. Kësajsoj mbetet shembull i përkushtimit të lartë. Ndërsa ne lexuesit duhet ta përkthejmë në respekt e përlujt të thellë ndaj maestro Zydi Fortuzit, duke menduar se kështu janë heronjtë e ditëve tona.

Ky është një libër xhepi. Jo. Është një libër dore. Sepse kështu dëgjohen rrahjet e cope të bëshme zemre (për të mos thënë të tërë) që autori ka vënë në të. Krejt i thjeshtë për t'u kuptuar, lehtësisht i përvetësueshëm dhe me të dhëna interesante që publiku i sotëm nuk di. Të sjella si kujtime faktet e ngjarjet që kur u themelua Radio Tirana dhe ecuria e punës krijuese nëpër vite, veçanërisht në fushën e muzikës dhe rritja cilësore e saj nga festivali në festival, janë një flad i freskët për vetëdijen kombëtare.

Me rastin e 120 Vjetorit të Lindjes

GJON MILI, NJË ARTIST ME PËRMASA BOTËRORE

Gurë Kilometrikë në Jetën dhe Veprimtarinë Artistike

Nga Kristaq BALLI

Më 28 Nëntor mbushen 120 vjet nga lindja e Gjon Mili, artistit shqiptar - amerikan me famë botërore.


Historia e jetës, veprimtarisë dhe karrierës së tij ekstravagante, sensacionale dhe inkandeshente, si drita fotografike strobe që ai përdori, nis rëndom si ajo e shumë emigrantëve të tjerë korçarë, që u ndanë me atdheun e tyre nativ qysh shumë të rinj për për t'u arsimuar e edukuar dhe, më pas, për t'u nënshtruar dhe dedikuar tërësisht punës agresive, por edhe pasioneve, entuziazmit, fantazisë, talentit e ëndrrave të tyre humane.



I lindur dhe pas një fëmijërie të hershme në Korçë, familja e madhe Mili emigroi së pari në Rumani, ku kishte një komunitet shqiptarësh, kryesisht nga Korça. Adolehencën e rininë e parë e jeto në Bukuresht, ku edhe u shkollua me arsim të mesëm në Kolegjin Kombëtar "Gheorghe Lazar" të kryeqytetit rumun. Kur ishte 19 vjeç, më 1923 ai shkoi në Boston të ShBA. Menjëherë, aty nis e vijon studimet universitare në degën e inxhinierisë elektrike në një prej universiteteve më të zëshëm në botë, Institutin Teknologjik të Massachusetts, (MIT). Gjatë jetës studentore ai ka eksperimentuar sprovat e tij të para të pasionit dhe prirjeve në fushën e fotografisë. Njëherësh, ushtroi edhe talentin e tij në letërsi, me ç'rast, në mes të krijimeve të tjera, ai në 1928-29 boton edhe disa proza të shkurtra letrare ("Larg", "Endërr" dhe "Nëna" në gazetën "Dielli" dhe në revistën letrare "Studenti shqiptar" të Odise Paskalit në Torino). Ai luan, gjithashtu, në oboe, madje në vonë do të praktikohet edhe në piano, duke shprehur, pra edhe prirje muzikore që do ta ndihmojnë atë në krijimtarinë e tij artistike. Bahun e kishte kompozitorin e tij favorit dhe e dëgjonte dendur. Me to është e lidhur




njohja dhe miqësia me Faik Konicën, apo aktivizimi si redaktor në gazetën "Dielli" dhe në Shoqërinë Panshqiptare "Vatra", të cilat kanë ushtruar një ndihmë vendimtare për jetën mëmëdhetare, intelektuale e artistike të Gjon Mili. Për këtë vetë Mili shkruan: "...zura miqësi me Faik Konicën, një mik i vjetër shqiptar. Një shkrimtar elegant, një humanist i kulturuar dhe një intelektual i mprehtë, Konica, nxiti interesin tim për artet, veçanërisht për kinematografinë". (Gj. Mili-Photographs & Recollections- Boston, 1980- faqe 18). Profesionin e inxhinierit e ushtron fillimisht për 10 vjet rresht në kompaninë elektrike "Westinghouse" deri në vitin 1937, ku ai është marrë kryesisht me punë dhe aktivitetet të natyrës shkencore në dobi të zbulimit dhe përmirësimit të teknologjive dhe paisjeve shkencore të ndriçimit dhe optikës.



Mandë do të shkëputet prej saj, për t'u kushtuar përfundimisht kamerës së errët, me të cilën do të lidhej me valenca të pashkëputura gjithë jetën. Edhe për filmin ka patur synime profesionale, madje ai fantazonte se një ditë do të shkonte në Hollywood, të cilin e arriti artistikisht shpejt, më 1942.

Më 1934 ai hapi ekspozitën e tij të parë jo formale fotografike.


Ndërkaq, më 1937, ai njihet gjatë një simpozium shkencor, në universitetin ku kishte studiuar, me profesorin dhe shkencëtarin Harold Edgerton (1908-1988), i cili konsiderohet si shpikësi i fletit elektronik (drita stroboskopike, blic, 1931), që krijonte



mundësi të reja moderne fotografimi dhe që u bë për Milin katalizatori i fotografisë futuriste dhe gjenialitetit të tij profesional në këtë art pamor. Pas një sërë



eksperimentimesh fotografike me dritën elektronike e bashkëpunimesh me Edgerton, i cili ia fali shpikjen e vet artistit për ta rigjeneruar atë artistikisht, po në këtë vit fillon punën e tij si fotoreporter në revistën e re "Life" të New Yorkut, aso kohe e për shumë vjet rradhazi e mirënjohur botërisht, e cila do të ishte për Gjon Milin afirmuesja e e krijimtarisë fotografike tepër inovative, të sukseshme e të admirueshme nga një opinion i gjerë artistik e shkencor botëror. "Në këto vite revista dhe fotografi filluan rrugën e tyre të lavdisë...Kjo përzierje e algjebërës me harmoninë do ta bënin Milin një nga fotografët më të njohur në Amerikë"(Andrea Visokov) Edgerton thotë për Milin: "Ai njohu forcën e dritës strobe dhe për vite na udhëhoqi në këtë fushë në një rrugë me të vërtetë imagjinare." Foto të tilla si ajo e daljes së një predhe



nga gryka e topit, me shpejtësi shkrepjeje të fraksioneve një të miliontën e sekondës (1942, e cila u quajt shpikja e shekullit), ajo e baletit "Lindy Hop"(1943), qindra foto stroboskopike në faqet dhe kopertinat e revistës "Life" e të revistave të tjera, ku ai pati kontrata të shpeshta, të personaliteteve të shquar artistikë, kulturorë, shkrimtarë, piktorë, balerinë, sportistë, shkencëtarë, supermodele, aktorë, muzikantë, politikanë, nudo, fotomontazhe, etj., shfaqen nëpërmjet një filtri abstragues, krijues, e estetik të një niveli shumë të lartë.


Ekspozitën e parë vetiake "Dance in Movement" (Vallzim në Lëvizje) e ka hapur në Muzeun e Artit Modern-MoMa në fillim të vitit 1942.

Në Janar 1943 në galerinë fotografike të Muzeut të Brooklin u çel ekspozita e përbashkët me Harold Edgertonin "Stroboscopic Photography" (Fotografia Stroboskopike) Të kësaj kohe (1943) janë edhe veprimtaritë e famshme të të ashtuquajturave "Jam Sessions", të iniciuara nga vetë Gjon Mili dhe Norman Granz, sipërmarrësi dhe prodhuesi më i madh i disqeve në ShBA, partit, apo mitingje, mbërmje të gjata artistike me dashamirës e profesionistë të artit e kulturës ku improvizohet e interpretohet krijimtaria e re letrare, vizive e muzikore e ku rriheshin debate estetike e kulturore. Nga këto mbërmje Gjon Mili njihet si autor filmimesh dhe një sërë botimesh e regjistrimesh interpretative muzikore në disqe, filma (sot edhe në CD). Veçmas studioja e tij u quajt edhe "Athina e Nju Jorkut" (Henri Cartier Bresson).

Ekspozitën e parë jashtë amerikë të Gjon Mili të vitit 1946 në Paris e inauguroi me entuziazëm filozofi e shkrimtari i madh Zhan Pol Satri. Midis të tjerash ai ka shprehur këtë konsideratë: "Për atë ka një pafundësi mënyrash të fotografiuar, siç është pafundësia e gjërave që na rrethojnë"

Por pasioni për filmin nuk i ishte venitur. Midis filmimeve të ndryshme, ai shpërthen nëpërmjet një filmi të bujshëm muzikor, më 1944, të gjatë vetëm 10 minuta, por i një niveli artistik mjeshtëror, që e bëri të famshëm në të gjithë Amerikën e sidomos në botën e muzikës khaz e bluz. Filmi duket sikur përbëhet prej një shumatore qindra sekuencash e tablosh fotografike sipas stilit origjinal të Gjon Mili. Filmi nën emrin "Jammin' the Blues", me muzikantët e shquar të top jazz Lester Young, George Red Callendar, Harry Edison, Marlowe Morris, etj. është nominuar për çmimin Oscar më 1945. Ai vijon të shfaqet edhe sot. Për hir të këtij suksesi pianisti Mary Lou Williams kompozoi në respekt të realizuesit të tij një pjesë jazz me titullin "Gjon Mili Jam Session". Gjon Mili i atribuohet edhe një film tjetër dokumentar prej afro 3 minutash të titulluar "Henri Cartier-Bresson", ku ky fotograf i shquar francez është duke kërkuar çastin vendimtar të fotografimit. Ndërkaq, pas disa vitesh gjenden materiale bruto regjistrimi të një filmi të ri muzikor ala "Jam Sessions", por ai ka dështuar për arsye financiare. Ka xhiruar me skenar të tijin edhe filma të tjerë dokumentarë, si "Improvisation", apo disa sprova të tjera kushtuar veprës së Pablo Casals-it, Shon O'Kejs-it, Henri Bresson-it etj.

Viti 1949 kur ai u takua me piktorin e famshëm Pablo Pikaso në Francë e kur ai realizoi ciklin me foto "Vizatimet me Dritë", ku piktori pozonte duke vizatuar me bilë elektrike në ajër, ishte nga më të veçantit e më të bujshmit e jetës dhe krijimtarisë së tij. Ky cikël ftohes përbente një vepër të dyfishtë surprizuese të Pablo Pikasos dhe Gjon Mili. Pablo Pikaso, kur pa fotografitë që ai i kish bërë, u shpreh: "Edhe me teknikë krijohen vepra artis-



tike". Me Pikason e vizatimet e tij në epiqëndër, por edhe me shumë piktura të tij, ai realizoi shumë fotografi, aq sa nga kujtimet dhe mbresat e tij miqësore, artistike e estetike me piktorin e madh, më 1970, Mili botoi librin katalog "Picasso's Third Dimension" (Dimensioni i Tretë i Pikasos).

Nga fundi i viteve '40 ai rralloi fotot me teknikën stroboskopike: "pas një dekade unë u vela me dritën strobe sepse kisha bërë pothuajse gjithçka dhe nuk doja të përsërisja veten". Por jo përfundimisht. Herë pas here ai kujtohej, ngarkonte bateritë, kondensatorët, ndriçuesit e paisjet e tjera strobe dhe këtë e bëri deri në fund të jetës. Për disa kohë, përkohësisht, ai punoi si ndihmës i fotografit shumë të famshëm Edward Weston, por pa u shkëputur asnjëherë nga revista "Life" Në disa foto të këtyre viteve firmën e mjeshtrit e gjejmë me vulën "Mili Studio".

Në vitet 1950, Gjon Mili ishte në kulmin e popullaritetit.

Në Janar vitin 1950, bashkë me fotografin e njohur Robert Kapa kanë hapur ekspozitë në Mueun e Artit Modern MoMA me foto kushtuar Pikasos. Kjo ekspozitë me 70 foto është çelur edhe në Paris në Galerinë Salon De Mai në vitin 1952. (Life.com).

Më 1955 Mili mori pjesë në ekspozitën më të madhe kolektive botërore të fotografëve të shekullit të kaluar në ShBA dhe vende të tjera me emrin "Familja e Njeriut" me 5 foto, midis të cilave "Nudo, duke zbritur shkallët"

Më 1959 në një sondazh të revistës amerikane "Popular Photography" ai konsiderohet si një nga 10 fotografët më të mirë bashkëkohorë të botës. Ja si e shpjegon ai angazhimin e vet:

"Brez im ardhni në një kohë kur fotografia po




avanconte me kërcime e bume, duke krijuar nxitje për të eksperimentuar dhe tentuar shtigje të reja."

"The Magic of the Opera" (1960) është libri i parë fotografik kushtuar historisë së Operas Metropolitane të Nju Jorkut me fotografi të vjera operistike nga Gjon Mili dhe të ilustruara me tekst nga Mary Ellis Peltz (bashkautore), drejtore e arkivës të operas metropolitane.

Tepër tragjik shfaqet viti 1966, kur fotografit i digjet studioja e tij në Manhatan, një nga më të mëdhatë e më të përshtatshmet në botë, dhe bashkë me të foto, shumë materiale fotografike, shkrime dhe korrespondenca e tij, që do të krijonin një kosto e humbje të dhimbshme materiale e shpirtërore për gjithë krijimtarinë dhe jetën e tij.

Në vitin 1970 ai boton katalogun me foto e tekst "Picasso's Third Dimension" kushtuar jetës dhe veprimtarisë së Pikasos. (vijon në faqen 23)



“Harta arkeologjike e pellgut të lumit Pavla” provon se Epiri dhe Iliria i kanë të përbashkëta themelet e qytetërimit të tyre

Nga Kujtim Mateli - Tirane

Libri “Harta arkeologjike e pellgut të lumit Pavla” me autor arkeologun dhe historianin e mirënjohur Halil Shabani, është një nga librat më të çmuar dhe të rëndësishëm të autorit, por dhe një gur themeli në historinë e arkeologjisë shqiptare. Pellgu i lumit Pavla ka qenë i banuar që nga Paleoliti, si rezultat i kushteve klimatike që e bënë të përshtatshme ekzistencën e njeriut. Po ajo që ka rëndësi në jetën e një populli është koha e fillimit të qytetërimit të tij. Koha kur njeriu u shkëput nga jeta e egër dhe e vetmuar dhe iu drejtua qendrave të banuara, ndryshoi mënyrën e jetesës dhe e pasuroi botën e tij shpirtërore me mite dhe legjenda.


Arkeologu dhe historiani Halil Shabani u lind më 25. 11. 1949, në Shalës të Konispolit. Ka mbaruar Universitetin e Tiranës në vitin 1973, në degën Histori-Gjeografi. Ka punuar si mësues historie dhe që nga viti 1976, është marrë me studime dhe gërmime arkeologjike në krahinën e Konispolit dhe në rajonin e Delvinës e Sarandës. Është zbuluesi i dhjetëra sajteve arkeologjike me rëndësi kombëtare si: Shpella e Kreshmës në Konispol, Kalaja e Dishatit, fortifikimi në Shuglat të Sopikut e në Aravuna të Gravës, Vastroi i Shalësit, skulptura e Perëndisë së Panit e derdhur në bronz etj. Punimet e tij i ka pasqyruar në botimet e revistë periodike e shkencore “Iliria” dhe organe të tjera të shtypit të përditshëm. Ka marrë pjesë në shumë ekspedita arkeologjike, ka kryer disa gërmime arkeologjike me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare, si ekspedita e bashkëpunimit shqiptaro-amerikan me Universitetin e Teksasit – SHBA, Greqi, Itali etj. Është bashkëpunëtor shkencor i Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike në Tiranë. Është autor i 17 librave dhe i qindra shkrimeve shkencore në revista të ndryshme. Për kontributin e tij të çmuar, është vlerësuar dy herë me medaljen e urdhërit “Naim Frashëri”.

Autori e ka drejtuar studimin e tij në dy drejtime: E para: në evidentimin e gjetjeve arkeologjike që u përkasin periudhave të ndryshme, të cilat vërtetojnë se pellgu i lumit Pavla ka qenë i banuar që 40 mijë vjet më parë.

E dyta: në gjetjet arkeologjike që lidhen me botën shpirtërore të njeriut, ku rolin parësor e përbënin hyjnitë, siç është Pani i Milesë ose terakota e perëndeshës Kibela në Çukën e Ajoit, të shkojë në origjinë të miteve dhe legjendave. Njerëzit e lashtë heronjtë dhe hyjnitë i kanë përjetësuar në statuja bronzi ose metale të tjera, por edhe në emra lumenjsh, malesh, luginash etj., siç është ajo për Kadmin që kjo zonë e ka përjetësuar me emrin e lumit të saj që është ndoshta emri i parë i lumit të sotëm Pavla.

Lugina e lumit Pavla, është një ndër trevat shqiptare më të pasura me vende arkeologjike që kapin nga periudhat më të hershme prehistorike deri në ato të periudhave të mëvonshme. Krahas dëshmiarve arkeologjike që e tregojnë këtë pasuri materiale, njeriu i ditëve të sotme është i interesuar edhe për pasurinë shpirtërore, të cilën brezat ia përcollën njeri-tjetrit deri në ditët e sotme. Autori i këtij studimi i është drejtuar pothuaj të gjithë autorëve të antikitetit, që kanë shkruar për këtë krahinë dhe ka arritur në përfundimin se pika më e largët kohore është legjenda për Kadmin dhe Harmoninë që njihen si dy hyjnitë kryesore të etnosit ilir. Dëshmia më e plotë për këtë krahinë është ajo e Stefan Bizantinit, të cilën autori i këtij studimi e ka sjellë të gërshtuar edhe me autorë të tjerë të antikitetit:

Stefan Bizantini: “Kammania-krahinë e Thesprotisë, më vonë u quajt Kestrinë, nëpër të cilën rrjedh Kadmi, lumi i Kestrinës; e themeloi Kestrini, biri i Priamit. Banorët quhen kammanoi” (Ilirët dhe Iliria të



autorët antikë fq. 419.)

Kadmi dhe Harmonia, si personazhe mitologjikë, kanë historinë e tyre e cila ngjitet në kohë deri në zanafillë të lindjes së hyjnieve pellazge. Harmonia është motra e perëndisë së Luftës, Aresit, që është një nga perënditë kryesore pellazge. Që do të thotë se sistemi i perëndive ilire ka qenë i gërshtuar me ato pellazge, janë zhvilluar në të njëjtin shtat: në territorin e Epirit që konsideroj pellazg me atë ilir që shtrihet në veri të Epirit. Kjo vërtetohet me faktin që hyjnia pellazge Di nderohej që nga Gjiri i Ambraqisë deri në gjirin e Kotorit në Malin e Zi. Po ashtu, Kadmi dhe Harmonia gjenden nga gjiri i Kotorit (Skylaks Kariadensis, Lundrimi, “Enkelejtë janë fis ilir, ngjitur me Rizonin. Gjendet te: “Ilirët dhe Iliria të autorët antikë, faqe 36) përgjatë bregdetit të Ilirisë deri në malet Akrokeraune, që shënojnë kufirin veriperëndimor midis Epirit dhe Ilirisë. Pikërisht në gjirin e Vlorës deri në kufijtë e Apollonisë, ky territor banohej nga enkelejtë ilirë që nderonin Kadmin dhe Harmoninë. (Hecataei Milesii, Fragmenta nr 75, faqe 66. “Ipsa Irici regio non annumeratur Chaoniae, sed est Illyriae, et quidem Oncheleorum.”)

Nga Stefan Bizantini mësojmë se krahina e Kestrinës më parë quhej Kammania. Ndërrimi i emrit nga Kammania në Kestrinë, i përket periudhës pas Luftës së Trojës, kur Kestrini, i biri i Priamit të Trojës, u vendos në veri të lumit Thiamis (sot Kalama) dhe territori mori emrin e tij. Nga pikëpamja kohore kjo krahinë ka patur dy emra: para Luftës së Trojës quhej Kammania dhe pas Luftës së Trojës Kestrina. Lumi që rrjedh në këtë territor është lumi Pavla. Nga pikëpamja kohore ky lumë ka patur dy emra: deri në shekullin e Stefan Bizantinit (shek.VI pas Krishtit) lumi quhej Kadmi, pas shekullit të VI pas lindjes së Krishtit, në një periudhë të panjohur, lumi ka marrë emrin Pavla. Ajo që na intereson është emri i parë që ky lumë ka pasur, i cili është thirrur me emrin e Kadmit, të cilin ilirët e konsideronin si paraardhësin e tyre dhe e nderonin në nivelin e Hyjnisë. Kadmi dhe Harmonia janë prindërit e Ilirit, që sipas disa autorëve, nga emri i tij e mori emrin Iliria dhe populli u quajt ilirë. Koha kur janë hyjnizuar Kadmi dhe Harmonia i përket periudhës së para Luftës së Trojës, pra përpara shekullit të XII para lindjes së Krishtit.

Pyetja shtrohet: cilat janë arsyet që Kadmi të nderohet edhe në Iliri, edhe në Epirin pellazg? Një nga arsyet mendoj se është, sepse Kadmi

kishte bashkëshorte Harmoninë, motrën e Aresit, perëndia pellazge e Luftës që nderohej në Pasaron, në kryeqytetin e Epirit. Kjo tregon se Epiri pellazg dhe Iliria i kishin të përbashkëta hyjnitë: Harmonia nderohej në Epir, por edhe në Iliri. Kadmi nderohej në Iliri, por edhe në Epir.

Lidhjen e ngushtë midis Epirit dhe Ilirisë e tregojnë dhe gjetjet e shumta arkeologjike të zbuluara në të dy anët e lumit Pavla. Arkeologu Halil Shabani sjell gjetjet arkeologjike të gjetura në Shpellën e Konispolit dhe lidhjet e këtyre gjetjeve arkeologjike me vendbanimet e tjera të Epirit dhe Ilirisë. Në periudhën e neolitit, qeramikat e gjetura “ngjasojnë me qeramikën e vendbanimeve Vlushë, Podgorie dhe Vushmi-Shqipëri... Neoliti i vonë paraqitet me kupa gjysmë sferike që ngjasojnë me ato Maliq 1, Katundas Berat etj. Epoka e bronzit e cila paraqitet me enë me vegje të shkurtra, ngjasojnë me ato Maliq III-a, Maliq III-b, Katundas e Bënjë -Përmet.” (Halil Shabani, “Harta arkeologjike e pellgut të lumit Pavla” faqe 246)

Siç shihet në këtë periudhë që u përket mijëvjeçarëve IV-II para lindjes së Krishtit, këto treva pellazge të Epirit dhe ato të Ilirisë, nuk kanë pasur të përbashkët vetëm mitologjinë dhe besimin e Hyjnia e tyre e përbashkët Di, por edhe kulturën materiale, që do të thotë se ato kanë qenë në lidhje të vazhdueshme midis tyre, shkëmbim përvojash e lëvizje të grup-familjeve nga njëri territor në tjetrin. Në këtë lëvizje Dodona ka qenë epiqendra që bashkonte njerëz nga të dy anët e shtrirjes së saj gjeografike, ku një arritje në fushë të qeramikës në një territor të caktuar, bëhej model për t’u përcjellë edhe të banorët e krahinave të tjera. Epoka e bronzit ka një vazhdimësi, të cilën e gjejmë te epoka e Hekurit dhe kjo e fundit është e pëzier me periudhat antike dhe mesjetare.

Banorët e të dy krahëve të lumit Pavla i kanë zanafillat e njeriut që ka dashur të shpreh emocionet e veta në lidhje me natyrën ose të depërtonin dhe të shprehnin një mendim për jetën që i rrethonte me anë të shenjave dhe simboleve, thellë në histori. Ata kërkonin të komunikonin nëpërmjet figurave të gëdhendura në gurë apo shkëmbinj me banorët e tjerë përreth vendbanimit të tyre, të shprehnin një mendim ose emocion. Mund të përmendim pikturën murale në Bogaz. “Edhe pse piktura nuk është e plotë, ajo është dëshmi e fantazisë së njeriut të lashtë të paleolitit. Piktura paraqet një zog shqiptarë të dëmtuar.” (po aty, faqe 46)

Banorët e kësaj treve kanë bërë përpjekje që të komunikonin midis tyre, të cilat mund t’i konsiderojmë si fillesat e një shkrimi ku mund të përmendet: “Gdhendja e 9 vijave, në një pllakë guri ranor, gjetur në shtresat kulturore të neolitit, që mbart elemente të shkrimit kujnor” (po aty faqe 250) Banorët e kësaj zone besojnë akoma si në kohët e besimit pellazgjik, kur vendet shenjtëroreshin dhe njerëzit shkonin atje për të bërë lutje dhe flijime për të realizuar atë, të cilën ata e kanë pasur të pamundur. Gjurmët e këtij besimi gjenden të Shpella e Shën Marinës. Ajo ka qenë e banuar që nga periudha prehistorike (40.000 vjet më parë) dhe në vazhdimësi njerëzit e kanë shenjtëruar atë sipas besimit pellazgjik. Në ditët e sotme konsiderohet si vend i shenjtë i kyjerëz të Shqipërisë Jugore vijnë aty duke besuar në shërimin e sëmundjeve të ndryshme.

Banorët e pellgut të lumit Pavla, përgjatë periudhës së antikitetit, i kanë lënë gjurmët e tyre në tempujt që kanë ngritur dhe hyjnieve që i janë përkushtuar. Në Dobra, gjendet, tempulli i Demetrës, i cili datohet i shek. IV para Krishtit, ku dhe është gjetur skulptura e Perëndisë Demetra, por koka e saj është grabitur. “Teknika e ndërtimit të tempullit të Dobrës, thotë autori i këtij studimi, Halil Shabani, është i njëjtë me atë të tempullit të Foinikes, të Butrintit, të varrit monumental

të zbuluar në kodrën Goleme, pranë fshatit Palavli në zonën e Vargoit...” (Po aty faqe 204). Përmasat e saj ishin gati dy herë më të mëdha se ato të trupit të njeriut. Kjo tregon se hyjnesha nuk nderohej vetëm në banesat e çdo familjeje ku mbahej në përmasa të vogla, por kishte një nderim publik ku mbledheshin njerëz nga të gjitha trevat përreth e kryenin ceremoni fetare të përbashkëta. Në një ekspeditë, që autori i këtij studimi, Halil Shabani, ka realizuar në malin e Milesë me nxënësit e shkollës 8-vjeçare Shalës, Konispol, gjeti statujën që i përket perëndisë pellazge Pani, 19,5 cm e lartë, i cili ka të hedhur krahëve një lëkurë luani:

“Tiparet e kësaj figurine janë punuar me mjeshtëri të mallë dhe triumfuese mbi kafshën më të fuqishme luanin. Duke u mbështetur tek objektet që paraqiten, briri dhe shkurra, paraqita e fytërës dhe këmbët e çapit, skulptori ka realizuar perëndinë e Panit. Për trevën e Epirit, Pani i Milesë është e para figurinë e derdhur në bronz. Deri tani Pani është gjetur në relieve dhe i shoqëruar nga nimfat, por i dëmtuar dhe në mermer. Ato relieve janë gjetur në Pllaçë të Vlorës, Durrës, Elbasan, Dimal dhe Apolloni. Pani i Milesë paraqet një perëndi ilire dhe epirote dhe u paraqiti si hyu i mbrojtjes së pyjeve, kullotave dhe barinjve. Por e plotë, figurina e Panit u gjet vetëm këtu në Mile. Njëkohësisht është edhe Simboli i bujqësisë e blektorisë.” (Po aty faqe 225)

Këto gjetje arkeologjike dhe të tjera, vërtetojnë se banorët e pellgut të lumit Pavla, kishin një botë të pasur shpirtërore, besonin në hyjnitë kryesore pellazge dhe e ndërtonin jetën e tyre mbi parime hyjnore të cilat u tregonin njerëzve si duhet të jetonin në shoqëri dhe si duhet të vepronin për të pasur një jetë më të mirë. E gjithë kjo botë shpirtërore, e ngritur mbi heronj dhe hyjni, është krijuar në qendrat kryesore të kësaj treve: “Periudha e antikitetit iliro-epirot, në pellgun e lumit Pavla përfaqësohet qartë nga qytetet antike si: Çuka e Ajoit, qyteti në Malçan, Diaporiti-pjesë përbërëse e Butrintit, Vastroi, Ripsi, Paleomanastiri, Llako-Grava, Kalaja e Vagalatit, Vila në Dobra, Vila në Malthe, Kalaja e Dishatit, Rashku, fortifikimi në Shuglat të Sopikut, si dhe shumë vendbanime të tjera që u përkasin territoreve të hapura fshatare.” (Po aty, faqe 246)

Qytetërimi i pellgut të lumit Pavla është i lidhur ngushtësisht me qytetërimet e tjera të Shqipërisë Jugore dhe më gjerë, teknika e ndërtimit dhe arkitektura e banesave kanë të njëjtën analogji me qytetet e tjera të së njëjtës periudhë si: Foinikes, Butrintit, Antigonesë, Bylysit etj. Kjo ndërthurje e qytetërimit të lumit Pavla me qytetërimet e krahinave të tjera të Epirit dhe Ilirisë, tregon se iliro-epirotët kanë qenë në marrëdhënie të vazhdueshme midis tyre, në ngjizjen e një kulture të përbashkët që përcaktojnë dhe themelet e përbashkëta të identitetit iliro-epirot.

Autori nënvizon se periudha mesjetare në pellgun e lumit Pavla, paraqitet me një numër të madh objekteve, ku gjenden kala dhe manastire, kisha dhe varreza të shumta. Vendbanimet më të rëndësishme të kësaj periudhe si: Llapsaneza, Palambari, Rrëza, Bregu i Sterrës, Stismasi, Lëmi i ri në Dishat, Munguli, Paleofshati i Ninatit, Shuglat i Sopikut, etj., japin një tablo të qartë të vendbanimeve fshatare në Mesjetë. Qeramika e gjetur në këto vendbanime ka lidhje të ngushtë me qeramikën e gjetur në qytetet dhe qendrat e banuara të Shqipërisë së Jugut. Teknika e ndërtimit të kalave ka ngjashmëri me kalatë e ndërtuara nga Ali Pashë Tepelena që i përkasin fillimit të shek. XIX. Pra, kemi në këtë trevë të Shqipërisë jugore një vazhdimësi që fillon nga periudhat e hershme të neolitit deri në ditët e sotme, që tregon për vazhdimësinë e së njëjtës popullsie në këto treva iliro-epirote që kanë ruajtur jo vetëm mitet dhe legjendat, por edhe kulturën materiale të cilën e kanë përsosur vazhdimisht.

Një studim të thelluar arkeologu Halil Shabani ua ka kushtuar objekteve të kultit ortodoks siç janë kishat dhe manastiret. Ato fillojnë duke përfaqësuar periudhën parabizantine dhe atë bizantine, me akitekturë të zhvilluar e cila gjendet sidomos në disa nga manastiret siç është ai i Shën Kollit në Çiflik, i Shën Thanasit në Cercovicë, i Shën Theodorit, etj.

Me arkitekturë të zhvilluar janë edhe kishat e hershme ku mund të përmendet ajo e Shën Marinës në Malçan, Panajasë në Cercovicë, e Shën Gjergjit në Leshnicë etj. Ato janë të pasura me afreske murale ku paraqesin jo vetëm shenjtorin me emrin e kishës përkatëse, por edhe shumë shenjtorë të tjerë, si dhe figura të tjera të thjeshta.

Autori Halil Shabani, ka sjellë në këtë libër gjithë trashëgiminë arkeologjike dhe atë shpirtërore të pellgut të lumit Pavla, i cili i ka shkelur me këmbë të gjitha ato vende, duke qëndruar me orë dhe ditë të tëra, për ta sjellë sa më të plotë gjithë këtë pasuri me vlera të jashtëzakonshme. Nga 148 vendet që jepen në këtë libër, 100 prej tyre sillen për herë të parë, të tjerat janë zbulime të mëparshme të autorit ose referenca nga autorë të tjerë. Duke lexuar këtë libër, jo vetëm banorët e pellgut të lumit Pavla, por çdo lexues i trojeve shqiptare, gjen aty një pasuri të çmuar kombëtare që do t’u shërbejë: nxënëseve, studentëve dhe pedagogëve, historianëve dhe etnologëve dhe gjithkujt që është i interesuar për të njohur historinë dhe gjeografinë e vendit tonë.

ELBASANI DJEPI I DITURISË

Nga Rakip Zgumi e Shefit Doksani - Elbasan

Në se ka qytet në Shqipëri, që shquhet në fushën e arsimit, kulturës dhe artit, ky është Elbasani. Figura të ndritura që nga lashtësia, por dhe në kohën e Rilindjes, i kanë dhënë këtij qyteti dritën e diturisë. Kostandin Kristoforidhi i madh, babai i gjuhës shqipe, Dhaskal Todhri i shkronjave e dhjetra të tjerë u bënë pishtarë të dijes e kulturës. Me veprat e tyre ata kanë edukuar ndjenjat patriotike dhe atdhetare. Me të drejtë kronikani Turk, Çelebiu, në kronikat e tij e ka quajtur Elbasanin qytetin e poetëve. Kulmi u arrit me hapjen e Normales më 1909, e cila me të drejtë është quajtur «Universiteti» i parë shqiptar, nga bankat e të cilat dolën figura të shquara duke shërbyer në përhapjen e diturisë anë e mban atdheut, madje dhe jashtë tij, në gjithë trevat ku flitej shqip. Tradita që u krijua u pasuroi më tej nga breza të tjerë. U shquan në fushën e



gjuhësisë akademiku Aleks Buda, profesor Mahir Domi, profesor Mehmet Çeliku. Puna e tyre kolosale dhe e lavdërueshme e sinkronizuar në veprat e tyre shkencore, ka bërë që të ngrihet më lart cilësia e gjuhës shqipe.

Shtyes të mëtejshme në këtë drejtim kanë dhënë dhe krijuesit e letrave të të gjitha gjinive, të cilët i kanë dhënë kombit vepra të shquara, me vlera edukative. Vepra e profesor Dhimitër Shuteriqit, Ali Abdihoxhës, Dhimitër Xhuvanit, Fatos Kongolit, profesor Astrit Bishqemit, Shefik Karadaku, Musa Vyshkës, Milianov Kallupit etj.janë nga më të pëlqyerat dhe më të lexuarat. Kjo traditë vazhdon edhe sot me krijuesit Ferit Rama, Nexhip Ejupi, Rakip Zgumi, Shefit Doksani, At Stavri Çipi, Dhimo Tarusha, Mihal Disho, Beatrice Balliqi, Ahmet Mehmeti, Elena Duka (Xhina), Isa


Muca etj.të cilët lëvrojnë me sukses të gjitha gjinitë letrare si: poezi, tregime, novela, romane, fabula, veçantë romane historik, monografi etj. Një kujdes të hajqant për krijuesit Elbasanas tregon Bashkia e qytetit e cila

i përkrah dhe i ndihmon konkretisht në krijimtarinë e tyre. Përveç takimeve të shpeshta me kryetarin, nën kujdesin e saj dhe të shoqatës së krijuesve, çdo vit organizohet «nata poetike» me krijime të krijuesve të qytetit. Ky event tashme tradicional ndiqet me kërshtëri nga shumë artëdashës të moshave të ndryshme. Në këtë shkrim e kemi të veshitur të lëmë pa përmendur punën e përkushtim që bënë Biblioteka e qytetit nën drejtimin e zj. Manjola Hatellari, për përhapjen dhe leximin e librit. Në sallën e Bibliotekës zhvillohen aktivitete të shumta letraro- artistike si: promovime librash, takime të shkrimtarëve me lexues, me nxënëse shkollash etj. Gjatë muajit tetor, si muaji i letërsisë, më morinë e aktiviteteve, më interesant që la mbresa jo vetëm tek pjesëmarrësit, por tek gjithë artëdashësit, ishte takimi i krijuesëve me nxënësit e shkollave të mesme. Motivi i këtij takimi ishte pas librave fshihet një det plot dije. Zgjidh çdo herë një libër dhe lere dijen tënde të rrjedh. Në këtë takim, mes diskutimeve u shfaqën diafilma me thënie të figurave botërore për librat. U recituan nga nxënësit poezi të autorëve të shumtë dhe në fund u ndan distiktiva «miku i librit» etj. Veprimtaritë e shumta vëshmojnë që Elbasani ka dhënë dhe jep ndihmesën e vet, në të gjitha fushat e jetës e sidomos në atë arsimore, kulturore, letrare, muzikore etj.

AMBASADORI MAL BERISHA SJELL PËR NE “MALET E GJIGANTËVE”

Nga Elda Keçi, Tiranë

“MALET E GJIGANTËVE” është libri i promovuar me dt.5 Nëntor 2024 në Tiranë në ambientet e Hotel “Mariat”. Një vepër e vyer për të gjithë brezat shqiptarë e përkthyer nga Ambasador Mal Berisha, personalitet i njohur në fushën e Diplomacisë, ish Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar, diplomat në Konsullatën Shqiptare në Stamboll, pjesë e Misionit të Kombeve të Bashkuara UNMIK në Kosovë. Personalitet që i është përkushtuar e i përkushtohet shkrimeve, përkthimeve, artit e kulturës, çështjes shqiptare. Është gegë. Vjen nga një familje e vjetër, sepse fisi Berisha është në regjistrin e Prof.Coon që në vitin 1270 e ka përcjellë brez pas brezi kulturën shqiptare, traditën familjare e atë të leximit që edhe ai e ka trashëguar. Është autor i disa librave e disa botime përfshijnë përkthimet: “Shqipëria e Jugut ose Epiri i Veriut në çështjet Europiane dhe Ndërkombëtare 1912 - 1923”, nga Dr. E. P. Stickney, “Shpëtimi në Shqipëri” nga Harvey Sarnier, studimi nga National Geographic Magazine “Shqiptarët, Lisa mbi truallin ilir”, “Naltësimi i Iskanderit” nga Benjamin Disraeli, “Shqiptarët, evropianët më të lashtë dhe më të rinj”. Autor i librave: “Charles Telford Erickson. Jeta dhe vepra”, “Herman Bernstein, Jeta dhe Vepra” (në anglisht dhe në shqip), “Realitetet Shqiptaro-Britanike, “ Ambasador i Pushtetit të Butë”. Gjithashtu është vlerësuar me medaljen Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut. “Malet e Gjigantëve” është një nga promovimet e fundit në rrugëtimin e tij. Ky promovim përfaqëson vazhdimësinë e angazhimit të veçantë për vlerësimin e trashëgimisë kombëtare, një kauzë e mundësuar me mbështetjen financiare të z.Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm SLLGAL UNIQA AL-KS-MKV. Në këtë promovim morën pjesë shkencëtarë, akademikë, historianë, personalitete të fushave të ndryshme dhe nga trevat shqipfolëse. Gjithashtu morën pjesë:



zv.ambasadorja e Mbretërisë së Bashkuar në Tiranë, znj. Mia Marzouk, Dr. David Shankland, Drejtor i Institutit Mbretëror Antropologjik në Londër, i cili trajtoi temën për rëndësinë e kërkimeve antropologjike të Miss Edith Durham dhe Margaret Hasluck në Shqipëri, të cilave Prof.Coon iu referohet në librin “Malet e Gjigantëve”. Gjithashtu historiane, Prof.Ass.Dr Gentiana Kera, e cila foli për rëndësinë e librit, për studimet antropologjike dhe për njohjen e shoqërisë shqiptare të veriut të Shqipërisë gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. Ishte i pranishëm enkas për aktivitetin z.Ndrek Gjini, i cili

referoi për vendin e librit “Malet e Gjigantëve” brenda vepërës së Prof.Coon, “Racat e Evropës”. Autori i librit, Dr. Carleton Stevens Coon, një nga antropologët më të rëndësishëm amerikanë të shekullit të XX, i cili ka kontribuar më parë si profesor i antropologjisë pranë Universitetit të Harvard-it në Amerikë e më pas si Dekan i Fakultetit të Antropologjisë pranë këtij Universiteti. Për një kohë të gjatë ka qenë President i Shoqatës së Antropologëve të Shteteve të Bashkuara. Një figurë e rëndësishme për ne shqiptarët, pasi përveç veprave të tij të çmuara, ai shkroi këtë libër, një studim racor dhe kulturor për Gegët e Shqipërisë së Veriut. Është i pari dhe pothuajse i vetmi deri më sot që ka ndërmarrë një ekspeditë kaq të gjatë e pa ndërprerje gjatë viteve 1929 - 1930 në Malet e Gegnisë. Ai ka jetuar në terren së bashku me familjen e tij, gjë jo e lehtë për kushtet e atyre viteve në krahinat veriore të vendit tonë. Me studimet e tij, me analizat e të dhënave, me matjet e kryera prej vete atij të popullatës së gegnisë ka argumentuar praninë Iliro- Dinarike të shqiptarëve Gegë ne veri të Shqipërisë. Studime të matjeve antropologjike prej 1067 shqiptarësh, të realizuara prej tij nuk është përsëritur më që nga viti 1930. Madje gjatë viteve të diktaturës studime të ngjashme të kryera nga antropologë shqiptarë nuk kanë mundur të përmendin emrin dhe veprën e Prof.Coon edhe pse si antropolog i pavarur dha mendimin e tij pa asnjë ndikim ideologjik. Një libër me një titull kaq të fortë që nxit kuriozitetin për ta lexuar e ka motivuar Ambasadorin Mal Berisha për ta përkthyer e për të përcjellë tek ne atë sensacion që ka patur dhe ai kur e ka marrë në dorë këtë libër. Siç e njohim Ambasadori Mal Berisha vjen nga viset

e Tropojës dhe në mes bukurisë së maleve, gjëja e parë që sheh syri në mëngjes herët është drita e diellit në majën e Shkëlzenit. E nuk ka gjë më të bukur! E kjo bukurë është ndërthurur me fatet e këtyre njerëzve që kanë jetuar në mes të maleve me tyrbe, në vende të shenjta. I nxitur dhe nga miku i tij z.Ndrek Gjini, shkrimtar, antropolog dhe përkthyes, i cili jeton në Irlandë, por dhe një arsye tjetër që e nxitu Ambasadorin Mal Berisha të përkthejë këtë vepër unike ku nxirret në pah gjenealogjia e vendit tonë është fakti se Prof.Coon ka sjellë gjuhën e bukur angleze në formën më të përparuar për atë kohë, por edhe sot në fushën e antropologjisë. Në këtë libër vihet në dukje që Gegët janë vazhdimësi e pranisë së shqiptarëve Iliro-Dinarikë e Iliro-Dardanëve, të cilët jetuan në fortesat e tyre malore. Natyra ka bërë të mirën e vet, sepse këta njerëz në këto zona i janë përshtatur kushteve, por kanë ruajtur nga ana gjenetike kulturën, traditat e tyre. E kjo sipas Coon çiftëzimi, martesat nuk kanë patur përplasje ose më mirë të themi, lidhje gjaku. Shqiptarët nuk kane rezus. Pra, kjo tregon që ishte racë e pastër. Edhe kur hyri feja islame në jetën e disa zonave tona malore, ato ruajtën traditat familjare, martesore, në gëzimet e jetës, të rritjes së fëmijëve, të djepit etj. Tematikat që janë trajtuar në libër janë interesante, siç janë: Ekonomia e një shoqërie të izoluar, Politika dhe gjakmarrja, Jeta rituale, Antropologjia fizike e studiuar sipas moshës, detyrës, funksionit dhe trashëgimisë etj. Antropologjia e vërtetë shkencore që është marrë me çështjen shqiptare ka nxjerrë në pah elementë të genies sonë kombëtare, të cilat na bejnë ne dhe brezat e ardhshëm të jemi krenarë për atë çka është arritur. Historia nuk duhet harruar se nga vijnë. Dua të përmbyll me një thënie të Ambasador Mal Berisha: “Jemi një komb edhe pse i vogël, por i kemi dhënë diçka njerëzimit. Nuk jemi komb i heshur”. Dhe Ambasador Mal Berisha nuk hesht, por jep kontributin e tij në shoqërinë civile me vepra që bën krenar çdo shqiptar.

XHILDA TOSKA, PRODUCENTJA QË Mbledh në Evente Gratë nga Shqipëria dhe Kosova

Nga Albana Barçi, Tiranë

Cdokush e njeh tashmë producenten nga Elbasani, zonjën e nderuar Xhilda Toska, e cila me zemërgjerësinë dhe mirësinë që e karakterizon mbledh në evente gratë nga Shqipëria dhe Kosova. Disa nga këto evente janë “Miss Mama”, që u organizua në ambientet e teatrit “Skampa”, në qytetin e Elbasanit, spektakli “Retro”, që u zhvillua në Odeonin e Pogradecit, konferenca e realizuar në kuadër të “Tetorit Rozë” me gra nga Shqipëria, Kosova dhe nga diaspora, që u organizua në ambientet e “Grand Blue Fafa Resort” etj. Në “Miss Mama” merrnin pjesë gra nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, jeta e të cilave ka qenë e mbushur me sfida, me dhimbje dhe grimca lumturie. Zonjat pjesëmarrëse performuan me veshje të ndryshme të përgatitura nga stilistë profesionistë. Gjithashtu kishte edhe mesazhe sensibilizuese nga vetë pjesëmarrëset në këtë event.

Qëllimi i spektaklit “Retro” ishte tu jepte të rinjve informacione si visheshin femrat shqiptare në vitet e errëta të diktaturës, rreth viteve 70-të. Veç veshjeve të krijuara nga vetë të rinjtë që sfiluan kishte edhe interpretime të këngëve të atyre viteve. Risia e këtij eventi qëndron në faktin se mblodhi këngët e atyre viteve nëpërmjet interpretimit të talenteve të reja. Qëllimi i eventit ishte promovimi i këtyre talenteve dhe nxitja për të vijuar më tej. Performancën më të mirë e bëri Armela Kosta, e cila imitoi këngëtarën Tina Turner në këngën “Wats love got to do with it”. Ajluna Meka këndoi këngën “Zemrën nuk ta



fal”, duke imituar këngëtarën kosovare Adelina Ismaili. Albana Barçi solli në “Retro” një kolazh me këngë të Anita Takes. Mbresa të shikuesit lanë edhe sozitë e këngëtareve Brigitte Bardo, Marilyn Monroe, Nexhmie Pagarusha, Raffaella Carra, Shakira etj.

Event tjetër ka qenë ai që u zhvillua në ambientet e “Swiss Hotel” në Durrës me zonja nga Kosova dhe Shqipëria. Me interes për publikun ishte si kërcente rinia shqiptare e viteve 90-të. Në këtë event pati edhe veshje kreative nga vetë të rinjtë. Ata sollën në sfilatë rreth njëzetë paruke cilësore, të cilat iu dhuruan atyre grave që trajtohen me kimioterapi dhe kanë mungesë të flokëve. Mbresëlënëse është edhe konferenca e realizuar në kuadër të “Tetorit Rozë” me gra

nga Shqipëria, Kosova dhe nga diaspora, që u organizua në ambientet e “Grand Blue Fafa Resort”. Kjo ishte një konferencë sensibilizuese për gratë pjesëmarrëse me anë të informacioneve të ndryshme për shkaqet dhe masat parandaluese kundër kancerit të gjirit.

Në një intervistë ajo rrëfen: “Po mendoj për nënat shqiptare, për gratë shqiptare që kanë qenë të mohuara dhe të ndaluara, sepse dihet që Shqipëria ka qenë pjesë e fanatizmit. Gruas shqiptare i është mohuar e drejta të shijojë veshjen për shkak të fanatizmit, të shijojë skenat dhe gjithçka tjetër, duke qenë pjesë e paragjyqimeve. N.q.s. kemi ndryshuar paksa eja ti japim gruas atë që i ka munguar, sidomos kjo gjeneratë moshash që unë jam duke

punuar me eventet që sjell. Në dukje duket e vështirë që këto moshë nuk i bashkohen eventeve, por në fakt këto janë më të eturat për të qenë pjesë e eventeve. Nëse shohim gratë e eventeve që unë zhvilloj kryesisht janë të moshave 50-60 vjeçare”. Ndër të tjera Xhilda tregon për nismën që ka strukturuar dy vite më parë dhe pritshmëritë nuk qenë at të larta, por ndonjëherë e bukura vjen kur sakrifikon. Ajo me sinqeritet tregon: “Nisa para dy vitesh një event, i cili erdhi për herë të parë në trojet shqiptare.

Unë mendova të sjell gruan në skenë për të përcjellë bukurinë shumëdimensionale, jo vetëm atë fizike, sepse gruaja ka bukurinë e shpirtit, bukurinë e forcës së saj etj. Dhe i gjeta tek këto gra në skenën e teatrit “Skampa” të Elbasanit, qyteti ku unë jetoj. Ishin gra nga Kosova, nga Shqipëria, nga diaspora, të cilat sfiluan në skenë para publikut me veshje të ndryshme dhe njera prej tyre fotoi kurorën Miss Mama. Gratë e Kosovës kanë qenë të pranishme në organizimet tona. Herë pas here unë i organizoj këto gra, jo vetëm për tu argëtuar, por edhe për kauza të ndryshme siç ishte Tetorit Rozë ku organizuam një konferencë informuese kundër kancerit të gjirit. Eventi i radhës do të jetë Miss Mama më 8 mars 2025, në ditën ndërkombëtare të gruas”.

Xhilda Toska punon me pasion dhe është pikërisht pasioni që ka për punën ai që e bën të kapërcejë të gjitha vështirësitë. Ajo menaxhon agjensinë e spektakleve “Event Modeling Produktion” dhe zhvillon evente të ndryshme në Shqipëri dhe në Kosovë.

POETIKA LIRIKE E POETIT USHTARAK, MBI SERINË E ZGJEDHUR, “VEPRA LETRARE 1- 8” E POETIT VLONJAT, LUFTAR PETOSHATI

Nga Egerem Canaj - Vlore
- Shkrimtar -

Luftar Petoshati ka lindur në vitin 1935, në fshatin Dukat, me banim në qytetin e Vlorës. Ka kryer studimet e larta në Akademië Ushtarake, si dhe Universitetin e Tiranës, në degën historio – gjeografi. Ka shërbyer në ushtri, oficer i lartë, tashmë, pensionist. Ka botuar qysh në moshën 25 vjeçare, si: “Kujtmet e Tokës” në vitin 1955, duke realizuar, gjer më tash, mbi 15 libra të botuara, artikuj kritikë e reportazhe, tregime dhe vëllime poetike, ca më shumtë, ku, krijimtaria poetike e të cilit, është e përmbledhur në serinë e zgjedhur, veptra letrare 1 – 8. Vëllimet poetike të autorit L. Petoshati, paraqesin një botë të panjohur, madje, mjaft të çuditshme dhe interesante të tij, çka dëfton rrjedhshmërinë poetike në harkun kohor rreth mbi gjashtëdhjetë vjetësh. Dhe, duke mos harruar faktin tjetër, s’kemi të bëjmë me një shkrimtar profesionist, po me një ushtarak, “Komandant i Njësisë së Tankeve”, që detyrat ndërkohore e kanë bërë reflektiv, sipas situatave e dramave kohore, t’i bjerë tokës shqiptare nga rrahu në rrah, e prapë, ai është marrë edhe me poezi. Sipas këtyre gjasave, vetëdija poetike e autorit, pse jo, shkon – udhëton, drejt profesionalizmit poetik.

Petoshatin e kam njohur në fushën e letërsisë, atje ku provohen penat e ndritura shqiptare, si në: “Almanak letrar” 1985, “Nënës”, vëllim me lirika, 1997, “Maliq Muço”, 2014... Pra, tek poeti ynë zbulohet vijueshmëria poetike si veçori individuale, një burim shpirtëror si burim i malit, që nuk shtreron kurrë. I tillë shfaqet Petoshati në vëllimin 1, 2, 3... të serisë poetike në fjalë. Vëllimet poetike janë ndarë në “Lirika”, “Erotika” dhe “Epika”, ku pjesët përbëjnë trungun e njëjtë të veprës, por me veçori të veta, si njësi e së tërës. Dhe kjo ka të bëjë me mençurinë poetike të autorit, i cili, kësajqë mendon se trasmeton më mirë e më qartë mesazhet domethënëse të lexuesit. “Filozofia e jetës” sipas autorit duket si prologu i veprës seriale nga 1 – 8, çka duket disi e çuditshme, por një realitet që nuk pranon kundërshtime. Vëllimi hapet me rreth 10 poezi, me stil bashkëkohor, të cilat bëjnë me dije synimin e objektit të autorit. Janë poezi jete, përmes të cilave zbrërthehet filozofia e jetës së dinamikës së patriotit, si: “I dua kujtimet/ nga koka gjer në thua/ ashtu, siç jeta/ më ka dashur mua”, te poezia “Kujtmet”. Po ashtu, tek poezia “Burri”, “burri fjalën e ka fjalë/ troç e thotë atë shkurtër/ dhe ai që del si ngjalë/ apo, ndryshe, kulpër/ këta s’janë burra radhe”.

“Erotika”, poeti i dhënë pas erotikës, besoj, në moshën e adoleshencës, në këtë vëllim ai i këndon dashurisë universale, e cila qëndron në jetën e njeriut si forcë lëvizëse, pa dashuri s’ka jetë, jeta pa dashuri është baltë.

Qysh në fillim: stili poetik i Petoshatit të kujton D. Agollin, pa vënë vija paralele, kjo ka të bëjë me përzgjedhjen, idhullin... Paçka, Petoshati në thelbin e krijimtarisë poetike, ka elementin popullor, ashtu siç edhe bashkëkombasit shqiptarë të kohës. Si dëshmitar i bregut, malit dhe detit, ky bir vlonjat, autor zë kumbues i lirikave të veprës së zgjedhur, zoti Luftar Petoshati, poet i mbujtur me ndjesi të theksuar të patriotizmit shqiptarë, emocionalisht, atë e rrëmben vendlindja, madhështia e burrave të thjeshtë, të heshtur, gojëmjaltë e të tërbuar po aq, kur binte fjala për nderin, ndershmërinë, burrërinë e karakterin e labit të paepur në dejtëm të çështjeve madhore të kohës. Petoshati, poet popullor i kësaj vepre, hap pas hapi, na shfaqet, pra reflekton përmes veprës gjithë larushmërinë e ngjyrave të kohës, sepse, me vargjet e ashpër të veprës, ai paraqet njeriun epik dhe lirik njëkohësisht, përpos asaj ka përshkruar jetën sa në gjerësi, në thellësi, po aq.

Në këtë mënyrë, autori bëhet reflektiv në jetë, përshkruet dhe tundues i ideve të veprës drejtimit lexuesve artdashës. Mendoj, kjo është edhe arsyeja, pse poeti ka shumë fansa: ai mendon, shkruan gjer në lodhje për jetën, hallet, dukuritë e jetës, duke përshkruar, ashtu popullorçë, tipa dhe karaktere njerëzore.

Thotë poeti ... “Duket se kam jetuar/ rritur, burrëruar/ nxitur e shkolluar/ gjithandëj kam punuar/ kodet realizuar”, tek poezia “Jeta”... Ajo çka spikatet në tërësi, është konceptimi filozofik i jetës së njeriut në jetëgjatësinë e vet: njeriu, liria dhe kodet transformuese të shoqërisë njerëzore. Pra, nga kjo anë poeti Petoshati nuk paraqitet vetëm si përshkruar i thjeshtë, realist, i kuq, blu apo gri, por përshkrimi estetik përmes epitetëve,

metaforave e shprehjeve filozofike, kalon mes një analize të thellë psikologjike, nga ku, edhe shquhet qëndrimi kritik i autori për mangësitë, të ligjtë, tradhëtarët, gënjeshtarët, imoralët... pak a shumë ai përpiqet që, kësajqë, të realizojë ballafaqimin njerëzor në individë a grupe të tillës... “Ç’u këput një këmbë mali/ gurgullon në hungërim kënga/ për mua mali besim fali/ malit të madh i duhet këmba/ ndaj malit përjetë iu gjenda./ me besë burrash”, tek poezia “Besë burri”... Besa e burrit për shqiptarët në shekuj është një nga virtytet më të lashta e më e spikatura, metaforat karakterizuese, jo vetëm i



Poeti vlonjat Luftar Petoshati

japin bukuri lëndës poetike, por edhe trasmetojnë mesazhe parësore. Në këtë vepër, dinamizmi poetik i autorit, si elemen i stilit autentik lab, bie dukshëm në sy, çka lexuesit i ndjell kënaqësi emocionale përgjatë leximit të veprës letrare. Dhe autori bëhet, sa figurë reale, po aq edhe interesant mes poetësh bashkëkohorë. Petoshati zotëron bukur mjaft elemente të karakterizimit të figurave popullore, nga ana tjetër ai paraqitet si zbulues dhe interpretues i mirëfilltë i elementit popullor në poezi, tek poezia erotike, ai shkruan ... “Fat për mua moj ftujake (vajzës)/ si të kishin varur zile (ergjendë) ti ishe rritur bonjake/ por malet të dhanë hire/ të qafosa, mallin nxire...”, poezia “Ftujake”. Lexuesi, tërësisht, është i prirur, si kureshtar, të lexojë ato që nuk di, të kuptojë e reagojë si genie aktive në jetë, por edhe të freskojë kujtesën, të emocionohet apo të ekzaltohet nga e kaluara e harruar ... Dhe këtë Luftar Petoshati, autori i serisë së zgjedhur, e realizon suksesshëm. Këto e të tjera veçori stilistike, përshkruar me lirshmëri, plot patos e dramacitet bashkëkohor, do t’i zbuloni tek “Lirikat” e poetit vlonjat, pa nënkuptuar se keni të bëni me një poet modern, por një poet tuajin dashamirës, sikur të jeni vetë ju.

Poeti vlonjat, z. Luftar Petoshati, i cili gjithë krijimtarinë letrare të tij, krijuar në hartën e nëntëdhjetë viteve, ka gjetur momentin e sistemit të lëndës në veprën e plotë letrare në disa seri. Tashmë, pasi ka botuar suksesshëm seritë e para paraqitet para lexuesit dashamirës dhe miq të autorit me seritë pasuese duke vazhduar sërish logjikën e botimeve të lirikave interesante të poetit, ish ushtaraku i lartë, icili, me zhdërvjelltësi, kohë pas kohe, ka hedhur në letër mbresa e kujtime, me art, pra filozofia e jetës së tij, dhe shoqërisë ndërkohore njëkohësisht, është shkrirë apo, mjeshtërisht, ai ka ditur ta shndërrojë në filozofinë poetike, përmes lirikave “bombë e flamur”. Vëllimi 3 përmbledh mbi 100 poezi dhe 4 poema, çka mbyllet me poemën e gjatë dhe më të arrirë “Ushtari legjendar”... Kjo poemë dhe, tërësisht veptra 3, përshkohet nga ideja: shqiptari patriot lind, i del zot atdheut dhe vdes si ushtar besnik e legjendar i atdheut e kombit të tij. Ndërsa shqiptari ndër kohëra ka jetuar e luftuar me mjegulla trazimtare armiqsh, veptra e Petoshatit tej e fund trasmeton mesazhin kuptimplotë, jeto për atdheut dhe vdis për të! Veptra e cilësuar “Lirika poetike”, pse në raportin e të veçantës me tërësinë, gati 80 % të vëllimit mbisundojnë poezi të bukura lirike çka prushërojnë shpirtin poetik të autorit, si dhe lexuesit pasionant për letërsi bashkëkohore, paçka se autori luhatet midis poezisë popullore dhe asaj klasike, kjo për arsyen e thjeshtë, ekzistencën e jetës së vetë autorit mbi bazamentin e traditës, e cila në kohën e vet lulëzoi mrekullueshëm. Poeti ynë, L. Petoshati, e pasuron vëllimin me poezinë e shkurtër “Njeriu i ri” ...

“Sytë i ka det në ngjyrë e madhësi/ sytë, mendjen

në duar i ka shtrirë/ ... net të tëra në punë i ka shkrirë/ më të mirën e botës për të arrirë/ ... Ky është njeriu ynë i ri/ epokën përpara do e prijë/” (me shkurtime). Sekretet e autorit janë zbuluar tashmë: ai pikturon mirë e bukur jetën e shqiptarit ideal, të cilin nuk e ka lindur e rritur një nënë, por gjithë nënat shqiptare, Nëna Shqipëri, e cila nuk ushqehet vetëm nga hekuri i shpatës, nuk ngopet vetëm me plumba (ato kur t’ia kërkojë nevoja), por duhej bukë, shkollim, kulturë, zgjuarësi, se trimëria s’ka kuptim pa zgjuarësinë, duhej ngritur e kalitur një brez i atillë që t’i dilte zot fateve të atdheut në përballjen e vazhdueshme me botën: një i tillë, si Enver Hoxha, apo Partia Komuniste Shqiptare, për autorin mbeten idhuj dhe dobësi të prekshme. Pranueshëm, poeti ynë, bir dukatas, me një karakter labi të fortë e i pathyeshëm ruan nostalgji, por di edhe ta gjykojë kohën. Në mjaft poezi, ku përshkruan zinxhirin e gjatë të jetë, ai motivon, konkludon e paraprinë progresin bashkëkohor. Pa përmendur mangësitë, të cilat janë bashkudhëtare të çdo autori, veptra në fjalë, e poetit Luftar Petoshati, është pasqyrë e një realiteti të brishtë, e cila të rrëmben për ta lexuar me interesim e ëndje. Prej poetit bashkëkohor, Luftar Petoshati, ish ushtarak i lartë, vetëdija e lexuesit ndër breza do të zbulojë talentin poetik të autorit në fjalë, i cili, si ushtar i devotë i atdheut të tij, i ka dhuruar me dashuri e patos atdhetar, atdheut, bashkudhëtarëve thesarin e vet të artit poetik. Duke e vështruar krijimtarinë e tij letrare në këtë sens, arrin të kuptosh mirëfilli se njeriu i epokës së pasluftës, gjer në ditët e sotme të demokracisë së vështirë, ka qenë edhe ushtar, edhe student, edhe patriot i flaktë, edhe politikan, edhe kooperativist, edhe, edhe ... Poet. Pra ka qenë e mbetur njeri me njohuri e zhdërvjelltësi bashkëkohore, thënë ndryshe, zemra e tij ka rrahur gjithëherët me pulsën e zemrës së madhe të atdheut. Mendoj, kjo është shfaqja më konkrete e njeriut të duhur me: shkollim solid, i përkushtuar, gjer në vetmohim, i papajtueshëm me ligësitë e ligantët, kurthet, mashtrimet, gënjeshtarë e gënjeshtarët, hajdutët, intrigantët, llafazanët, thashethemexhinjtë, imoralët e idiotët...

Pikërisht, këto gjetje morale, etike, atdhetare, patriotike të tij, në raportet individ – shoqëri – shtet përmban lëndën e plotë “Veptra letrare 4, 5, ... 6 ... 8” e poetit tradicional, Luftar Petoshatit. Kemi të bëjmë me një seri poetike të plotë, mbushur me jetë njerëzorësh, tipa e karaktere të ndryshme. që pazgjidhshmërisht, janë objekt dhe subjekt të politikës, atdheut, ushtrisë, shkollës, të ekonomisë socialiste dhe asaj pasocialiste, të ndërrim sistemit, gjer në imëti, kjo, pasqyra e plotë e jetës shqiptare, e cila zë një hark kohor të mjaftueshëm, derdher në veprën në fjalë, rreth 70 poezi, si dhe 4 poema, duke e mbyllur me poemën më të gjatë “Vrulli i epokës së re”, të cilën edhe mund ta quash autobiografia e popullit shqiptar në vargje. Duke përmendur këtë formulim, s’është e thënë të nënkuptojmë se autori në fjalë është Kadareja a idhujt e tjerë poetë shqiptar, por, si ata, bashkëkohor i të cilëve, poeti ynë, Luftar Petoshati, me mënyrën e vet, stilin e vet, folklorizimin e vet e ka paraqitur atdheut e tij brenda opusit të vështirimit të tij poetik, me mjetet shprehëse përkatëse: frazeologjinë, metaforën, epitetet e shumta dhe hipërbolën, veçanërisht, gjuhën e komunikimit, ku të kujton njeriun popullor, ulur këmbëkryq me bashkatdhetarët, si një urtak, i cili shtrun në kuvend hallet e atdheut e dialogun me togun e burrave, shtron “direktivat nga lart” apo ngarkon mbi shpinë thesin me halle për ta zbratur diku, atje ku fjala e burrit zë vend...

P.S: poema e plotë “Vrulli i epokës së re”, është jo vetëm një punim i lodhshëm i autorit, por, si një realizim i rrallë në poetikën bashkëqytetare, brendësia lëndore – jetësore e saj të shpie larg, të kujton Ostrovskin me “Si u kalit çeliku”, kuptojmë pas këtij konceptimi se poeti ynë dhe gjithë brezi i kohës, kanë qenë dëshmitarë e gjallë, jo të përfytyruar, një brez që u kalit mjaftueshëm në kudhërën e revolucionit: u ndesh me shumë gjasa kombëtare, u vu në prova të rënda, u mashtrua keqani, duroi dhe përballoi njëkohësisht, pra sfidoi politikën, luftoi për jetë më të mirë. Dhe paqe për njerëzimin. Këto ide do t’i gjeni, të shtjelluar e analizuar bukur përgjatë veprës letrare të plotë të poetit L. Petoshatit. Luftar Petoshati, ky bard i poezisë klasike, pas studimit të plotë të krijimtarisë letrare poetike, përmes veptrave 1 – 8, tashmë shfaqet, me portretin e qartë dhe admirues njëherazi, një poet lirik dhe epik i mirëformuar,

suksesi i të cilit duhet nënvizuar si një shembull, jo vetëm për individualitetin poetik, por edhe si një kontribut i veçantë në poezinë qytetare vlonjate e më gjerë. Në veprat pararendëse për Petoshatin është përdorur kryesisht termi “popullor” dhe herë “klasik”, sigurisht, dy citimet e mësipërme janë dhe mbeten dukuri të shfaqjes poetike të autorit, përgjatë serisë përshkruese të veprave, do të kuptohen mirëfilli disa caqe interesante të lëvizjes së portretit, ku përfshinë përmasat hapësirë – kohë. Shoqëria njerëzore shqiptare ajo pas viteve ’30 ka lëvizur çuditërisht, ku epokat përndoqën njëra – tjetrën, duke u ndryshuar cilësisht njeriun dhe marrëdhëniet në prodhim, individit dhe shoqëria, epokat e sistemit deri tash. Pra, ndryshoi njeriu, ndërgjegjja e krijuesit në perceptimin e objekteve, poezia u mbars me ngjyrën politike, si dhe u zhvillua, hap pas hapi, në ndryshim të vazhdueshëm, si edhe vetë njeriu, ndërgjegjja krijuese mori trajta e forma të reja dinamike në metrikë, në ngjyrimet poetike, figuracion dhe intesitein e mesazheve, çka lidhet me raportet individuale të poetit me lexuesin. Këtë zhvillim progresi e reflekton edhe krijimtaria poetike e lirikut dhe epik e L. Petoshatit nga veptra 1 – 8. Sjellim për argument, vëllimin poetik “Nëna”, botim i vitit 1977, krahasuar me poemën madhore “Nëna” e vitit 2020 kanë tjetër frymëmarrje, figuracion, metrikë... ose, krahasuar me botimin sadisfacionues “Thirrja e gjakut” nga “Ditari i Vlorës së përgjakur” 1977 dhe ripunimi i vitit 2022, ndryshimet sasiore dhe cilësore janë të dukshme, gati të habitshme. Ky poet shfaqet kërkuks nga koha në kohë. E rëndësishme është të theksojmë se autori në fjalë dialektikisht, duke ecur me hapin e kohës, ka provuar zhvillimin pasues: nga poet popullor (vjershëtor kryesisht), në poezinë klasike, drejt modernizimit bashkëkohor. Mendoj, ai tashmë është i pajisur sa me dije, kulturë, si dhe vendosmëri përkushtimi, pasi për ditë udhëhiqet nga motivi se ç’mund të bëjë më tej në shërbim të shoqërisë së kohës. Në veprën poetike të Petoshatit bën dukuri edhe poema “Vlora ‘97”... Duke e lexuar, të kujton, ndër të tjerë, poetin Luan Qafëzezin me veprën “Internacionale”... Luftar S. Petoshati, ky zë i fuqishëm, që jeton në Vlorë, mbetet personazhi i ditës në lëmin poetik, i cili po shfaqet i suksesshëm nga veptra në vepër.

Poeti bashkëkohor, Luftar Petoshati, paraqitet çuditërisht me kolanën e veprës së plotë letrare, kryesisht poezi lirike – epike njëherësh, brenda vitit 2022, një pasuri interesante e mbartur ndër vitesh, ku ai ka milituar gjatë në radhët e ushtrisë popullore të viteve të diktaturës, duke e vazhduar ritin si aktivist i shquar në qytetin e tij. Përmendet ky fakt për të ravijëzuar qartë portretin moral të autorit, L. Petoshati, i cili ka qenë dhe reflekton edhe tash përgjatë kolanës së plotë letrare, me veprat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, një njeri i besueshëm, i partishëm dhe atdhetar i pashoq... Ndërsa, në veprën 7 “Shqipëria në rrjedhat e kohës”, ese, krahas kolanës poetike në këtë vepër, autori në fjalë, shfaqet me dukurinë e një tjetër lloji: kemi të bëjmë me një studiues të zërrlshëm të historisë së Shqipërisë, pasqyrim faktik, i cili shfaqet përmes “Para erës sonë”, “Era jonë”, “Rilindja”, “Pavarësia”, “Lufta çlirimtare”, “Paslufta” dhe “Shqipëria në rrjedhat e kohës”. E vlerësojmë këtë paraqitje estetike të autorit, Petoshati, si një gjedhje e bukur dhe e rëndësishme njëkohësisht, një dokument në shërbim të lërxuesve të shumtë, të studentëve apo masës së komunitetit për më shumë njohuri, dije shkencore, historike, ku pajisen me fakte të qarta, data e ngjarje, kësajqë, esetë në fjalë, edhe pse janë tejet historike, sipas shtjellimit që ka bërë autori, luajnë rol formues të padiskutueshëm në memorien kombëtare. Vëmë re, njëkohësisht, se si mjeshtër ai katreguar vëmendje anës estetike të veprës, krahas asaj shkencore, pra dijet i ka paraqitur mirësisht në kapitujt përkatës, me qëllim që të tërheqë vëmendjen tek anët esenciale të ngjarjeve, të nënvizojë a të thellohet, sipas nevojës a arsyes, në këtë anë, autori është treguar erudit dhe ekzigjent njëkohësisht, kjo kuptohet nga detyra që ia ka ngarkuar vetes dhe qëllimi të madh, të cilit i përkushtohet: edukimit atdhetar e patriotik të brezit të ri e popullit, gjithashtu, si bir i popullit ushtar. Autori, Luftar Petoshati, përbën portretin e poetit tipik lab, bashkëkohës i lirikut Ali Asllani dhe poetit patriot D. Agollit e tjerë, jo më në arritjet cilësore, po në mesazhet që, aq logjikshëm, përcjell, mbetet, pa përjashtim, një shembull interesant dhe admirues njëkohësisht, edhe në letërsinë bashkëkohore të viteve të demokracisë.

Në mërgim besa, fjala e dhënë, mbetet gjithmonë një koncept kulturor

Nga Petrit R Aliaj - BRESCIA

Besa, fjala e dhënë, mbetet gjithmonë një koncept kulturor për të cilin populli ynë është shprehur mjaft bukur dhe saktë se "ku është besa është edhe shpresa". Dhe një shpresë të tillë e ngjalli stafi i shoqatës "Krenaria Shqiptare", i mbështetur si kurdoherë në të gjitha shkollat nga ëngjëjt e gjuhës shqipe. Të tillë janë edhe mësueset Mimoza Bixheku, Donika Gjoka dhe mësuesi veteran Avni Mehmeti, që falë angazhimit të tyre e kthyen në ditë feste këtë takim me pjesëmarrjen e prindërve, bashkëatdhetarëve tanë si edhe fëmijëve, të cilët thërrisin njeri - tjetrin e salla gumëzhinte nga bisedat e tyre.

Çuditërisht të gjitha bisedat ishin në gjuhën shqipe, përfshirë edhe një vajzë të vogël e shoqëruar nga nëna e saj italiane. Është kënaqësia e mirëkuptimit dhe integritetit të ndërsjelltë kur prindërit merren vesh me fëmijët e tyre. Pasi në këto raste ndihmon edhe atmosfera e takimit të vogëlshëm, me biseda pafund midis tyre. Se sa vlera kanë për fëmijët këto takime dhe të mësuarit e gjuhës së mëmës, pse jo edhe gjuhën e origjinës së babait, kur çiftet nuk kanë një prejardhje, mbetet një investim për të gjithë fëmijët. Me krenari dhe me të drejtë themi se kudo mësuesit janë njerëzit që sakrifikojnë, e shmangin lodhjen me durim dhe me këmbëngulje e dashuri, i përkushtohen profesionit të tyre të nderuar dhe aspak të lehtë për mësimdhënësit në diasporë. Shpesh herë ata ftohen në seminare e konferenca dhe mirë bëjnë, pasi u jepet rasti të takohen me kolegë të së njëjtë ideal dhe nga trajnuesit u rekomandohet zbatimi i programeve, të bëjnë kujdes se roli i tyre është ashtu e kështu, pa harruar edhe për punën bindëse, që duhet të bëjnë me nënat për



frekuentimin e nxënësve. Pra qartësisht kësaj mase të madhe vullnetarësh të angazhuar në diasporë u ka munguar realizimi i një konference ,simpoziumi ekonomik apo seminar tregues që t'i dedikohet shpenzimeve personale që bën çdo mësues vullnetar për të gjithë vitet në këto shkolla, për t'u mundësuar minimalisht një vlerë, një vlerësim në nder të tyre të përcaktuar në buxhetin e shtetit. Pothuajse jemi kthyer në kohën e Migjenit, i cili me trashën e librave në dorë dhe mbi një biçikletë, shkonte çdo ditë me diell apo me shi, t'u mësonte vocrrakëve të tij gjuhën shqipe. Jemi të humbur në kohë dhe në një dalje pa krye, të përçmimit ndaj mësuesve atdhetarë, të cilët e vendosin gjuhën tonë të bukur të parën që duhet zhvilluar, trashëguar e ruajtur atë, identitetin tonë kombëtar.

Shkolla "Besa" i hapi dyert e saj në datën 16 nëntor 2024, në mjedisin e dhënë tek "Casa

dello Studente" komuna Azzano Decimo, në provincën Pordenone me një seri masash sensibilizuese, me takime veprimtarësh e prindër si edhe me publikime në rrjetet sociale, për të pasur sa më shumë pjesëmarrje e nxënës. Presidenti i kësaj shoqate z. Ndrim Kercuku, prej kohës kishte kontaktuar presidencën e Federatës së Shoqatave Shqiptare (FNAI), për hapjen e kësaj shkolle, si edhe kishte kontaktuar direkt me dr. Luljeta Cobanaj, oficere e Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë për Diasporën pranë Konsullatës së Përgjithshme në Milano. Zonja Cobanaj arriti në kohë ti siguronte librat për dy shkolla për faktin se këtë ditë do të vinte në ceremoninë e hapjes së shkollës "Besa" vetë presidenti i shoqatës "Vatra" z. Dritan Ferhati së bashku me stafin e tij. Me këtë rast z. Ferhati së bashku me urimet e tij ai i ftoi të gjithë në festën e flamurit në datën 28

nëntor në Ravena. Me këtë rast dua të përmend edhe Arditin (ish president i org. InterAction), i cili mori në dorëzim librat në konsullatë për të dyja shkollat. Sëbashku me Arditin ishte edhe i papërtuari mësuesi, atdhetari dhe zëdhënësi i Federatës "FNAI", prof. Ndue Shabaku, i cili në përshëndetjen e tij lavdëroi ata që mendojnë, punojnë dhe sakrifikojnë për të arritur një rezultat si ky që ne po e përjetojmë në sallë sot. Jashtë në korridor dhe brenda në sallën ku do të zhvillohej ceremonia e përvitimit të shkollës dhe dorëzimit të librave, një dorë e kujdesshme kishte menduar që në plan të parë të ishte dekorimi në ballë me shqiponjën dykrenare, tavolinën e zbkuruar me librat e rreshtuar mbi të, gati për t'u shpërndarë si edhe për vendosjen e fëmijëve dhe prindërve në bankat e shkollës së tyre të ardhshme.

Mbizotëruan përshëndetjet e shumta. Për kënaqësinë e prindërve që falenderonin dhe pozonin së bashku me fëmijët, mendoi fotografi i ri, Florian Fusha. Ceremoninë e hapi drejtuesja e kësaj dite festive të shumëpritur, sekretarja Shoqatës, zj. Elvana Fortuzi, e cila u kalonte radhën për të përshëndetur të ftuarve, kolegëve, prindërve dhe recitimeve që disa vogëlushë i kishin përgatitur për të recituar përpara bashkëmohatarëve të tyre.

Me këtë rast përshëndeti edhe zj. Lumturi Fortuzi si shkrimtare, poete, piktoe, por edhe më e moshuara e këtij takimi. Fjala e mësuesve u duartrokoi pa masë edhe nga vogëlushët, të cilët me kërshtëri i shikonin ata që do t'u mësonin shkronjat e para. Me shumë dashuri dhe respekt në përshëndetjen time falënderova të gjithë ata që kishin mbushur sallën: prindër, mësues, aktivistë të ftuar dhe organizatorët me urimin për suksese në vazhdimësi e begati në familjet e tyre

Tetori, si gjithherë një muaj që bashkon artistët

Nga Skender Lazaj - Bologna

Tetori, si gjithherë, e gjen Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Itali, të angazhuar me veprimtari. Për gjashtë edicione është zhvilluar aktiviteti i pagëzuar "Fjalët e Shpirtit" dhe këtë vit "Il richiamo delle muse" (Thirrja e Muzave), për herë të parë, u zhvillua në Abruzzo dhe pikërisht në kështjellën Sterlich Alipardi, me një histori mbresëlënëse mijëvjeçare, në komunën Nocciano, Pescara. Aktivitetin "Thirrja e Muzave", të Lidhjes së Shkrimtarëve, e organizoi tërësisht Zëvendës-presidentja e Lidhjes, shkrimtarja dhe poetja Mimoza Leskaj, me mbështetjen (patrocinio) e Rajonit të Abruzzo si dhe komunës Nocciano. Në aktivitet morën pjesë, përveç artistëve shqiptarë me banim në atë zonë edhe të ardhur nga Calabria, Napoli, Brescia, si dhe artistë dhe artdashës italianë. Patëm nderin të kishim të pranishëm dhe Kryetarin e Komunës Nocciano, z. Marcello Luciano Giordano, si dhe deputetin e zonës, z. Luciano D'Alfonso. Komuniteti arbëresh i Villa Badessa me presidente Anna Maria Passeri, me të cilët një ditë më parë patëm fatin dhe nderin të takoheshim dhe të vizitonim komunitetin e tyre, një vizite mbresëlënëse, kulturore dhe historike, në kishën Santa Maria Assunta ose Shën Mëria Theo-Toka, e cila gjendet në Villa Badessa, fraksion i komunës Rosciano, themeluar në shekullin e 18, saktësisht në vitin 1743, prej regjimentit shqiptar të përbërë prej 18 ushtarakësh me kapiten Kostandin Blashi e Giovanin Pali, me origjinë nga Piqerasi dhe rrethinat, me ftesë të mbretit të Napolit, Carlo di Borbone, për shërbimet e tyre në ushtrinë e mbretit.

Aty na pritën pesë zonja, trashëgimtare të 18 familjeve shqiptare. Zonja Anna Maria Passeri rrefeu për një histori të ndodhur midis 18 ushtarakëve shqiptarë, ku i kërkohet mbretit Borbone të bënte të mundur ardhjen e familjeve të tyre, duke dhënë dorëheqjen nga pagat. Pasi



mbreti e miratoi, familjet e tyre, të shoqëruara nga prifti Macario Nika e Demetrio Atanasio, mbërritën në Villa Badessa. Në një moment të dytë ata dërguan përfaqësues në Piqeras, për të marrë ikonën Odigritia nga Manastiri i Kremesove. Për gati tre shekuj, komuniteti në fjalë ka ruajtur me fanatizëm zakonet, doket, virtytin e mikpritjes si dhe kostumet popullore shqiptare. Vizitua dhe muzeun e tyre modest, por tejet të vlerët, ku shpërfaqeshin krenarisht dhe kostumet shqiptare të shekullit të 18-të si dhe një pllakat ku binin në sy fjalët shqip. Na nderuan me pjesëmarrjen e tyre një përfaqësi e Shoqatës "Misioni për vazhdimësi" prej gjashtë

anëtarësh, z. Blendi Gremi, Drejtor i Kulturës Rajonale Elbasan, z. Artur Guni, Xhimi Vila, Petrit Ibro, Albert Shopi, Petrit Hodo, të ardhur enkas nga qyteti i Elbasanit për aktivitetin. Ishin edhe piktorët e talentuar Nikolla Rama dhe Anila Ciccone. Aktiviteti i parapriu një vizite në ambientet e komunës Nocciano, me kërkesë të Kryetarit të Komunës, ku na u dha mundësia e njohjes nga afër me historikun e saj si dhe premtimin për bashkëpunim në të ardhmen. Sipari i aktivitetit, filloi natyrisht me himnet kombëtare italiane e shqiptare dhe menjëherë nikoqirja e aktivitetit, poetja dhe shkrimtarja, njëherësh dhe Zëvendës-presidentja e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Itali, u ngjiti në skenë mes duartrokitjesh dhe atmosferës së magjisë së tingujve muzikorë të interpretuar nga artistet shqiptare; pianistja e talentuar Luljeta Papanisto, violinistja virtuozë Xhoana Askushaj dhe zëri vokal gati hyjnor i këngëtares lirike Yllka Gero, të cilat na dhuruan emocione dhe ndjenja krenarie të papërshkrueshme për gati tre orë.

Pasi falënderoi pjesëmarrësit, prezantuesja Mimoza Leskaj si dhe Sekretarja e Lidhjes Lori Duka, ftuan në skenë të zotët e shtëpisë, Kryetarin e Komunës Nocciano, zotin Marcello Luciano Giordano, deputetin zotin Luciano D'Alfonso, përfaqësuesit e komunitetit arbëresh të Villa Badessa, të cilët u prezantuan me kostumet tradicionale shqiptare, pas tyre

përfaqësuesit e "Misionit për Vazhdimësi" si dhe z. Skender Lazaj, Presidenti Lidhjes. Pasi morën fjalën e rastit, dhuruan mes tyre, në shenjë mirënjohjeje dhe bashkëpunimi, simbole, emblema, vepra letrare si dhe peizazhe në pikturë. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Itali i dhuroi një pikturë komunës Nocciano, të piktorit tonë të talentuar, anëtar i Lidhjes Faik Skopeci, si dhe vepra letrare të anëtarëve tanë, mes tyre dhe Antologjinë e dytë të Lidhjes sonë, realizuar me autorë shqiptarë në Itali. Aktiviteti vazhdoi me autorët Lili Kristuli shkrimtare, Francesca Gallelo, gazetare dhe shkrimtare italiane, Griselda Doka poete dhe përkthyes, Elsa Cenaj, poete, Juliana Mehmeti, poete, Nikolla Rama, piktor, si dhe piktori Dashmir Gurabardhi, i cili kishte ardhur nga SHBA. Ata folën për artin e tyre, sfidat e kohës moderne, arritjet dhe projektet. Presidenti i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Itali, shpallosi dhe projektin ambicioz, për krijimin e degëve të Lidhjes, në çdo rajon të Italisë, atje ku ka artistë shqiptarë, dëshirë dhe vullnet, për t'u dhënë mundësinë e bashkëpunimit, së pari, por dhe për ta bërë Lidhjen edhe më të pranishme dhe gjithëpërfshirëse. Pas tre orë aktivitet, të gjithë pjesëmarrësit iu drejtuan një ambienti tjetër të kështjellës, ku ishin ekspozuar pikturat mbresëlënëse të piktorëve Nikolla Rama dhe piktorja Anila Dekovelli Ciccone. Në të njëjtin ambient ishin të ekspozuara dhe veprat letrare të autorëve ku qe dhe rasti i i bukur i autografeve, vera e famshme e atyre anëve dhe ushqimeve të përgatitura enkas nga amvisat vendore, të cilat të kujtonin shijen e largët të vendlindjes. Pa asnjë hezitim, sa ishim prezentë, deklamua dhe konfirmojmë se ishte një aktivitet madhështor, ashtu si i takon një kështjelle, në çdo detaj, për vlerat e shpërfaqura me stil, kulturën tonë, të cilën e gjetëm dhe atje nëpërmjet arbëreshëve, artin si një fill që bashkon popujt, mirësinë dhe respektin reciprok shprehur me dinjitet.

Një javë në vizitë studimore në Yerevan të Armenisë

(vijon nga faqja 15)

Këtu gjenden shembuj unikë të përkthimit, origjina e të cilave nuk është ruajtur. Më tha se unë ato dokumenta mund ti konsultoja pa asnjë kufizim. Mbasi unë e kisha kohën e qëndrimit të kufizuar, u morëm vesh që ajo të më skaneronte të gjitha dokumentat që bënin fjalë për Shqipërinë dhe të mi dërgonte me postë elektronike. Orarit të punës i kishte ardhur fundi dhe ne u larguam të kënaqur dhe me përshtypjet më të mira nga ky institucion prestigjioz. Të lodhur por mjaft të kënaqur u drejtuan për në hotel.

Ditën e tretë të qëndrimit tonë në këtë qytet, e mërkurë dt. 13 nëntor 2024, u paraqitëm me së pari në Bibliotekën Kombëtare ku unë ju dhurova disa libra të mija të shkruar në gjuhët shqipe dhe italiane. Ata kërkuam sipas kërkesës time informacion për disa libra antike që unë po i kërkoja por kërkimi rezultoi se ato që kërkoja unë nuk gjëndeshin në këtë bibliotekë. Duke më falenderuar, më dhanë dokumentin për dorëzimin e librave dhe një fletë falenderimi të firmosur nga drejtoresha e kësaj biblioteke për dhënien pa pagesë të librave nga ana ime. U larguam nga biblioteka dhe u paraqitëm në Muzeun Historik Kombëtar për ta vizituar. Ishte një ndërtesë impozante, ndërtuar me mermer dhe me një arkitekturë mbresëlënëse e vendosur në qendër të qytetit në krah të godinës qeveritare ku ishte e vendosur kryeministria. Mbas kësaj vizite, u paraqitëm në Akademinë e Shkencave, në Institutin e Historisë së Armenisë tek Dekani i Fakultetit të Historisë dhe Drejtësisë Profesor Edgar Hovhannisyann. Biseduam gjatë për problemet e të dhënave për Shqipërinë në dokumentacionet që ata kishin dhe mbas një bisede të frytëshme dhe miqësore u ndamë për të shkuar në Bibliotekën Shkencore të Akademisë. Në këto takime gjithnjë ishte shoqëruar dhe përkthyesi ynë Prof. Harutyun Khudanyan i cili ishte organizatori i këtyre takimeve.

Në Muzeun e Genocidit Armen.

Ditën e enjte, me datë 14 nëntor 2024 shkuam për vizitë në muzeun e genocidit ndaj popullit armen. Edhe ky institucion ishte mbresëlënëse. I ndërtuar me mermer dhe i vendosur në majë të një kodre nga ku mund të vështroje të gjithë qytetin Yerevan, kishte një obelisk rreth 30 metra të lartë. Në stendat e muzeut



ishin të demonstruara krimet dhe barbaritë që ishin kryer ndaj popullsisë të pa mbrojtura dhe të pa fajshme të Armenisë. Aty deklarohet se në genocidin e vitit 1915, pushtuesit otoman kishin vrarë një milion e gjysëm armen. Fotot dhe dëshmitë e panumërta krijonin një tablo të qartë të këtij genocidi të tmershëm. Armenët tash mbi njëqind vjet kërkojnë që të njëjzet zyrtarisht ky genocid dhe të kompensohen për dëmet e shkaktuara. Kërkesa vazhdon edhe sot e kësaj dite por asnjë gjë nuk është bërë në këtë drejtim.

Mbasi vizituam Muzeun e Genocidit u paraqitëm në Bibliotekën shkencore të Akademisë së Shkencave. Në fillim aty takuam Prof. Zohrab Gevoryan. Mbas bisedës me profesorin e nderuar u paraqitëm në Bibliotekën Shkencore të Akademisë. Kjo bibliotekë më impresionoi sepse aty kishte, sipas asaj që ata më thanë, tetë milion libra shkencore në të gjitha gjuhët e botës. Unë ju dhurova librat e mija që i kisha sjellë për tu dorëzuar në libraritë e këtij vendi. Ata më bënë një dokument të tipit fletëhyrje dhe më pajisën me një kod me të cilin unë mund të shikoja librat e kësaj bibliotekë nga shtëpia ime pa qenë nevoja të shkoja aty. Orari zyrtar kishte mbaruar dhe ne u larguam për në hotel.

Ditë e fundit të qëndrimit tonë në Armeni, me 15 nëntor 2024, shkuam për vizitë në qendrën ndërkombëtare të kulturës. Ishte një institucion gjigand i mbështetur në shtatin e një kodre, me sheshe të zbukuruar me lule dhe me statuja gjigande, me një arkitekturë të mrekullueshme dhe i gjithi me mermer të skalitur. Ata që kërkojnë të njëjten më mirë me këtë qendër mund të kërkojnë në google serch me këtë emër "Cafesjian museum-foundation Yerevan".

Për tu ngjitur deri në majë, ishin njëmijë shkallë dhe ngjitja atje për njerëz të moshuar dhe me probleme kardiale siç isha unë ishte një gjë e pamundur. Në fillim të këtij institucioni ishte një hyrje dhe brenda kishte shkallë lëvizëse me korant të cilat të mundësonin të ngjiteshe nga njëri shesh pushimi tek tjetri pa u lodhur. U ngjitem me ndihmën e këtyre transportierëve deri në pikën më të lartë të mundshme por jo deri në majë të kodrës. Ndërtimi i kësaj qendre kulturore ishte ndërprerë pa u mbaruar për shkak të ndryshimeve politike atje dhe hekurat e vendosura me stafa me lartësi deri në gjashtë metra mbi themetet e përfunduara ishin të ndryshkura nga mosbetonimi. Tani opsioni i fundit ishte ngjitja me këmbë në shkallët prej betoni deri në majë të kodrës. Atje ishte një shesh i madh prej betoni i vendosur mbi kollona gjigande betoni dhe poshtë këtij sheshi kalonte autostrada me dhjetë kors. Në këtë shesh ishte i vendosur një tjetër obelisk mbi pesëdhjetë metra i lartë. Nga kjo pikë mund të shikoje qytetin e Yerevanit si në pëllëmbë të dorës. Më erdhi shumë keq kur u ngjita në krye dhe pashë që ky kompleks i mrekullueshëm kishte mbetur i pa përfunduar për shkak të ndryshimit të sistemit politik. Fotoja e dytë e tregon gjendjen e pjesës fundore të këtij kompleksi gjigand. Rreth pesëqind metra më larg, po në majë të kodrës ndodhej një park gjigand me pemë dhe me lodra pa fund për fëmijët. Kishte parcela me lodra ku pa ndonjë vështësi mund të luanin deri në një mijë fëmijë pa asnjë problem. Ishin ndërtuar dinosaur të bukur me madhësi deri në gjashtë metra të cilat krijonin një panoramë të këndëshme për fëmijët por edhe për të rriturit. Në mbarim të këtij parku por në vazhdimësi,

ishte i vendosur muzeu i luftës së dytë botërore. Ishte ndërtuar në formën e një obelisku rreth njëzet kate i lartë me një statujë të një luftëtari në majë midis një sheshi të madh ku ishin ekspozuar pajisje ushtarake is armë, raketa, aviona, tanke, topa etj.

Në brendësi muzeu kishte ekspozatë që tregonin luftën dhe qëndresën e popullit armen. Më së pari vizitori duhet të përkulej para memorialit të të rënëve për liri pastaj të vazhdoje vizitën në pavionet e ndryshme të këtij muzeu. Ata na thanë se në luftën e dytë botërore kishin marrë pjesë 49 bataljone armenie të cilët kishin shkuar nga Yerevani deri në Berlin. Në hartat e vendosura ishte shënuar dukshëm rruga e përshkuar nga kjo ushtri deri në Berlin. Në ballinën e një pavioni ishte hapur një galeri ku ishte vendosur një maket i sheshit kryesor të Berlinit dhe Raishtagu gjerman i bombarduar dhe shkatëruar nga ushtria ruse ku armenët kishin kontribut të dokumentuar. Galeria ishte vendosur prapa një xhami të madh rrafsh me murin dhe ishte e ndriçuar. Dukej si një pamje televizive tredimensionale. Ishte mbresëlënëse. Në njërin nga sallat ishin vendosur fotot e tradhëtarëve dhe bashkpunëtorëve të pushtuesve për të treguar se ata kishin gabuar shumë rëndë dhe ishin të dënues publikisht. Të tjera pajvone ekspozonin heronj dhe luftëtarë të shquar dhe relike të tyre. Midis këtyre ishte një gjeneral i cili kishte marrë pjesë në luftën e dytë botërore dhe kishte vdekur në vitin 1982. Ai ishte dekoruar dy herë me titullin "Hero i Popullit". Armenët krenoheshin për të kaluarin e popullit të tyre, për luftën, qëndresën dhe sakrificat që kishin kaluar. Vizitës tonë në Yerevan i kishte ardhur fundi dhe ne u drejtuan për në hotel për tu larguar të nesërmen në mëngjes heret për në Shqipëri. Ishte një udhëtim mbresëlënëse me veprimtari të dendur i realizuar në pesë ditë por që nëse e kemi të mundur, kemi dëshirë të shkojmë përsëri për të marrë më shumë informacione për këtë komb të lavdishëm. Dëshiroj të falenderoj të gjithë ata persona që më pritën dhe më ndihmuan pa rezervë në misionin tim. Falenderoj edhe Profesor Harutyun Khudanyan i cili më shoqëroi dhe më përktheu me shumë vëmendje bisedat me kolegët e tij. Ai ishte edhe organizatori kryesor i takimeve të mija. Gjithashtu më duhet të falenderoj personelin shumë të sjellshëm të hotelit Dynasty për ndihmën që na dhanë dhe për informacionet.

GJON MILI, NJË ARTIST ME PËRMASA BOTËRORE

(vijon nga faqja 18)

Ekspozita fotografike bienale në Musée Des Arts Décoratifs, Arle të Francës në verën e vitit 1971 u kushtua krijimtarisë së Gjon Milit.

Në vitin 1971 është i vetmi fotograf i autorizuar ndërkombëtarisht për pasqyrimin fotografik të procesit të fotografimit gjatë gjyqimit të një prej krerëve SS të shfarosjes së ebrejve gjatë Luftës së Dytë Botërore, Adolf Eichman.

Viti 1973 cilësohet si i veçantë për arsye se ai merr pjesë si fotoreporter i revistës "Life" në gjyqin e Skandalit të Uotergeit-it, ku ai realizon fljetra foto psikologjike dhe një foto kryevepër që përdoret si embleme e pasqyrimit të kësaj ngjarjeje.

Nga vitet 1970 deri thuhet në fund të jetës Gjon Mili e nënçmoi interesin e opinionit rreth tij, revistat filluan ta harronin. Më 1980, me rastin e 75 Vjetorit të lindjes, në Nju Jork u çel ekspozita retrospektive me 140 punime të tij dhe Shoqata e Grafistëve të Nju Jorkut botoi librin autobiografik të përgatitur nga vetë ai: "Gjon Mili Photographs & Recollection", libri më përfaqësues, ku përshihet një pjesë e krijimtarisë dhe kujtimet e refleksionet estetike të piktorit për fotografinë dhe artet e tjera.

Gjatë fundit të viteve të tij të krijimtarisë ai dha leksione e ligjërata mbi fotografinë nën prizmin e veprës dhe përvojës së tij në disa universitete e kolegje artistike amerikane. Ai nuk krijoi ndonjë lidhje të qëndrueshme familjare dhe nuk la pasardhës.

Vdekja e fotografit më 1984 (disa vjet më parë ai kishte pësuar një aksident automobilistik në Manhattan dhe shëndeti e personaliteti i tij ishin dëmtuar shumë), megjithatë, nuk e zgjoi opinionin artistik. Ndërroi jetë për shkak të një pneumonie në Stamford Connecticut të ShBA. Në varrimin e tij kishte shumë pak shqiptarë. Një valë e re interesi për fotografinë dhe njëherësh për Gjon Mili u vu në vetëm në fund të shek XX dhe fillim të shek. XXI



Më 1994, në librin e fotografes Susan Kismariç "American Politicians" (foto 1843-1993), New York, janë botuar edhe dy fotografi me temë politike të Milit.

Për nder të tij, dhjetë vjet pas vdekjes, në fund të vitit 1994, në Harvard Greenberg Gallery të Nju - Jorkut u paraqitën punë të bëra prej tij në harkun kohor 1930-1970, si dhe objekte nga jeta dhe vepra e Milit në lëmë të fotografisë dhe filmit. Interesi për këtë ekspozitë retrospektive ishte i tillë, sa që nga kritikët dhe vizitorët u quajt "ngjarja e vitit në fushën e fotografisë". (Q. Vriani: Gjon Mili - fotografi më i shquar shqiptaro-amerikan i shekullit.)


Qysh prej vitit 1998 Instituti Teknologjik i Massachusetts organizon çdo vit konkursin fotografik "Mili & Edgerton" për fotografë të rinj në homazh të një profesori dhe një studenti të shquar të tij. Në Kosovë, prej 2001, çdo vit gjatë një ekspozitë ndërkombëtare jepet çmimi Gjon Mili dhe një shkollë mban emrin e tij.

Në vitin 2000 fotografia e tij e Pikasos duke vizatuar me dritë ze vend në botimin e 500 fotografëve më të mirë të 59 vendeve të botës në të gjitha kohrat - albumin "The Photo Book" të shtëpisë botuese angleze "Phaidon".

Fotoja nga një ndeshje basketbolli ndërmjet universiteteve amerikane, bërë në vitin 1951, është zgjedhur ndër 100 fotot sportive më të mira të shekullit XXMë 2006 në Galerinë Kombëtare të Arteve, Tiranë është çelur ekspozita me foto të Gj. Milit nga fotografi i njohur shqiptar Roland Tasho.

Gjon Mili konsiderohet si fotografi i dritës dhe errësirës në kundërshtim, me gjithë nuancat e errëta dhe me hollësitë e dritës mbi profilet e muzikantëve të shquar zezakë.

Kështu, figurën brilante humane dhe intelektuale të Gjon Milit mund ta përcaktojmë në mënyrë sintetike si një inxhinier e shkencëtar novator; një fotograf dhe fotografetar të shquar klasik e modern,



që bëri zbulime e përparime të jashtëzakonshme në fotografinë mediatike dhe atë artistike e komerciale në shumë gjini si foto në lëvizje, foto stroboskopike, vizatime me dritë, fotot me dy ose disa shkrepje, fotot me mbivendosje, portrete ku shfaqet si një portretist botëror, fotot moderniste pa formë, foto shkencore, fotografi politike, peizazhe, monumente historike dhe arkitekturore antike e moderne, fotografi nudo, etj.; një kinestat ledhatar e të përkorë të muzikës xhaz, një letrar të sprovuar në disa librakatalogë madhore memuaristikë, prozë, tregime, reportazhe ese, kujtime, gazetari, etj., një veprimtar mëmëdhëtar e nostalgjik i atdheut të tij të lindjes, Shqipërisë.

Krijimtaria e botuar e Gjon Milit gjendet kryesisht në revistën LIFE ku ai punoi gjithë jetën, por edhe në ekspozita të shumta vetiake e të përbashkëta, retrospektive para e pas vdekjes së tij, të cilat vijnë edhe sot në të gjithë botën.

Kështu, vetëm gjatë "Erës së Artë" të revistës LIFE (1936-1972) Gjon Mili ka botuar aty në mënyrë të pandërprerë në 355 numëra të saj e thuhet se sipas përlogaritjeve tona deri në vitin 1972 ai ka botuar mbi 3.500 foto, përveç botimeve në libra, katalogë, organe e revista të tjera, si dhe të një

numëri edhe më të madh në LIFE.com.

Po aq i shpeshtë është edhe prezantimi i tij në ekspozita vetiake, apo të përbashkëta të nivelit amerikan e botëror në dhjetra vende të globit. Sipas kërkimeve e gjetjeve tona janë mbi 100 ekspozita të tilla,



luajtur me to edhe në mënyrë absurde ka kërkuar një dimension tjetër midis tyre. Nga kombinimi i konceptit fizik e imagjnativ në subkoshiençën e tij, u zhvilluan teknika e teknologji të reja, që ndikuan tek fotografët e ardhshëm, por edhe në përparimin e cilësisë së aparateve fotografike, të lehtësimit të ndriçimit në përgjithësi dhe atij stroboskopik, në veçanti, të ndjeshmërisë së filmave negativë e diapozitivë që do të lehtësonin e inkurajonin hapësirat e fotografisë stroboskopike moderniste.

Po aq i shpeshtë është edhe prezantimi i tij në ekspozita vetiake, apo të përbashkëta të nivelit amerikan e botëror në dhjetra vende të globit. Sipas kërkimeve e gjetjeve tona janë mbi 100 ekspozita të tilla, numëri i të cilave shtohet edhe sot e ku paraqiten veprat e tij surprizuese fotografike

Por, streha e përjetshme e Gjon Milit dhe veprës së tij është bërë sot e përgjithmonë Muzeu "Gjon Mili" në Korçë, vendlindja shqiptare e tij, ku pasqyrohet deviza e lëvizjes, e ndryshimit e jetës, që atij ia gjetën mbi tavolinën e punës dhe që citonte pak a shumë sipas Heralkiut mendimin se: "Gjithësia ekziston dhe nuk ekziston, ajo është e rrëshqitshme është në ndryshim të pandërprerë dhe largohet gjithmonë në mënyrë të njëtrajtshme."

Trashëgimia e tij artistike vazhdon të frymëzojë fotografët dhe artistët në të gjithë botën,

WINGS TRAVEL & Cargo



TRANSPORT NDERKOMBETAR Udhëtarë & Mallra
Bari, Foggia, Pescara, Ancona, Rimini, Bologna, Modenam, Parma, Piacenza, Milano, Bergamo, Brescia, Cremona

Autobus	+39 331 160 4572	Kamion	+39 324 551 7365
	+39 328 316 8617		+39 327 426 6040
	+39 327 426 6040		+355 69 337 3797
Shoferi	+355 68 545 0000		<i>Makina me qera</i>
			+355 69 337 3797

WINGS TRAVEL
Shqipëri - Itali - Shqipëri



WINGS TRAVEL

Bileta Avioni
Bileta Trageti
Bileta Autobuzi
Siguracione
Makina me qera

+355 69 337 3797
+355 68 840 8000
+39 331 1604572
+39 327 4266040
+39 328 316 8617

wingsagency@yahoo.com




BONI TRAVEL

SHQIPERI - ITALI - SHQIPERI

Administrator: Bilbil Çobaj
Shoferat

+355 692178389	+39 3444181239
+355 695222784	+39 3497447196

Adresa: VLORE - ALBANIA

Është për t'u lavdëruar gjesti bujar i shoferit të Kompanisë "Wings Travel & Cargo" Z. Hasan Nezaj, me origjinë nga Tropoja dhe banues në Durrës, i cili prej shumë kohësh nga Shqipëria për në Itali është një ndër shpërndarësit kryesor të gazetës "Rrënjët". Kur e pyet përse vallë gjithë ky përkushtim, me thjeshtësi të përgjigjet: "Ndjem krenar që kjo gazetë me frymë kombëtare e me emrin kuptimplotë "Rrënjët" të ndodhet në çdo familje shqiptare në mërgim.



Shoferit zemërbujar e patriot Bilbil Çobaj sapo i njoftuam mbi shpërndarjen e gazetës "Rrënjët" me thjeshtësi e buzëgaz na tha: "Është një nder e krenari për Kompaninë "Boni Travel" si dhe për mua personalisht që gazeta mbarëshqiptare të ndodhet në autobuzat e linjës: Arezzo, Bari, Brindisi, Firenze, Genova, Napoli, Pisa, Prato, Roma e Savona." Ai na premtoi që tashmë kjo gazetë me emrin kuptimplotë "Rrënjët" do të ndodhet kudo ku shkon "Boni Travel".

NOI srl
materiale edile

Shytermeja Aurel | Cell. 345 3029764
noi2017srl@libero.it

NOI s.r.l. - Via Anna Maria Mozzoni, 30
06073 Corciano, Perugia - Tel. 075 6979540 - P. IVA 03552250544

Nel punto di vendita NOI srl a Perugia, troverete un servizio professionale, speciale e tutti i materiali che cercate ..., ma di più troverete anche il nostro giornale "Le Radici". Il titolare, Shytermeja Aurel, è una persona eccellente che vi aspetta a braccia aperte.



Smerald Shpk Vlore

Tek Smerald Shpk Vlore me President Mihal Selimaj do të gjeni llojshmëri materiale si: Pllaka të dimensioneve të ndryshme, paisje Hidrosanitare, Aksesorë, Tulla për Oxhak, Mozaik shumëngjyresh, Kol, Fino, Stuko..., por mbi të gjitha një shërbim të shpejtë, cilësor e me kulturë. Ju mirëpresim në ambjentet tona me shumëllojshmëri materiale sipas gustos dhe shijes suaj dhe me çmim të arsyeshëm.

Adresa: Rruga Trasballkanike, pranë rrethrotullimit të Omones.
Magazina qendrore në hyrje të Nartës.
Vlorë, Albania Tel: 00355/67202359 & 00355/682040290
FB : Smerald Shpk Vlore